



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 338 Akti

Nr. 399 Vendimi
Tiranë, më 14.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 11.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Durim Hasa**, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Durim Hasa, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Durim Hasa është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, në momentin e shortimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Durim Hasa, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit duke u shortuar në datën 12.11.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Firdes Shuli, Etleda Çiftja dhe Roland Ilia.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31–33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin e datës 12.11.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisioneren Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 3.12.2019, me anë të postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) fillimin e procesit të rivlerësimit; (ii) anëtarët e trupit gjykues të shortuar për të zhvilluar procesin e rivlerësimit; (iii) deklarimin nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues; si dhe (iv) përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit

¹E-mail, datë 3.12.2019, ora 10:42 “Komisioni – njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

standard, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhje me procedurat e rivlerësimit.

6. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit shtesë dërguar me *e-mail*-in më lart, me anë të postës elektronike² dërgoi përgjigjet dhe dokumentacion bashkëlidhur.

7. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 19.3.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Durim Hasa, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes, vetëm për kriterin e pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për kriterin e pasurisë; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Në datën 19.3.2021, përmes postës elektronike³, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 15.3.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit për t'u njohur me dosjen e hetimit.

9. Në datën 24.3.2021, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike⁴, kërkoj kohë shtesë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të barrës së provës së kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht. Komisioni, me anë të postës elektronike⁵, njoftoi subjektin se afati i dërgimit të prapësimeve shtyhet nga data 2.4.2021 deri më 12.4.2021, ora 10:00.

10. Në datën 12.4.2021, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë, duke paraqitur dhe kërkesën për thirrjen e dëshmitarëve E. D., I. Z., V. H., B. SH., A. SH., I. SH. dhe A. A., si dhe duke kërkuar çeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të vlerësimit: kontrollin e figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

11. Më tej, në datën 14.4.2021, me anë të postës elektronike⁶, trupi gjykues, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore.

12. Në po të njëjtin komunikim elektronik të datës 14.4.2021, trupi gjykues njoftoi subjektin në lidhje me vendimin për refuzimin e kërkesës së tij për të thirrur si dëshmitar shtetasit E.D., I.Z., S.L., V.H., B.Sh., A.Sh., I.Sh. dhe A.A., bazuar në parashikimet germave “a” dhe “d”, të

²*E-mail*, datë 18.12.2019, ora 10:44.

³*E-mail*, datë 19.3.2021, ora 14:17 “Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁴*E-mail*, datë 24.3.2021, ora 9:42 Re: “Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁵*E-mail*, datë 25.3.2021, ora 17:49 Re: “Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁶*E-mail*, datë 14.4.2021, ora 13:26 “Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike”.

pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Trupi gjykues vlerëson se marrja në cilësinë e provës së dëshmimeve të shtetasve të kërkuar nga subjekti, me qëllim që të provonte fakte dhe rrethana të cilat ishin konstatuar nga rezultatet e hetimit kryesisht, ishin të panevojshme, duke qenë se këta shtetas gjatë hetimit administrativ kishin lëshuar deklarata noteriale në lidhje me këto fakte dhe rrethana. Në lidhje me kërkesën për dëshmitar të shtetasve V.H. dhe B.Sh., trupi gjykues vlerëson se dëshmia nuk mund të provonte të ardhurat e vëllait të subjektit si huadhënës, duke qenë se për të provuar të ardhurat sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti duhet të provonte se këto të ardhura ishin deklaruar dhe paguar tatimet nga ana e huadhënësit (vëllai i subjektit). Gjithashtu, pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, detyron huadhënësin të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të krijuara.

13. Gjithashtu, trupi gjykues, njoftoi subjektin e rivlerësimit se në lidhje me kërkesën e tij për riçeljen e hetimit administrativ dhe përfshirjen në procesin e rivlerësimit edhe të dy kriterëve të tjera, çmon se hetimi në lidhje me këto kriterë mund të rihapet vetëm nëse subjekti arrin të provojë me prova dhe shpjegimet përkatëse të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me kriterin e pasurisë. Më tej, provat dhe shpjegimet e subjektit bashkë me deklaratimet në seancë dëgjimore, do të vlerësohen nga ky trup gjykues para marrjes së vendimit. Për sa më sipër, deri në këtë fazë të procesit, trupi gjykues nuk pranoi kërkesën e subjektit për rihapjen e hetimit për kriteret e tjera.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Në datën 19.4.2021, ora 12:30, u zhvillua seanca dëgjimore në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

15. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ të kryer mbi kriterin e rivlerësimit të pasurisë.

16. Subjekti i rivlerësimit, pasi dëgjoi relacionin shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar prapësimet, lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht mbi kriterin e pasurisë, si dhe përsëriti kërkesën e tij për çeljen e hetimit administrativ edhe për të dyja kriteret e tjera të rivlerësimit (kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke deklaruar se ishte i bindur në pastërtinë e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, çka do të sillte dhe konfirmimin në detyrë.

17. Në datën 22.4.2021, pas seancës dëgjimore të datës 19.4.2021 dhe para se të diskutonin mbi vendimin për kriterin e pasurisë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues, bazuar në rezultatet e hetimit kryesisht mbi pasurinë, prapësimet me shkrim të subjektit, si dhe deklaratimet e tij në seancë dëgjimore, vlerësoi se duhet të shtyhet seanca dëgjimore për shpalljen e vendimit planifikuar në datë 23.4.2021 dhe të çelet hetimi edhe për të dyja kriteret e tjera të rivlerësimit: për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimin profesional.

18. Për këtë arsye, me vendimin e datës 22.4.2021, trupi gjykues vendosi të shtyjë seancën dëgjimore për shpalljen e vendimit të datës 23.4.2021 dhe të çelë hetimin për kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

19. Ky vendim iu komunikua subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike⁷ në datën 22.4.2021 dhe po në të njëjtin komunikim u njoftua se deri në këtë moment të marrjes së këtij vendimi të ndërmjetëm nuk ka rivlerësuar akoma kriterin e pasurisë, për të cilin kishte sjellë shpjegime dhe prova dhe për të cilin u zhvillua seanca dëgjimore e datës 19.4.2021 dhe rivlerësimi i kriterit të pasurisë do të bëhet vetëm pas prapësimeve dhe seancës dëgjimore, pasi t'ju jetë njoftuar përfundimi i hetimeve për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Gjithashtu, subjektit u njoftua se vazhdimi i seancës dëgjimore, njoftuar në datën 23.4.2021, ora 9:45, do të shtyhet deri në përfundimin e hetimit kryesisht mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilin subjekti do të ftohet në një seancë tjetër dëgjimore.

20. Komisioni, pasi hetoi dhe krijoi bindjen se provat për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesional kishin nivelin e provueshmërisë në datën 28.5.2021, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht.

21. Me anë të postës elektronike⁸, datë 28.5.2021, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht për kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 4.6.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative dhe i dha afat subjekti të rivlerësimit për të paraqitur prapësimet e tij deri në datën 4.6.2021.

22. Në datën 4.6.2021, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike⁹, paraqiti shpjegimet dhe provat për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

23. Me vendimin e datës 8.6.2021, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Durim Hasa, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua përmes postës elektronike¹⁰ se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 11.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, Tiranë.

24. Në datën 11.6.2021, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore për rezultatet e hetimit kryesisht në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatit, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

25. Relatori i çështjes, në vijimësi të seancës së datës 19.4.2021 mbi vlerësimin e pasurisë, në këtë seancë paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

26. Subjekti i rivlerësimit, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar prapësimet lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht mbi kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të seancës së datës

⁷ E-mail, datë 22.04.2021, ora 15:39 “Njoftim vendimi të ndërmjetëm dhe shtyrje të seancës dëgjimore”.

⁸ E-mail, datë 28.5.2021, ora 15:06 “Njoftim mbi përfundimin e rezultateve të hetimit të figurës dhe aftësive profesionale”.

⁹ E-mail, datë 4.6.2021, ora 15:53.

¹⁰ E-mail, datë 8.06.2021, ora 16:39 “Komisioni – Ftesë për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore publike për kriterin e figurës dhe profesionalizmit”.

11.6.2021, kryesuesi i trupit gjykues, njoftoi se seanca për shpalljen e vendimit, do të vazhdojë në datën 14.6.2021.

27. Në datën 14.6.2021, trupi gjykues i Komisionit, shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Durim Hasa, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

28. Subjekti i rivlerësimit Durim Hasa, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

29. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGj-ja është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

30. Referuar vendimit nr. 2/2017¹¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

¹¹ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi”. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

31. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Durim Hasa, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 për herë të parë dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

32. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2003 – 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

33. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shpresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaratimet e përfaqësueses ligjore me prokurë në seancë dëgjimore.

34. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

35. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon:

Znj. V.H. – bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; z. O.H. – djali i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; znj. Xh.H. – vajza e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur.

Z. S.L. - shok i subjektit të rivlerësimit (në cilësinë e huamarrësit) – konsiderohet personi tjetër i lidhur, pasi ka marrë hua nga subjekti në vlerën 1.200.000 lekë dhe e ka kthyer atë bashkë me interesat e përllogaritura në shumën 200.000 lekë; z. M.H. – vëllai i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet personi tjetër i lidhur, si rezultat i dhënies së huas në shumën 400.000 lekë; z. I.H. – babai i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet personi tjetër i lidhur, si rezultat i dhurimit të shumës 1.000.000 lekë.

36. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

1. Apartament banimi me sip. 96.6 m², ndodhur në L., Tiranë

1.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron një apartament banimi me sip. 96.6 m², në L., Tiranë, blerë nga subjekti “****” sh.p.k., në datën 10.9.2007, pasuria me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Vlera: 29.109,6 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: krijuar nga të ardhurat e familjes. Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹².

1.2. Nga faktet e hetimit administrative kryesisht rezulton se subjekti e ka deklaruar këtë apartament në DIPP-në e vitit 2006 me përshkrimin: “*Kontratë sipërmarrje për ndërtim shtëpie me sip. 103 m², pallat, Komuna D., Tiranë, sipërmarrës shoqëria “****” sh.p.k., vlera 46.500 euro. Likuiduar: 34.000 euro. Burimi: pakësuar gjendje cash në vlerën 3.800.000 lekë. Hua vëllait pa kontratë 400.000 lekë, 1.000.000 lekë dhënë nga babai dhe nëna*”. Në DIPP-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar: “*Shtesë, apartament banimi Komuna ‘D.’, Tiranë, me sip. 96.6 m², blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., në datën 10.9.2007, në vlerën 29.109 euro +20.000 lekë shpenzime, blerje, regjistrim... Shtesë, orendi shtëpiake për banesën e deklaruar me sipër të blera në treg, në vlerën 700.000 lekë. Pakësime, kontrata e sipërmarrjes për apartament banimi, nuk e kam më pasi u bë blerja e mësipërme...*”. Në pyetësin standard, subjekti deklaroi se për periudhën gusht 2008 – nëntor 2009, ka jetuar familjarisht në apartamentin me vendndodhje në rrugën “****”, pallati “****”, L. D., Tiranë (kjo është sot adresa e tij e banimit dhe se aty jetojnë fëmijët e tij).

1.3. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Tiranë¹³, në emër të subjektit të rivlerësimit rezulton e regjistruar pasuria me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji apartament me sip. 93.6 m², vërtetuar me kartelën e pasurisë.

¹² Kontratë shitblerje nr. ***, datë 10.9.2007, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Durim Hasa për blerje apartamenti me sip. 93.6 m², ndodhur në L., Tiranë, në vlerën 29.109 euro, pagesë e kryer nga blerësi jashtë zyrës noteriale, certifikatë për vërtetim pronësie, datë 14.9.2007, për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji apartament me sip. 93.6 m², në pronësi të Durim Hasa + kartelë pasurie.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 15.1.2020.

1.4. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar certifikatën e pronësisë në emër të tij, lëshuar në datën 14.9.2007, për apartamentin me sip. 93.6 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

1.5. Ky apartament është blerë me kontratën nr. ***, datë 10.9.2007, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. (përfaqësuar nga shtetasit I.Sh., E.A., A.M., A.Sh.) dhe palë blerëse shtetasin Durim Hasa për blerje apartamenti me sip. 93.6 m², ndodhur në L., Tiranë, në vlerën 29.109 euro (311 euro/m²), pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale.

1.6. Komisioni vëren se bëhet fjalë për të njëjtin apartament të deklaruar në DPV-në e vitit 2006 dhe atë të blerë dhe të deklaruar në DPV-në e vitit 2007, por evidentohen disa mospërputhje midis deklaramit të vitit 2006 nga njëra anë dhe deklaramit të vitit 2007 dhe deklaratës *Vetting* të vitit 2017 nga ana tjetër, pasi në DPV-në e vitit 2006, subjekti deklaron se është porositur një apartament me sipërfaqe 103 m², me sipërmarrës shoqërinë “****” sh.p.k (bëhet fjalë për të njëjtën shoqëri “****”), me vlerë 46.500 euro, *me burim krijimi pakësimi i gjendjes cash në vlerën 3.800.000 lekë, hua vëllait pa kontratë në vlerën 400.000 lekë, si dhe vlerën prej 1.000.000 lekësh dhënë nga babai dhe nëna*, ndërkohë që, në DIPP-në e vitit 2007 dhe në deklaratën *Vetting*, deklaron apartament me sip. 96.6 m², me shitës shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën 29.109.6 euro, *me burim të ardhurat familjare*.

1.7. Komisioni konstaton se shtetasi I.Sh. figuron në cilësinë e administratorit së shoqërisë “****” sh.p.k., në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 10.9.2007. Më tej, referuar kërkitimit *online* në faqen zyrtare të QKB-së, ky shtetas figuron si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.

1.8. Në pyetësorin nr. 1¹⁴, subjektit iu kërkua të paraqesë kontratën e sipërmarrjes të lidhur në vitin 2006, për apartamentin me sip. 103 m², në Komunën D., Tiranë me shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe anulimin e saj në vitin 2007. Subjekti në përgjigje¹⁵ shpjegon se kontrata e sipërmarrjes e vitit 2006, nuk është anuluar, pasi është shndërruar në kontratë shitblerje në datën 10.9.2007. Kontrata e deklaruar e sipërmarrjes nuk ka qenë kontratë formale, por verbale për shkak të lidhjeve të posaçme me administratorin e dy shoqërive “****” sh.p.k. që ishte shoqëria ndërtuese dhe “****” sh.p.k. që ishte shoqëria investitore. Subjekti ka blerë të njëjtin apartament që ka porositur, ndryshimi i sipërfaqes afërsisht 6 m², ka qenë për shkak të përlllogaritjeve të bëra në fund të ndërtimit. Për të mbështetur deklaramet e tij, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.9.2020, të lëshuar nga administrator i dy shoqërive, z. I.Sh.

1.9. Sipas deklaratës noteriale të dorëzuar nga subjekti, z. I.Sh., deklaron se ka qenë administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., të cilën e administron akoma dhe, gjithashtu, ka qenë edhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., e cila ka qenë shoqëri investitore që sot nuk është më aktive. Meqenëse, ka lidhje të afërta gjinie, pasi është kushëriri i bashkëshortes së tij, në vitin 2006, subjekti ka porositur një apartament gjatë kohës që shoqëria “****” sh.p.k., ndërtonte në L., Komuna D. Me përfundimin e ndërtimit dhe regjistrimin në ZVRPP, apartamenti i porositur u ble prej subjektit nga shoqëria investitore “****” sh.p.k. Për shkak të lidhjes së afërt kanë rënë dakord verbalisht që subjekti në pallatin e përmendur të blinte një njësi tregtare dhe një garazh, si dhe të ndryshojnë kushtet e përcaktuara në kontratën verbale të sipërmarrjes, siç

¹⁴ E-mail, datë 1.9.2020, ora 16:03.

¹⁵ E-mail, datë 16.9.2020, ora 15:56.

është çmimi i shitjes. Duke qenë se blerësi do të blinte edhe dy pasuri të tjera, apartamenti i porositur është shitur më lirë.

1.10. Duke qenë se subjekti deklaroi se kontrata e sipërmarrjes është shndërruar në kontratë shitblerje çmimi i shitjes konstatohet të jetë në vlerën 29.109,20 euro, pra, 4.890,80 euro më pak. Për sa rezulton, me anë të pyetësorit nr. 2¹⁶, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues që vërteton pagesën e shumës 34.000 euro, si dhe nëse gjatë ushtrimit të detyrës ka shqyrtuar ndonjë çështje me palë shtetasin I.Sh., apo shoqëritë ku ky shtetas është ortak/dhe ose administrator. Në përgjigje¹⁷, subjekti shpjegon se lidhur me deklarin e periodik të vitit 2006, për kontratën e sipërmarrjes dhe shndërrimin e saj në kontratë shitblerje, si dhe diferencën në çmim, sqaron se diferenca në çmim ka kaluar për pagesën në favor të shitësit për blerjen e njësisë dhe të garazhit. Kjo shumë është paguar në arkën e shoqërisë, nuk i kujtohet në sa këste dhe nuk disponon fatura. Kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, si dhe kontrata e shitblerjes së dyqanit dhe garazhit janë dokumentacioni ligjor që vërtetojnë pagesat e bëra.

1.11. Më tej, sqaron se nuk ka pasur asnjë proces gjyqësor me shtetasin I.Sh. dhe shoqëritë ku ky shtetas është ortak apo administrator, pra, për shkak të lidhjeve të posaçme me këtë person, nuk mund të zhvillonte procese gjyqësore që kishin lidhje me të. Për të vërtetuar deklarin e tij, subjekti paraqiti vërtetimin nr. *** prot., datë 25.1.2021, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Sipas këtij vërtetimi në këtë gjykatë nuk rezulton të jetë regjistruar dhe gjykuar prej subjektit ndonjë çështje civile apo penale në ngarkim të shtetasit I.Sh., si individ apo administrator.

Lidhur me burimin e krijimit

1.12. Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat familjare. Në DIPP-në e vitit 2006, si burim krijimi subjekti deklaroi: pakësuar gjendja *cash* në vlerën 3.800.000 lekë, hua nga vëllai pa kontratë në vlerën 400.000 lekë, si dhe vlerën prej 1.000.000 lekësh dhënë nga babai dhe nëna.

1.13. Për të analizuar të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, Komisioni analizoi gjendjen e likuidimeve *cash* të përdorura si burim krijimi dhe konstatoi se në vitet paraardhëse subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP-në e vitit 2003, ka deklaruar *cash* shumën 0.1 milion/lekë në banesë, burimi nga paga e tij dhe e bashkëshortes; me depozitë 0.45 milion/lekë, Banka e Kursimeve, burimi nga paga e tij dhe e bashkëshortes; (ii) në DIPP-në e vitit 2004, ka deklaruar gjendje *cash* shumën 500.000 lekë; (iii) në DIPP-në e vitit 2005, ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 950.000 lekë; (iv) në DIPP-në e vitit 2006, ka deklaruar pakësuar gjendje *cash* në shumën 3.800.000 lekë.

1.14. Duke qenë se ishte i paqartë akumulimi i shumës prej 3.800.000 lekësh, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit me anë të pyetësorit nr. 1, në përgjigje të të cilit shpjegoi se: “*Kjo pagesë përbëhet nga 550.000 lekë për periudhën deri në vitin 2003 + 500.000 lekë kursime për vitin 2004 + 950.000 lekë kursime për vitin 2005 + 1.000.000 lekë dhuruar nga babai im gjatë vitit 2006 deklaruar prej meje në datën 19.03.2007 + 400.000 lekë të mara hua nga vëllai im*

¹⁶ E-mail, datë 1.11.2020, ora 15:27.

¹⁷ E-mail, datë 25.1.2021, ora 15:30.

*M.H. + kursimet e mia të vitit 2006, pavarësisht se ato nuk mund të pasqyroheshin në formularin e atij viti, pasi shtesa ime ishte kontrata verbale e sipërmarrjes, me shoqërinë '***' sh.p.k. dhe pakësimi ishte shuma 3.800.000 lekë. Dua të theksoj se në shumën 3.800.000 lekë përveç shumave të mësipërme janë edhe kursimet e mia për vitin 2006 të llogaritura në shumën 400.000 lekë”.*

1.15. Sa më sipër, shuma 3.800.000 lekë, duket sikur përfshin: (i) kursime *cash* në vlerën 100.000 lekë deri në fund të vitit 2003; (ii) depozitë në ish-Bankën e Kursimeve në vlerën 450.000 lekë deri në fund të vitit 2003; (iii) kursime *cash* në vlerën 500.000 lekë gjatë vitit 2004; (iv) kursime *cash* në vlerën 950.000 lekë gjatë vitit 2005; (v) kursime *cash* në vlerën 400.000 lekë gjatë vitit 2006; (vi) hua nga vëllai në vlerën 400.000 lekë në vitin 2006; (vii) dhuruar *cash* nga babai në vlerën 1.000.000 lekë në vitin 2006, si dhe kursime, të cilat u analizuan në vijim:

- **Në lidhje me burimin (i) dhe (ii)** - kursimet *cash* në vlerën 100.000 lekë dhe depozita në ish-Bankën e Kursimeve në vlerën 450.000 lekë deri në vitin 2003

1.16. Komisioni analizoi pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 1994 – 2003, ku u konsideruan: (i) të ardhurat nga punësimi në shumën 3.621.213 lekë bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*; (ii) shpenzimet jetike në masën 66% për periudhën 1994 – 1999, sipas shkresës së ILDKPKI-së - INSTAT për periudhën 2000 – 2003; (iii) shpenzimet për blerjen e apartamentit në shumën 450.000 lekë në datën 18.7.1996, sipas arsyetimit në paragrafin 11.25 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht; (iv) shpenzimet për blerje apartamenti 2+1, me sip. 72 m², të ndodhur në lagjen “***”, Çorovodë, në shumën 500.000 lekë, referuar kontratës nr. ***, datë. 4.4.1999; (v) shpenzimet për blerje automjeti në shumën 320.000 lekë, sipas arsyetimit në paragrafin 7.4 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht; si dhe (vi) shpenzimet për krijimin e pasurive likuiditetet, konkretisht, në shumën 100.000 lekë *cash* dhe në shumën 450.000 lekë depozitë bankare.

1.17. Sipas analizës financiare, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 825.482 lekë, për krijimin e pasurive dhe shtesën e kursimeve, përgjatë periudhës 1994 – 2003.

- **Në lidhje me burimin (iii), (iv) dhe (v)** – kursimet *cash* gjatë viteve 2004, 2005 dhe 2006

1.18. Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin dhe personat e lidhur për vitet 2004, 2005 dhe 2006¹⁸, ku u konsideruan: (i) të ardhurat nga punësimi në shumën 3.838.654 lekë bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe në lëvizjet e llogarive bankare; (ii) të ardhurat nga interesat e depozitës bankare në ish-Bankën e Kursimeve; (iii) të ardhurat nga interesat e huadhënies nuk u konsideruan; (iv) shpenzimet jetike sipas shkresës së ILDKPKI-së - INSTAT për periudhën 2000 – 2003; (v) shpenzimet për krijimin e kursimeve *cash* sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore; (vi) ndryshimet e llogarive bankare, duke përllogaritur diferencën midis gjendjes në fund të vitit më atë në fillim të vitit.

¹⁸ Analiza për vitin 2006 përfshin vetëm analizimin e mundësisë për kursimin e shumës 400.000 lekë, duke përfshirë huan, dhurimet dhe pagesën për apartamentin.

1.19. Sipas analizës financiare, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 39.912 lekë për shtesën e kursimeve prej 950.000 lekësh në vitin 2005.

- **Në lidhje me burimin (vi)** – hua në shumën 400.000 lekë e marrë nga vëllai në vitin 2006

1.20. Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka deklaruar si burim krijimi vetëm “kursime nga të ardhurat e familjes” dhe jo huan nga vëllai, kjo në kundërshtim me pikën 7, të udhëzimit nr. 4095/2016 të ILDKPKI-së, ku për çdo pasuri në pronësi të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.

1.21. Në seksionin e të dhënave konfidenciale në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar detyrim financiar në shumën 400.000 lekë ndaj të vëllait M.H. Në pyetësonin standard, ka deklaruar se ka marrë hua shumën 400.000 lekë nga vëllai M.H., marrë në vitin 2006, pa kushte dhe afat shlyerje. Në vitin 2007 ka shlyer shumën 100.000 lekë dhe shumën prej 300.000 lekësh në vitin 2008.

1.22. Për të mbështetur deklaratimet e tij, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të huadhënësit nr. ***, datë 24.3.2015, sipas së cilës z. M.H. deklaroi se i ka dhënë subjektit huan në vlerën 400.000 lekë, për blerjen e një apartament banimi në Tiranë. Kjo hua është likuiduar tërësisht me këste. Më tej, subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 5.11.2019, lëshuar nga Shërbimi Veterinar Shqiptar, Sektori Veterinar Berat, ku konfirmohet se shtetasi M.I.H. ushtron veprimtari blegtorale në fshatin K., me kod ferme *** dhe mbarështon 200 (dyqind) krerë të imta, kjo fermë është e regjistruar prej vitit 2011 në sistemin kompjuterik *** dhe se e ka ushtruar aktivitetin edhe para vitit 2011.

1.23. Duke qenë se shtetasi M.H./vëllai i subjektit, konsiderohet person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, me anë të pyetësonit nr. 1¹⁹, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimet financiare të vëllait të tij. Në përgjigje²⁰ subjekti shpjegon se provat lidhur me burimet financiare të huadhënësit janë ato të dërguara në pyetësonin standard. Burimi i të ardhurave të vëllait është nga mbarështimi i bagëtive të imta që nga vitit 1991 dhe deri në ditët e sotme dhe se aktualisht ushtron të njëjtin aktivitet. Vëllai i tij ka një situatë të mirë financiare, si dhe kursime të cilat i ka bono thesari në “Raiffeisen Bank”.

1.24. Komisioni vëren se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti nuk provon se vëllai ka pasur të ardhura të mjaftueshme dhe të ligjshme për t’i dhënë subjektit huan e deklaruar. Vërtetimi i lëshuar nga Shërbimi Veterinar Shqiptar, Sektori Veterinar Berat, paraqitur nga ana e tij, citon se personi i lidhur/vëllai i subjektit ka ushtruar aktivitet përpara vitit 2011, por kjo nuk provon se ka realizuar të ardhura në periudhën që i ka dhënë hua subjektit dhe as që këto të ardhura janë të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 19, të nenit 3, të i ligjit nr. 84/2016.

¹⁹ E-mail, datë 1.9.2020, ora 16:03.

²⁰ E-mail, datë 16.9.2020, ora 15:56.

1.25. Sa më lart, personi tjetër i lidhur, z. M.H., ka pasur mungesë dokumentacioni në lidhje me burimet e ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 400.000 lekë.

▪ **Në lidhje me burimin (vii)** – dhuratë nga babai në shumën 1.000.000 lekë

1.26. Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka deklaruar si burim krijimi vetëm “kursime nga të ardhurat e familjes” dhe jo dhuratën nga babai, kjo në kundërshtim me pikën 7, të udhëzimit nr. 4095/2016, të ILDKPKI-së²¹. Në seksionin e të ardhurave të deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar dhuratë në mjete monetare në shumën 1.000.000 lekë, nga babai I.M.H., në momentin e bashkimit të dy familjeve në vitin 2006 me burim krijimi të ardhura nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral.

1.27. Në seksionin e të dhënave konfidenciale në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë, dhuratë nga babai dhe nëna në momentin e fillimit të bashkëjetesës me subjektin. Në pyetësin standard ka deklaruar se babai I.H. i ka dhuruar shumën 1.000.000 lekë, pas bashkimit në një familje me të dhe nënën. Burimi i kësaj shume ka qenë nga puna në bujqësi dhe blegtori e babait, deri në moshën 76-vjeçare dhe e nënës deri në moshën 71-vjeçare, si dhe nga pensionet e tyre.

1.28. Duke qenë se shtetasi I. dhe H.H. (prindërit e subjektit), konsiderohen persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, me anë të pyetësit nr. 1²², subjektin iu kërkua të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimet financiare të babait të tij. Në përgjigje²³, subjekti shpjegon se burimet financiare të babait janë ato të deklaruara në pyetësin standard, puna në bujqësi dhe blegtori e babait dhe nënës, pensionet e tyre, si dhe të ardhura të tjera të siguruara nga puna e tyre në mbledhjen e bimëve medicinale. Lidhur me këto të ardhura, subjekti deklaron se nuk ka dokumentacion ligjor, pasi punonjësit e bujqësisë kanë punuar në informalitet. Subjekti dorëzoi AMTP-në nr. ***, pa datë, që i përket familjes bujqësore me kryefamiljar shtetasin I.M.H.

1.29. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.1.2021, ku shtetasi B.Sh. deklaron se pas vitit 1993 ka kryer aktivitet privat në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të bimëve medicinale dhe se shtetasi I.M.H. i ka shitur çdo vit bimë të ndryshme medicinale, të mbledhura nga ai dhe familja e tij në zonat pyjore të krahinës, duke siguruar të ardhura të konsiderueshme. Deklarimit të tij i ka bashkëlidhur: (i) ekstrakt të QKB-së, ku shtetasi B.Sh. figuron i regjistruar në datën 9.5.2012 me aktivitet në fushën e grumbullimit, përpunimit të bimëve mjekësore; si dhe (ii) librezë punë të shtetasit F.Sh., ku figuron që kjo shtetase ka qenë e punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k., përgjatë periudhave 1.11.1999 – 31.1.2000 dhe 1.10.2001 – 30.6.2002.

1.30. Komisioni vëren se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti nuk provon se babai ka pasur të ardhura të mjaftueshme dhe të ligjshme për t’i dhënë subjektit dhuratën e deklaruar. Deklarata e lëshuar nga shtetasi B.Sh. nuk provon se babai i subjektit ka realizuar të ardhura

²¹ Për çdo pasuri në pronësi të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimin dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.

²² E-mail, datë 1.9.2020, ora 16:03.

²³ E-mail, datë 16.9.2020, ora 15:56.

në periudhën që i ka dhënë hua subjektit dhe as që këto të ardhura janë të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 19, të nenit 3 i ligjit nr. 84/2016.

1.31. Sa më sipër, Komisioni vëren se për shumën e dhuruar prej 1.000.000 lekësh, ka mungesë të dokumentacioni ligjor justifikues, lidhur me të ardhurat e babait/personi tjetër të lidhur I.H.

1.32. Si përfundim, personi tjetër i lidhur I.H., nuk ka dokumentacion ligjor justifikues për shumën e dhuruar prej 1.000.000 lekësh.

Lidhur me diferencën midis vlerës së paguar 34.000 euro me vlerën e deklaruar si burim 3.800.000 lekë

1.33. Komisioni konstaton se ekuivalenti i shumës 34.000 euro është 4.205.902 lekë²⁴ dhe, për rrjedhojë, rezulton një diferencë prej 405.902 lekësh²⁵, e paguar gjatë vitit 2006.

1.34. Duke qenë se subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2006 ka kursyer vetëm shumën 400.000 lekë (të përfshira te shuma 3.800.000 lekë), kjo nënkupton që pjesa e mbetur është shpenzuar. Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e diferencës prej 405.902 lekësh.

1.35. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (1) Lidhur me mospërputhjet në deklarime: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit të blerjes së këtij apartamentin në deklaratën Vetting të vitit 2017, duke pasur parasysh se në deklaratën Vetting subjekti deklaroi si burim të ardhurat e familjes, ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2006 deklaroi si burim dhuratën nga babai dhe huan nga vëllai. (2) Lidhur me ligjshmërinë e burimeve të krijimit: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumën 825.482 lekë për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve për periudhën 1994 – 2003; (ii) subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 39.912 lekë për shtesën e kursimeve prej 950.000 lekësh në vitin 2005; (iii) subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në vlerë 405.902 lekë në vitin 2006; (iv) ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues në lidhje me të ardhurat e personit tjetër të lidhur M.H. (vëllai), si dhe dokumentacion ligjor justifikues për dhënien e huas në shumën 400.000 lekë; (v) ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues lidhur me të ardhurat e babait/personi tjetër i lidhur z. I.H. (babai i subjektit), për dhurimin e shumës 1.000.000 lekë.

1.36. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, shpjegon se lidhur me mospërputhjet në deklarime se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit të blerjes së këtij apartamentin në deklaratën Vetting të vitit 2017, duke pasur parasysh se në deklaratën Vetting subjekti deklaroi si burim të ardhurat e familjes, ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2006 subjekti deklaroi si burim

²⁴ E vlerësuar me kursin e këmbimit mesatar të muajit dhjetor 2006, 1 euro = 123,703 lekë.

²⁵ Diferenca e 4.205.902 lekë me 3.800.000 lekë.

dhuratën nga babai dhe huan nga vëllai, Komisioni vëren se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime lidhur me këtë konkluzion.

1.37. Për sa i përket konkluzionit se subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumën 825.482 lekë për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve për periudhën 1994 – 2003, subjekti paraqiti shpjegimet e tij lidhur me veprimet e blerjes dhe shitjes së apartamenteve në Çorovodë.

1.38. Në lidhje me kursimet në shumën 200.000 lekë – subjekti shpjegoi se në deklaratën *Vetting* ka dorëzuar fotokopje të librezës së punës së tij dhe bashkëshortes, që vërtetojnë se subjekti nga muaji shtator 1988 deri në fund të vitit 1993, gjithashtu, edhe bashkëshortja e tij nga muaji shtator 1988 deri në muajin gusht të vitit 1995, kanë qenë të punësuar si mësues. Po kështu, për sa i përket aktivitetit të familjes dhe të ardhurave të siguruara, subjekti deklaroi se pas shpërbërjes së kooperativave bujqësore zyrtarisht në datën 31.7.1991, përveç të ardhurave nga pagat si mësues kanë pasur të ardhura nga puna në bujqësi dhe blegtori. Në përfundim të familjes bujqësore, në mesin e vitit 1994, subjektin deklaroi se prindërit dhe vëllezërit i kanë dhanë shumën 200.000 lekë, përfituar si rezultat i pjesëtimit të familjes bujqësore në momentin e largimit. Në vitin 1990 dhe në vazhdim ky aktivitet ka qenë informal dhe subjekti deklaroi se është në pamundësi absolute për të paraqitur dokumente ligjore. Për të kundërshtuar përfundimin e Komisionit se këto kursime nuk mund të realizoheshin për shkak të inflacionit që ka pasur ekonomia shqiptare në ato vite, subjekti shpjegon se zhvlerësimi i monedhës u shoqërua edhe me rritjen e madhe të çmimeve bujqësore dhe blegtorale. Kjo shumë, vijon subjekti, është rezultat i pjesëtimit të familjes bujqësore në momentin e largimit, kur çmimi i mallrave të vlerësuara kishte arritur nivelet e inflacionit. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti një vërtetim të lëshuar nga kryetari i fshatit Kapinovë.

1.39. Në lidhje me mospërputhjen e shumës 3.800.000 lekë me likuidimin prej 34.000 euro – subjekti sqaron se në deklarin periodik vjetor të vitit 2006 ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes për ndërtimin e një shtëpie në L., Komuna D. Kjo kontratë është lidhur verbalisht me njërin nga ortakët e shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k.. Në fund të atij viti pas përlllogaritjeve të bëra kanë arritur në përfundimin se subjekti nga shuma e asaj kontrate kishte paguar me lekë shqiptare vlerën 34.000 euro. Për këtë pagesë, vijon subjekti, ka pakësuar të gjitha kursimet deri në atë kohë, shumën e dhuruar nga babai, huan e marrë nga vëllai si dhe kursimet e vitit 2006. Në vijim, subjekti shpjegon se nga përmbajtja e deklaratës së pasurisë së vitit 2006, rezulton se ka pasur të ardhura nga paga e tij dhe e bashkëshortes në vlerën 1.447.637 lekë dhe se këto të ardhura flasin për një shtesë ose kursime të atij viti në një vlerë më të madhe se 400.000 lekë. Duke pasur parasysh se një vit më parë ka kursyer 950.000 lekë me të ardhura afërsisht 1.500.000 lekë, atëherë për vitin 2006 nga kursimet e subjektit që janë paguar për kontratën e sipërmarrjes kanë qenë rreth 800.000 lekë. Llogaritja e bërë prej tij kur ka deklaruar pakësim në vlerën 3.800.000 lekë, përfundon subjekti, ka qenë një gabim që është i vërtetueshëm nga të ardhurat e atij viti në raport me shpenzimet të cilat kanë qenë vetëm për ushqim. Nga kjo përlllogaritje rezulton se pakësimi në lekë për atë vit ka qenë në shumën 4.200.000 lekë.

1.40. Pretendimet në lidhje me shumën 1.000.000 lekë të dhuruar nga babai dhe huan në shumën 400.000 lekë të marrë hua nga vëllai – subjekti i paraqiti në të njëjtin arsyetim,

konkretisht deklaroi se ata kanë ushtruar aktivitet bujqësor dhe blegtoral, duke ndarë çdo vit të ardhurat nga ky aktivitet. Përveç punëve në bujqësi e blegtori, prindërit e tij dhe vëllai familjarisht kanë realizuar të ardhura edhe nga mbledhja e bimëve medicinale dhe tatimpagues janë grumbulluesit dhe tregtarët e bimëve, një prej të cilëve është edhe shtetasi B.Sh., për të cilën subjekti gjatë hetimit ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale. Pavarësisht se nga informacioni i kërkuar prej tij në rrugë elektronike për regjistrimin e personit fizik nuk del përpara vitit 2012, shpjegon subjekti, librezë e punës së bashkëshortes së shtetasit B.Sh., shtetasja F.Sh., provon ekzistencën e kësaj shoqërie apo personi fizik që prej datës 1.11.1999 dhe në vijim. Subjekti deklaron se vëllai i tij, shtetasi/M.H., ka krijuar një depozitë në Bankën e Kursimeve para vitit 2005 dhe me të njëjtën mënyrë e të njëjtën punë ka realizuar të ardhura dhe sot i ka në bono thesari në “Raiffeisen Bank”. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës kopje të librezës së vëllait pranë ish-Bankës së Kursimeve, ku hyrje-daljet e fondeve tregojnë se ka pasur mundësinë financiare për vlerën e dhënë hua, vijon subjekti. Subjekti vë në dukje se vëllai dhe kunata nuk kanë nxjerrë kurrë pasaportë biometrike dhe nuk kanë udhëtuar asnjëherë jashtë shtetit dhe, po kështu, ata pjesën më të madhe të pasurisë e kanë të investuar në sektorin e blegtorisë dhe se me punën e tyre kanë rritur të tre fëmijët, dy prej të cilëve i kanë arsimuar me arsim të lartë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.41. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.42. Në lidhje me mospërputhjen në deklarime lidhur me burimin e krijimit, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin burimin e krijimit të shumës 34.000 euro, duke pasur parasysh se në deklaratën *Vetting* subjekti deklaron si burim të ardhurat e familjes, ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2006 deklaron si burim dhuratën nga babai dhe huan nga vëllai.

1.43. Sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij dhe, në këto kushte, subjekti duhet të kishte deklaruar saktë burimin e krijimit, referuar kohës së kryerjes së pagesës.

1.44. Më tej, në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, përcaktohet se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

1.45. Referuar bazës ligjore më lart, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e germës “a” të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

1.46. *Për sa i përket kursimeve në shumën 200.000 lekë para fillimit të detyrës, në vitin 1992,* Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë pretendim duke marrë për bazë jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁶, të ardhurat e përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi atë vit, si pasojë e ndryshimeve të natyrës politike dhe ekonomike, janë të papërfillshme për shkak të inflacionit deri në 400% që kaloi ekonomia shqiptare. Periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991-1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë, e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare (lekë), në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta dhe të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha

1.47. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 39.912 lekë për shtesën e kursimeve prej 950.000 lekë në vitin 2005,* Komisioni vëren se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime për këtë konkluzion. Për këtë arsye, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 39.912 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve gjatë vitit 2005, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të ligjit nr. 84/2016.

1.48. *Lidhur me pretendimin e subjektit se gjatë vitit 2006 ka kursyer vlerën 800.000 lekë dhe jo vlerën 400.000 lekë,* Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë për sa kohë ky pretendim u paraqit pas njohjes së subjektit me barrën e provës dhe bie në kundërshtim me deklaratimet e tij të mëparshme. Për këtë arsye, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 405.902 lekë, për sa kohë subjekti deklaroi gjatë hetimit se gjatë këtij viti ka mundur të kursejë vlerën 400.000 lekë dhe, për rrjedhojë, diferenca në shumën 801.240 lekë²⁷, që ka rezultuar nga analiza financiare e Komisionit, prezumohet e shpenzuar.

1.49. *Për sa i përket huas nga vëllai në vlerën 400.000 lekë,* Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur kanë detyrimin të paraqesin dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 86/2016. Pavarësisht deklaratimit në DIPP-në e vitit 2006 të huas, personi tjetër i lidhur duhet të provonte se këto të ardhura janë deklaruar në organet përkatëse tatimore dhe për to është paguar detyrimin tatimor. Fakti që këto vlera monetare janë në sistemin bankar, nuk justifikon ligjshmërinë e tyre. Për këtë arsye dhe ky pretendim i subjektit nuk qëndron.

1.50. *Për sa i përket shumës së dhuruar nga babai në vlerën 1.000.000 lekë,* për të cilën subjekti pretendon se në vitin 1990 dhe në vazhdim aktiviteti bujqësor, blegtoral dhe mbledhja

²⁶ Vendim nr. 14-2019 (JR), datë 9.7.2019.

²⁷ Pasqyruar në pikën 1.29 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

e bimëve medicinale që ka zhvilluar babai i tij ka qenë informal dhe subjekti është në pamundësi absolute për të paraqitur dokumente ligjore, Komisioni vlerëson se kjo pamundësi nuk mund të kualifikohet në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, për aq kohë sa subjekti nuk provoi se ky aktivitet ishte regjistruar dhe janë paguar tatimet dhe dokumentacioni që provon këto fakte është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër. Subjekti i rivlerësimit pranon dhe vetë se ka qenë një aktivitet informal dhe i paregjistruar. Në këto kushte, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues se personi tjetër i lidhur ka të ardhura të ligjshme për të krijuar shumën 1.000.000 lekë, dhuruar subjektit, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

1.51. Në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie, trupi gjykues i Komisionit konkludon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 2.255.902 lekë²⁸ për të justifikuar likuidimin e vlerës 34.000 euro në vitin 2006, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Garazh me sip. 24.8 m², ndodhur në L., Tiranë

2.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi garazh makine me sip. 24.8 m², në L., Tiranë, blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., në datën 16.11.2007, pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Vlera: 5.555,2 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: nga të ardhurat e familjare. Për vërtetimin e deklaratimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁹.

Fakte nga hetimi kryesisht

2.2 Sipas dokumentacionit të depozituar në deklaratën *Vetting* dhe të administruar nga hetimi i Komisionit, rezultoi se kjo pasuri është blerë me kontratën nr. ***, datë 16.11.2007, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. (përfaqësuar nga shtetasit I.Sh., E.A., A.M., A.Sh.) dhe palë blerëse shtetasit Durim Hasa dhe R.C., për garazhin me sip. 24.80 m², ndodhur në L., Tiranë, në vlerën 5.555,2 euro (224 euro/m²), likuiduar jashtë zyrës noteriale.

2.3 Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Tiranë³⁰, në emër të subjektit të rivlerësimit rezultoi e regjistruar pasuria me nr. ***, z. k. ***, lloji garazh me sip. 24.8 m². Sipas kartelës së pasurisë figuron në bashkëpronësi të subjektit dhe z. E.L.D., regjistruar në datën 7.6.2019, në deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.4.2019 (*Not. E.T.*). Ndërkohë që sipas dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2018, të ZVRPP-së Tiranë, kjo pasuri ka në bashkëpronësi të subjektit edhe z. A.B. Sipas kontratës nr. ***, datë 13.10.2008, rezultoi se z. R.C. ia ka shitur pjesën e tij takuese në garazhin me sip. 24.8 m² (12.4 m²), znj. A.B. kundrejt vlerës 529.480 lekë.

²⁸ Diferenca midis vlerës së paguar (4.205.902 lekë, ekuivalenti i 34.000 euro) me shumën cash të mbartur (1.550.000 lekë) dhe atë deklaruar të kursyer gjatë 2006 e të përdorur për pagesën e (400.000 lekë)

²⁹ Kontratë shitblerje nr. ***, datë 16.11.2007, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Durim Hasa dhe R.C., të një garazhi me sip. 24.80 m², në vlerën 5.555,2 euro.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.1.2020.

2.4 Në DIPP-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar: “...*shtesë: garazh makine, Komuna ‘D.’ Tiranë, me sip. 24.8 m², blerë nga shoqëria ‘***’ sh.p.k., në datën 16.11.2007, në vlerën 5.555 euro +10.000 lekë blerje me pjesë takuese 50%*”.

2.5 Komisioni vëren se në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se pjesa takuese në këtë pasuri, është 100%, ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2017 pjesa takuese është 50%, po ashtu referuar kontratës së shitjes figuron blerës edhe shtetasi R.C. Lidhur me këtë mospërputhje, me anë të pyetësorit nr. 2³¹, subjektit iu kërkua të shpjegojë kontributin financiar të secilës palë shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, si dhe lidhjen e tij me shtetasin R.C. Në përgjigje³² subjekti shpjegon se pjesa takuese 100% e pasurisë e pasqyruar në deklaratën *Vetting* është një gabim i bërë prej tij, pasi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, ka deklaruar pjesën takuese në masën 50%. Pasuria është paguar në 50 % nga subjekti dhe në 50% nga shtetasi R.C. Subjekti deklaroi se pranë shoqërisë “***” sh.p.k. ka blerë tri pasuri të deklaruara, një pjesë të shumës i ka paguar *cash* dhe nuk disponon fatura, kurse një pjesë të pagesës e ka xhiruar me bankë.

2.6 Më tej, subjekti sqaron se shtetasin R.C. nuk e njeh dhe kontratën e shitblerjes nuk e kanë nënshkruar në të njëjtën ditë, si dhe nuk e ka përdorur pjesën e tij të garazhit. Aktualisht kjo pjesë pasurie është tjetërsuar te një person tjetër. Për vërtetimin e deklaramëve të tij, subjekti ka paraqitur certifikatën për vërtetim pronësie dhe kartelën e pasurisë, datë 7.6.2019, sipas të cilës tashmë figuron në bashkëpronësi të subjektit dhe z. E.L.D.

2.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2³³, subjekti sqaron se lidhur me deklarimin e tij periodik të vitit 2006 për kontratën e sipërmarrjes dhe shndërrimin e saj në kontratë shitblerje dhe diferencën në çmim, diferenca në çmim ka kaluar për pagesën në favor të shitësit për blerjen e njësisë dhe të garazhit. Kjo shumë është paguar në arkën e shoqërisë (nuk i kujtohet në sa këste) dhe nuk disponon fatura. Kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, si dhe kontrata e shitblerjes së dyqanit dhe garazhit janë dokumentacioni ligjor që vërtetojnë pagesat e bëra.

2.8 Për rrjedhojë, në shumën 34.000 euro përfshihet vlera e apartamentit 29.109,20 euro dhe vlera e garazhit 5.555,20 euro, duke rezultuar me një diferencë në vlerën 664,40 euro, e cila u pasqyrua në analizën financiare të vitit 2007.

2.9 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimin se ka mospërputhje midis deklaramit të subjektit dhe dokumentacionit të administruar nga hetimi i Komisionit në lidhje pjesën takuese të garazhit me sip. 24.8 m².

2.10 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime në lidhje me këtë konstatim. Trupi gjykues vlerëson se kjo mospërputhje në deklarime qëndron dhe konsiderohet si pasaktësi në deklarimin e pjesës takuese, pasaktësi e cila nga hetimi dhe dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti nuk ka pasur qëllim të caktuar për të fshehur këtë pasuri duke pasur parasysh se ishte në interes të tij deklarimi i saktë. Gjithsesi, Komisioni çmon se

³¹ E-mail, datë 1.11.2020, ora 15:27.

³² E-mail, datë 25.1.2021, ora 15:30.

³³ E-mail, datë 25.1.2021, ora 15:30.

pasaktësitë në deklaratimet periodike të pasurisë, të cilat janë në dëm të subjektit, nuk mund të përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore. Këto mospërputhje në deklarime do të mbahen në konsideratë nga trupi gjyqësor në vlerësimin tërësor të subjektit, për sa i përket mënyrës së deklaratimit, por në asnjë rast nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

3. Njësi shërbimi me sip. 32.9 m², ndodhur në L., Tiranë

3.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se zotëron një njësi shërbimi, me sip. 32.9 m², në L., Tiranë, pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, blerë nga shtetasi I.Sh. në datën 19.8.2009. Çmimi i shënuar në kontratë është në vlerën 2.010.000 lekë. Vlera: 30.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kredi në shumën 3.000.000 lekë, marrë në “Raiffeisen Bank” në datën 21.11.2009, si dhe të ardhurat e familjes. Subjekti për vërtetimin e deklaratimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³⁴.

Fakte nga hetimi kryesisht

3.2 Në DIPP-në e vitit 2009 subjekti deklaroi se zotëron pasurinë “njësi me sipërfaqe 32.9 m², pasuria nr. ***, blerë nga I.Sh., regjistruar në datën 6.10.2009, me vlerë 30.000 euro dhe pjesë takuese 100%”. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Tiranë³⁵, në emër të subjektit të rivlerësimit rezultoi e regjistruar pasuria me nr. ***, z. k. ***, lloji njësi me sip. 32.9 m², vërtetuar me kartelën e pasurisë.

3.3 Kjo pasuri është blerë me kontratën nr. ***, datë 19.8.2009, me palë shitëse I.Sh. dhe palë blerëse Durim Hasa, për blerje njësie me sip. 32.9 m², ndodhur në L., Tiranë, në vlerën 2.010.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Vërtetuar kjo pasuri me certifikatën e pronësisë nr. ***, lëshuar në datën 6.10.2009.

3.4 Komisioni vëren se ka mospërputhje lidhur me çmimin e blerjes të deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 dhe në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 në vlerën 30.000 euro, si dhe në kontratën e shitjes që figuron në shumën 2.010.000 lekë. Lidhur me sa konstatohet, subjekti u pyet me anë të pyetësorit nr. 1, ku ka shpjeguar se njësia me sip. 32.9 m², është blerë nga shitësi I.Sh. në shumën 30.000 euro, paguar me kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në shumën 2.746.000 lekë dhe është xhiruar me porosi të shitësit I.Sh. në llogarinë e bashkëjetueses V.H.H. në datën 28.12.2009, vetëm katër ditë pas disbursimit të saj. Pjesa tjetër e mbetur e vlerës së njësisë është paguar *cash* gjatë vitit 2009 nga kursimet e subjektit.

3.5 Në procesverbalin e ILKDPKI-së mbajtur në datën 18.3.2015, lidhur me mospërputhjen midis çmimit të përcaktuar në kontratë dhe atij të deklaruar në deklaratën periodike, subjekti ka theksuar se çmimi në kontratë është vendosur nga shitësi dhe nuk i është kushtuar rëndësi, por shpjegon që do të bënte deklaratim të rremë në rast se do të deklaronte blerjen me çmimin e kontratës.

3.6 Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar detyrim në shumën 1.000 euro shtetasi I.Sh. (shitësi i dyqanit), pa afat dhe pa interes. Ndërkohë që në deklaratat periodike në vitet në

³⁴ Kontratë shitblerje nr. ***, datë 19.8.2009, certifikatë pronësie nr. ***, datë 6.10.2009, kontratë kredie nr. ***, datë 21.11.2009.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 15.1.2020.

vijim nuk është deklaruar pagesa e këtij detyrimi dhe, gjithashtu, në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar ky detyrim financiar. Me anë të pyetësores nr. 2, subjektit iu kërkuan shpjegime për sa konstatohet nga Komisioni. Në përgjigje, subjekti deklaroi se në deklaratën pasardhëse, të vitit 2010, ky detyrim është likuiduar, por duke qenë se vlera ka qenë nën 300.000 lekë nuk është parë e arsyeshme të deklarohet.

3.7 Një tjetër mospërputhje që vihet re është se në pyetësores nr. 1, subjekti ka deklaruar se pjesa tjetër e mbetur e vlerës së njësisë, është paguar *cash* gjatë vitit 2009 nga kursimet e tij, pra, jo në vitin 2010 siç pretendohet me sipër në pyetësores nr. 2.

3.8 Në përfundim të analizimit të deklarimeve të subjektit në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se referuar gurmës “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ku subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me detyrimet ndaj palëve të treta dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie në gusht të vitit 2009, pasaktësi, e cila nuk bën të mundur kontrollin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushte e gurmës “a”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me burimin e krijimit

3.9 Kredi bankare - në DIPP-në e vitit 2009, subjekti deklaroi kredi për blerjen e njësisë, në “Raiffeisen Bank” me kontratën nr. ***, datë 21.11.2009, në vlerën 6.585.480 lekë (kësti mujor 36.586,08 lekë). Komisioni vëren se ka mospërputhje lidhur me vlerën e deklaruar për kredinë e marrë, pasi në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar vlerën 6.585.480 lekë, ndërkohë në deklaratën *Vetting* ka deklaruar vlerën 3.000.000 lekë. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 18.3.2015, lidhur me këtë mospërputhje subjekti shprehet se ka deklaruar shumën totale, principal+interesa, në fund të periudhës së shlyerjes.

3.10 Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2017, DPPPP-ja ka raportim se subjekti i rivlerësimit Durim Hasa, në datën 21.11.2009, ka marrë një kredi në shumën 3.000.000 lekë te pala kredidhënëse “Raiffeisen Bank”.

3.11 Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”³⁶, rezulton kontrata e kredisë bankare nr. ***, datë 21.11.2009, me kredimarrës Durim Hasa dhe bashkëkredimarrëse V.H., për shumën 3.000.000 lekë, qëllimi i dhënies së kredisë është përdorimi për kredi konsumatore me hipotekë dhe si kolateral është lënë apartamenti në pronësi të subjektit me sip. 93.6 m², ndodhur në L., Tiranë.

3.12 Komisioni kërkoi informacion nga “Raiffeisen Bank”, lidhur me aplikimin e kryer dhe analizën e riskut, për të saktësuar objektin e kësaj kontrate kredie. Në përgjigje³⁷, “Raiffeisen Bank” informon se për këtë rast nuk disponojnë formularë aplikimi dhe ka bashkëlidhur komunikime midis departamenteve përkatës ku, ndër të tjera, citohet: “[...] Klienti aplikon për

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2019.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021.

3.000.000 lekë kredi konsumatore me hipotekë. Qëllimi i kredisë është pagesë detyrimi. [...]” dhe më tej “[...] Numër fiks *** I.Sh. shok i klienti [...]”.

3.13 Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare, kjo kredi është disbursuar në datat 24.12.2009 dhe 28.12.2009, si dhe është transferuar shumë 2.746.000 lekë në favor të shtetasës V.H. me përshkrim “likuidim për blerje dyqani nga Durim Hasa”.

3.14 Komisioni vëren se në kontratën e shitblerjes, datë 19.8.2009, përcaktohet se shuma është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale, ndërkohë që kredia rezulton të jetë disbursuar në datën 24.12.2009. Lidhur me sa konstatohet, subjekti u pyet me anë të pyetësorit nr. 1, ku ka shpjeguar se shuma e deklaruar në kontratë dhe fakti që ajo shumë është paguar jashtë zyrës së noterisë, është bërë për shkak të lidhjeve të posaçme që subjekti ka me shitësin I.Sh., prej të cilit ka blerë edhe shtëpinë dhe garazhin. Kjo kontratë është bërë më parë me qëllim që subjekti ta përdorte si kolateral për marrjen e kredisë bankare për blerjen e njësisë tregtare.

3.15 Më tej, subjekti deklaroi se shuma për këtë njësi është paguar nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank” në shumën 2.746.000 lekë dhe është xhiruar me porosi të shitësit në llogarinë e bashkëjetueses V.H.H., në datën 28.12.2009, vetëm katër ditë pas disbursimit të saj. Pjesa tjetër e mbetur e vlerës së njësisë është paguar gjatë vitit 2009 nga kursimet e subjektit. Për të vërtetuar deklaratimet, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.9.2020, të lëshuar nga administrator i dy shoqërive z. I.Sh. dhe bashkëjetuesja V.H.H., si dhe nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” për klientin Durim Hasa, me nr. ***, datës 9.9.2020.

3.16 Sipas kësaj deklarate noteriale, është cituar se: “Kontrata e shitblerjes së njësisë është lidhur më parë me qëllim që pasuria të regjistrohej nga blerësi dhe të përdorej si kolateral për marrjen e kredisë për likuidim. Lidhur me deklaratimin e bërë në kontratë se likuidimi i vlerës është bërë jashtë zyrës noteriale, ky deklaratim është bërë në kushtet e marrëdhënieve të posaçme (lidhjeve familjare), me qëllim që blerësi mos të kishte pengesa për regjistrimin e pasurisë dhe sigurimin e kredisë për shlyerje. Pagesa është bërë pasi blerësi ka siguruar kredinë dhe shuma është derdhur me porosi të z. I.Sh. në llogarinë e bashkëjetueses së tij”.

3.17 Për sa referohet më sipër, Komisioni konstaton se këto deklarime nuk qëndrojnë, pasi në kontratën e kredisë nr. ***, datë 21.11.2009, për shumën 3.000.000 lekë, në nenin 6 të saj “sigurimi i kredisë”, pika 2, citohet se: “Hipotekuesi për të garantuar shlyerjen e plotë të kredisë ka hipotekuar Apartament me nr. pasurie ***, ndodhur në L., Tiranë, me sipërfaqe 93.6 m²”.

3.18 Në kushtet që: (i) referuar transfertës bankare, përfituesi i shumës së disbursuar nga kredia nuk është shitësi i pronës; dhe (ii) nuk qëndrojnë deklaratimet e subjektit lidhur me arsyen e shënimit të likuidimit në datën e nënshkrimit të kontratës për shkak të vendosjes si kolateral të kësaj njësie, Komisioni vlerësoi që analiza financiare të kryhet në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes më 19.8.2009, për vlerën e shënuar në kontratë, pra, 2.010.000 lekë, si dhe në datën 31.12.2009, për shumën 1.917.900 lekë. Kjo e fundit u përlllogarit si diferencë e vlerës 3.927.900 lekë (30.000 euro * 130,93 lekë³⁸) me vlerën 2.010.000 lekë.

³⁸ Kursi i këmbimit datën e nënshkrimit të kontratës, sipas faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

3.19 Kursime familjare - subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008: “... *cash, shtuar nga shitja e shtëpisë, paga ime dhe e bashkëshortes në shumën 1.450.000 lekë*” dhe në DIPP-në e vitit 2009 “... *pakësuar gjendjet cash së bashku me kursimet e realizuara në vitin 2009 në shumën 2.000.000 lekë*”.

3.20 Në lidhje me kursimet e vitit 2008, në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar shitje apartamenti 2+1, në lagjen “***”, Çorovodë, në maj të vitit 2008, në vlerën 2.200.000 lekë. Pagar taksa për shitjen e apartamentit në vlerën 170.000 lekë. Gjithashtu, në këtë vit ka deklaruar blerje apartamenti 1+1, në lagjen “***”, Çorovodë, “pa bërë dokumente në maj 2008, vlera 800.000 lekë”.

3.21 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka dorëzuar kontratën nr. ***, datë 4.4.1999, me palë shitëse z. B.Sh. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit, për blerjen e apartamentit me sip. 72 m² (2+1), në lagjen “***”, Çorovodë, me çmim 500.000 lekë. Kjo blerje është vërtetuar me certifikatën e pronësisë lëshuar në datën 23.4.2008. Më pas, ky apartament është shitur me kontratën nr. ***, datë 28.4.2008, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit Durim Hasa dhe palë blerëse z. Q.H. në vlerën 2.203.200 lekë. Konfirmuar sa më lart edhe me dokumentacionin e administruar në dosjen e ILDKPKI-së, me shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2017, të ZVRPP-së Skrapar.

3.22 Me anë të pyetësorit nr. 2, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për pagesën e taksave në shumën 170.000 lekë. Në përgjigje, subjekti shprehet se nga llogaritja e bërë nga ZVRPP-ja Skrapar rezulton se është paguar shuma 165.320 lekë dhe subjekti bashkë me shpenzimet e tjera nga shitja e ka rrumbullakosur vlerën në 170.000 lekë. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti dorëzoi dokumentacionin e ZVRPP-së Skrapar ku evidentohet se vlera e tatimit të paguar është në shumën 165.320 lekë.

3.23 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) ka mospërputhje lidhur me çmimin e blerjes së kësaj njësie, pasi në DIPP-në e vitit 2009 dhe në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, është deklaruar në vlerën 30.000 euro, ndërkohë që në kontratën e shitjes figuron në shumën 2.010.000 lekë; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 likuidimin e detyrimit në vlerën 1.000 euro, në referencë të germës “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, si dhe ka mospërputhje lidhur me deklaratimet e subjektit gjatë hetimit, pasi në pyetësorin nr. 1, subjekti ka deklaruar se pjesa tjetër e mbetur e vlerës së njësisë, është paguar *cash* gjatë vitit 2009 nga kursimet e tij, ndërkohë në pyetësorin nr. 2 pretendon se shlyerja e detyrimit të mbetur prej 1.000 euro është bërë në vitin 2010; (iii) Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personat e lidhur për periudhat 1.1.2009 – 19.8.2009 dhe 20.8.2009 – 31.12.2009, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në shumën 441.746 lekë në datën 19.8.2009 (datën e kontratës së shit-blerjes) dhe në shumën 211.801 lekë në datën 31.12.2009 (për periudhën 20.8.2009 – 31.12.2009).

3.24 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës shpjegon se në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka deklaruar se njësia me sip. 32.9 m² e blerë nga shitësi I.Sh., është blerë në shumën 30.000 euro. Shuma e deklaruar në kontratë dhe fakti që ajo shumë është paguar jashtë zyrës së noterisë, është bërë për shkak të lidhjeve të posaçme që ka me shitësin, prej të cilit ka blerë shtëpinë dhe garazhin. Kontratë është hartuar me qëllim që subjekti ta përdorte si kolateral për marrjen e një kredie bankare për blerjen e kësaj pasurie. Vlera për këtë njësi është paguar nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank” në shumën prej 2.746.000 lekë, kaluar me porosi të shitësit në llogarinë e bashkëjetueses V.H.H. në datën 28.12.2009, vetëm katër ditë pas disbursimit të saj. Pjesa tjetër e mbetur e vlerës së njësisë është paguar gjatë vitit 2009 nga kursimet e subjektit.

Bisedimet paraprake për marrjen e kredisë janë bërë nga shitësi, i cili ka biseduar me punonjësit e bankës për kushtet e marrjes së kredisë, ku ka deklaruar se do të vendosë njësinë si kolateral. Pas hartimit të kontratës me shitësin, banka e ka njoftuar se njësia nuk pranohej si kolateral, pasi vlera e saj ishte më e vogël se kredia që do të merrte dhe për të përfituar kredinë kërkohej një kolateral sa 130% e shumës së kredisë. Kjo gjë e detyroi të vendosë kolateral banesën dhe të përfitojë kredinë në vlerën 3.000.000 lekë, nga e cila, pasi u mbajtën shpenzimet e kostos së përfitimit të saj, pjesa tjetër u dërgua në llogaritë e shitësit. Subjekti sqaron se referuar deklarimeve të tij, çmimi 2.010.000 lekë për njësinë i shënuar në kontratë, nuk është paguar prej tij dhe nuk duhet t'i konsiderohet si shpenzim.

3.25 Për sa i përket mospërputhjes, lidhur me deklaratimet e subjektit në pyetësorin nr. 1, në të cilin ka deklaruar se pjesa tjetër e mbetur e vlerës së njësisë është paguar *cash* gjatë vitit 2009 nga kursimet e tij, ndërkohë në pyetësorin nr. 2 pretendon se shlyerja e detyrimit të mbetur prej 1.000 euro është bërë në vitin 2010, subjekti nuk dha shpjegime.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.26 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

3.27 Në dritën e deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe DIPP-në e vitit 2009 se vlera e blerjes së kësaj njësie është 30.000 euro dhe transaksionit bankar që vërteton se kredia është marrë për pagesën e detyrimit ndaj firmës për blerjen e njësisë, por dhe transferuar bashkëjetueses së pronarit të njësisë, vërteton se një nga burimet për pagesën e kësaj njësie ka qenë kredia e marrë në nëntor të vitit 2009. Ndërkohë që kontrata e shitjes në gusht të vitit 2009 me vlerë të ndryshme, e cila daton rreth 4 muaj para marrjes së kredisë, siç rezulton nga hetimi administrativ, ka qenë fiktive dhe vetëm në shërbim të marrjes së kredisë me qëllim vënien kolateral për kredinë që do të merrte subjekti nga banka. Ky rezultat pranohet edhe nga subjekti, i cili deklaron se e ka bërë kontratën vetëm për të përfituar kredinë, por në fakt nuk ka paguar shumën 2.010.000 lekë, sikundër citohet në kontratë.

3.28 Në lidhje me kontratën e shitjes, trupi gjykues vlerëson se kjo është një kontratë e cila nuk ka pasur për qëllim krijimin e pasojave për të cilat ajo nënshkruhet, si u pranua nga subjekti dhe, si e tillë, konsiderohet kontratë fiktive me qëllim përfitimin e kredisë së marrë nga banka.

3.29 Trupi gjykues në vlerësim të: (i) provave të administruara gjatë hetimit për pagesën e kryer bashkëjetueses së pronarit të njësisë nëpërmjet sistemit bankar nga fondet e kredisë; (ii) rregulloret e bankave private për dhënien e kredisë ku detyrimisht kërkohet kolateral për dhënie kredie apartamentin të cilin klientët kërkohet hua; (iii) deklarimeve konsistente të subjektit në DIPP-në e vitit 2009 dhe në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 se apartamenti është blerë në shumën 30.000 euro, pavarësisht se në kontratën e shitjes kishte vlerën 2.010.000 lekë; (iv) evidentimit në dosjen e kredisë të emrit të shitësit I.Sh. dhe citimit se qëllimi i kredisë është pagesë detyrimi; si dhe (v) faktit se subjekti ka deklaruar një çmim më të lartë se kontrata, gjë e cila nuk ishte në interesin e tij, për efekt të diferencës në shumën e blerjes reale me atë kontraktuale, çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë burimin dhe çmimin e blerjes së kësaj pasurie dhe ka burime të ligjshme për pagesën e kryer nga burimi i kredisë së marrë nga banka.

3.30 Më tej, në lidhje me pagesën e kryer jashtë sistemit bankar, në shumën 1.181.900 lekë³⁹, me burim kursimet familjare, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e kësaj vlere, për sa kohë që analiza financiare e vitit 2008 (gjatë së cilës është krijuar likuiditeti *cash* në shumën 1.450.000 lekë) dhe e vitit 2009 (gjatë së cilës është deklaruar pakësimi i kësaj vlere dhe është kryer pagesa për njësinë), rezultuan me balanca pozitive. Edhe nëse analiza financiare për vlerën 1.181.900 lekë do të kryhej në datën 19.8.2009, balanca e fondeve do të rezultonte pozitive në vlerën 386.354 lekë.

3.31 Në konkluzion, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e njësisë

4. Apartament me sip. 55 m², lagjja “**”, Berat**

4.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka blerë apartament banimi me sip. 55 m², me vendndodhje në lagjen “****”, Berat, blerë nga shtetasit A. dhe K.A., në datën 9.2.2015, pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Vlera: 2.400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kredi në “Raiffeisen Bank”, disbursuar në datat 30.10.2013 dhe 13.3.2015. Punime dhe riparime të kësaj shtëpie, në shumën 285.000 lekë. Burimi: krijuar me kursimet familjes. Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴⁰.

Fakte nga hetimi kryesisht

4.2 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shtesë apartament banimi me sip. 55 m², lagjja “****”, Berat, blerë me kontratë nr. ***, datë 9.2.2015, në vlerën 2.400.000 lekë dhe

³⁹ Diferenca midis ekuivalentit të vlerës 30.000 euro (3.927.900 lekë) me vlerën e transfertës bankare (2.746.000 lekë).

⁴⁰ Kontratë shitblerje nr. ***, datë 9.2.2015, palë shitëse K.A., palë blerëse Durim Hasa për blerje apartamenti me sip. 55 m², ndodhur në lagjen “****”, Berat, në vlerën 2.400.000 lekë; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 17.4.2015, kontratë kredie nr. ***, datë 4.3.2015, me palë kredidhënëse “Raiffeisen Bank” dhe palë kredimarrëse Durim Hasa, bashkë kredimarrëse V.H., për marrje kredie në vlerën 1.707.777 lekë.

punime riparimi e meremetimi në vlerën 285.000 lekë. Shtesë mobilimi dhe blerje elektroshtëpiake për banesën e blerë në shumën 720.000 lekë.

4.3 Në pyetësozin standard subjekti deklaron se nga marsi i vitit 2015 dhe në vazhdim jeton së bashku me bashkëshorten në këtë apartament.

4.4 Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Berat⁴¹, në emër të subjektit rezulton e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji apartament me sip. 55 m², ndodhur në lagjen “****”, Berat. Me kontratën nr. ***, datë 9.2.2015, me palë shitëse A. dhe K.A., subjekti ka blerë apartamentin me sip. 55 m², ndodhur në lagjen “****”, Berat, në vlerën 2.400.000 lekë, prej të cilave është shlyer shuma 700.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 1.700.000 lekësh do të paguhet menjëherë pas disbursimit të kredisë nga “Raiffeisen Bank” ose çdo bankë tjetër e nivelit të dytë. Sa më sipër, është vërtetuar me kartelën e pasurisë dhe certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, datë 17.4.2015.

4.5 Komisioni vëren se ka mospërputhje ndërmjet kontratës së dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe asaj të administruar gjatë hetimit, pasi në kontratën e dorëzuar nga subjekti nr. i repertorit figuron ***, ndërkohë që në dokumentacionin e administruar nga ASHK-ja Berat dhe noteri publik L.I.⁴² kontrata e shitblerjes mban nr. *** rep., për sa u përket elementëve të tjerë figurojnë të njëjtë në të dy kontratat.

4.6 Më anë të pyetësorit nr. 4⁴³, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me mospërputhjet e konstatuara dhe në përgjigje⁴⁴ deklaron se kontrata e blerjes së këtij apartamentit në regjistrin e noterit publik L.I., figuron me nr. ***, datë 9.2.2015. Numrat e repertorit dhe të koleksionit në të gjitha kopjet e kontratave të hartuara nga noteri janë me shkrim dore dhe gjatë plotësimit të numrit të repertorit në kopjen e kontratës që i është dhënë subjektit është regjistruar në mënyrë të gabuar nr. *** rep. Në lidhje me këtë fakt, subjekti deklaron se u vu në dijeni pas pyetësorit të Komisionit dhe pasi u paraqit te noteri konstatoi gabimin e bërë me shkrim dore prej këtij të fundit. Në përfundim deklaron se numri i repertorit të kësaj kontrate në regjistrin noterial rezulton ***.

4.7 Referuar udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014”⁴⁵, rezulton se vlera mesatare të shitblerjes për këtë apartament përllogaritet në shumën 2.320.450 lekë (55 m² * 42.190 lekë/m²). OSHEE-ja informon⁴⁶ se në emër të subjektit figuron një kontratë për energjinë elektrike, me adresë J.V., e cila ka kaluar në emër të subjektit në datën 4.11.2015.

Lidhur me burimin e krijimit - kredi në “Raiffeisen Bank”, disbursuar në datat 30.10.2013 dhe 13.3.2015

4.8 Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në shumën 676.000 lekë në “Raiffeisen Bank” në datën 31.10.2013 deri më 1.12.2017, por nuk ka deklaruar qëllimin e

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020.

⁴² Shkresë e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2020.

⁴³ E-mail, datë 10.3.2021, ora 16.29.

⁴⁴ E-mail, datë 18.3.2021, ora 09.40.

⁴⁵ Llogaritur sipas udhëzimit të vitit 2014, pasi udhëzimi nr. 4 i vitit 2015, është miratuar në datën 30.9.2015, pra, pas lidhjes së kontratës në datën 9.2.2015.

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2019.

përdorimit. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” me kontratën nr. ***, datë 13.3.2015, në shumën 1.707.777 lekë, me afat deri në datën 13.12.2015, *mbetur në datën e marrjes principal plus interesa 2.200.000 lekë*. Nuk është deklaruar qëllimi i përdorimit.

4.9 Në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”⁴⁷, është administruar informacion lidhur me dy kreditë e deklaruara nga subjekti, si vijon: (i) kontratë kredie bankare lidhur në datën 30.10.2013, kredimarrës Durim Hasa, vlera 676.000 lekë, me qëllimi i përdorimit të kredisë *preselected*; dhe (ii) kontratë kredie bankare lidhur në datën 4.3.2015, kredimarrës Durim Hasa, bashkëkredimarrëse V.H., hipotekues A. dhe K.A. (shitësit e apartamentit referuar kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 9.2.2015), vlera 1.707.777 lekë, qëllimi i përdorimit të kredisë “blerje shtëpie”, kolateral pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. *** (apartamenti i blerë nga subjekti).

4.10 Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare në datën 31.10.2013 është disbursuar shuma 676.000 lekë dhe nuk konstatohet ndonjë përdorim i menjëhershëm i saj, i tillë si tërheqje apo transfertë për llogari të të tretëve.

4.11 Komisioni i kërkoi informacion nga “Raiffeisen Bank”, lidhur me aplikimin e kryer dhe analizën e riskut, për të saktësuar objektin e kontratës së kredisë për shumën 676.000 lekë. Në përgjigje⁴⁸, “Raiffeisen Bank” informon se për këtë rast nuk disponojnë formularë aplikimi.

4.12 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se kredia e disbursuar në datën 31.10.2013 nuk është tërhequr/transferuar, por ka qëndruar në llogari dhe duke u bashkuar me kreditimet e pagave, ka shërbyer si burim i tërheqjeve nga bankomati, për pagesat e kësteve/utiliteteve dhe tërheqjes në datën 22.1.2015, në vlerën 1.250.000 lekë.

4.13 Më tej, në datën 13.3.2015 është disbursuar kredia e dytë, në shumën 1.707.777 lekë dhe menjëherë pas disbursimit është kryer një transfertë në shumën 1.700.000 lekë, në llogarinë e shitësit A.A., me përshkrim “likuidim pagesë për blerje shtëpie sipas kontratës së kredisë, datë 4.3.2015, Durim Hasa”.

4.14 Referuar informacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, “Alpha Bank”⁴⁹ konfirmon se subjekti ka kryer një depozitim *cash* në vlerën 1.250.000 lekë në datën 21.1.2015 në favor të shtetasve A. dhe K.A. (blerje apartamenti).

4.15 Me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, lidhur me këtë depozitim dhe i cili sqaroi se shitësit apartamentin me sip. 55 m² e kishin të ngarkuar me barrë në hipotekë, për shkak të një kredie në “Alfa Bank”. Me qëllim sigurimin e kredisë, duke e vënë banesën që do të blinte në hipotekë, duhej që të lirohej nga barra që kishte në “Alpha Bank”. Për këtë, në datën 21.1.2015, subjekti ka derdhur në “Alfa Bank” shumën 1.250.000 lekë për llogari të shitësve, nga të cilat vetëm 700.000 lekë ishin të tijat, kurse pjesa tjetër ishte pasuri e shitësve. Subjekti deklaroi se nuk ka pranuar që t’u dorëzojë lekët *cash* shitësve, me qëllim sigurimin e provës shkresore të dhënies së parave, që të mos kryheshin dy veprime në

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2019.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2017.

sportelin e bankës, shitësi A.A. ia dha shumën subjektit. Shuma 700.000 e shënuar në kontratën e blerjes me këste është pikërisht shuma e mbyllur prej subjektit në “Alpha Bank”. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti dorëzoi deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.9.2020, lëshuar nga z. A.A.

4.16 Komisioni vëren se në këtë deklaratë, z. A.A., shpjegon se ka qenë pronar i apartamentit me sip. 55 m² dhe në vitin 2015 ia ka shitur subjektit në vlerën 2.400.000 lekë, si dhe kanë rënë dakord, para lidhjes së kontratës, për kushtet dhe shitjen e saj. Duke qenë se kjo pasuri ishte vendosur në hipotekë për llogari të një detyrimi që z. A.A. kishte në “Alpha Bank” dhe nuk mund të kryente veprimin e shitjes pa mbyllur detyrimin në bankë, si dhe subjekti nuk mund të merrte kredi pa kolateral, kishin rënë dakord që të paguanin detyrimin e tij në “Alpha Bank”, ku vetëm 700.000 lekë ishin të subjektit kurse pjesa tjetër ishte e deklaruesit. Veprimi në bankë u krye nga subjekti, pasi donte të garantonte dhënien e shumës 700.000 lekë me shkresë, kurse deklaruesi A.A. për të shmangur veprime shtesë në sportel ia dha paratë e tij që t’i mbyllte subjekti. Kjo është arsyeja që në kontratën e shitblerjes u shënuar shlyer shuma 700.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 1.700.000 lekësh do të paguhej pas disbursimit të kredisë.

4.17 Në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”⁵⁰, evidentohet deklarata noteriale nr. ***, datë 19.6.2015, lëshuar nga z. A.A., i cili deklaron se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 9.2.2015, i ka shitur subjektit apartamentin kundrejt çmimit 2.400.000 lekë, prej të cilave me nënshkrimin e kontratës u shlye shuma 700.000 lekë dhe pjesa tjetër në shumën 700.000 lekë, do të likuidohet menjëherë pas disbursimit të kredisë që subjekti do të merrte në “Raiffeisen Bank”. Subjekti deklaron se në datën 17.6.2015, shleu shumën 1.700.000 lekë, nëpërmjet “Raiffeisen Bank” dhe nuk ka më asnjë detyrim financiar në lidhje me këtë kontratë.

4.18 Komisioni vëren se subjekti në datën 22.1.2015, ka tërhequr shumën prej 1.250.000 lekësh nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” dhe po në datën 22.1.2015 ka depozituar të njëjtën shumë në llogarinë e shitësve në “Alpha Bank”, ndërkohë që shpjegon se vetëm shuma 700.000 lekë ishte e tij, ndërsa diferenca ishte e shitësit.

4.19 Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, detyrimet, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur për vitin 2015, duke e përfshirë edhe diferencën e derdhur në llogarinë e shitësit në vlerën 550.000 lekë, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 1.117.301 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2015.

4.20 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) duket se vlera reale e apartamentit me sip. 55 m², në lagjen “****”, Berat, është 2.950.000 lekë referuar pagesave të kryera (kësti I në shumën 1.250.000 lekë dhe kësti II në shumën 1.700.000 lekë) dhe jo 2.400.000 lekë referuar çmimit në kontratë dhe atij të deklaruar nga subjekti; (ii) subjekti

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2019.

dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 1.117.301 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2015.

4.21 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës shpjegon se apartamenti me sip. 55 m² ishte i ngarkuar me barrë në hipotekë, për shkak të një kredie që shitësit kishin në “Alfa Bank”. Me qëllim sigurimin e kredisë, duke e vënë këtë banesë në hipotekë, duhej të lirohej nga barra që kishte në “Alfa Bank”. Për këtë në datën 21.1.2015, subjekti ka derdhur në “Alfa Bank” shumën 1.250.000 lekë për llogari të shitësve. Nga kjo shumë vetëm 700.000 lekë ishin të subjektit, kurse pjesa tjetër ishte pasuri e shitësve. Subjekti deklaroi se nuk ka pranuar t’u dorëzonte paratë *cash* shitësve, me qëllim sigurimin e provës shkresore të dhënies së parave, kurse shitësi A.A. me qëllim që të mos kryheshin dy veprime në sportelin e bankës i ka dhënë pjesën tjetër të shumës subjektit për ta depozituar dhe atë. Shuma 700.000 lekë e shënuar në kontratën e blerjes me këste është pikërisht shuma e mbyllur prej subjektit në “Alfa Bank”. Subjekti deklaroi se vërtetë ka tërhequr nga llogaria e tij në shumën 1.250.000 lekë, por vetëm 700.000 lekë prej tyre ia ka dhënë shitësit, kurse pjesën tjetër e kam përdorur për riparime dhe rregullime në banesën, si dhe për blerjen e sendeve të domosdoshme për të. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.9.2020, të lëshuar nga shitësi A.A.

4.22 Gjithashtu, subjekti thekson se çmimi i gjetur prej Komisionit në vlerën 2.950.000 lekë nuk i korrespondon çmimit të tregut për banesat 1+1 të ndërhuara para vitit 1970 në lagjen “***”, Berat.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.23 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

4.24 Deklarimi i subjektit se vërtetë ka tërhequr nga llogaria e tij shumën 1.250.000 lekë, por vetëm 700.000 lekë prej tyre ia ka dhënë shitësit, kurse pjesën tjetër shitësi ia ka kthyer në *cash* dhe se subjekti e ka përdorur për riparime dhe rregullime në banesën, si dhe për blerjen e sendeve të domosdoshme për të, ngelet në nivel deklarativ dhe i paprovuar kthimi mbrapsht të subjektit i shumës 550.000 lekë.

4.25 Duke vërejtur se: (i) përshkrimi i depozitimit të vlerës 1.250.000 lekë qartësisht i referohet blerjes së apartamentit⁵¹; (ii) subjekti ka tërhequr nga llogaria në “Raiffeisen Bank” ekzaktësisht të njëjtën shumë në të njëjtën datë që ka kryer depozitimin e në llogarinë e shitësit në “Alpha Bank”; si dhe (iii) mungon një arsyetim logjik nga subjekti për nevojën e depozitimit prej tij në një transaksion të vetëm të shumës së detyrimit të tij për blerjen e apartamentit (700.000 lekë) dhe fondeve personale të shitësit (550.000 lekë), Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka blerë apartamentin në shumën 2.950.000 lekë referuar

⁵¹ Aneks 29, dosje ILDKPKI, mandat depozitimi në llogarinë e shtetasi A.A., vlerë 1.250.000 lekë, përshkrim “*Durim Hasa derdhje në llogari të A.A. për blerje apartamenti*”.

pagesave të kryera (kësti I në shumën 1.250.000 lekë dhe kësti II në shumën 1.700.000 lekë) dhe jo në shumën 2.400.000 lekë.

4.26 Për rrjedhojë, trupi gjykues pas kryerjes së analizës financiare, arrin në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2015 në shumën 1.117.301 lekë, për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive.

4.27 Në përfundim, subjekti i rivlerësimi nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, nuk ka qenë i vërtetë në deklaratimet e tij dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2015 në shumën 1.117.301 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive blerjen e këtij apartamenti, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

5. Mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën 1.620.000 lekë

5.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake në vlerën 1.620.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursimet familjare.

Fakte nga hetimi kryesisht

5.2 Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shtesë mobilim dhe blerje elektroshtëpiake në shumën 580.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar shtesë orendi shtëpiake të blera në treg për banesën me sip. 96.6 m², të ndodhur në L., në shumën 700.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shtesë mobilimi dhe blerje elektroshtëpiake për banesën me sip. 55 m², në lagjen “****”, Berat, në shumën 720.000 lekë. Në pyetësonin standard, subjekti shpjegon se mobilimi i apartamenteve është i thjeshtë, i bërë pjesë-pjesë dhe kur ka blerë ndonjë pajisje të re, të vjetrën ose e ka hedhur ose e ka përdorur në banesën tjetër. Në bazë të deklaratimeve periodike, rezultoi se ka shpenzuar në total 1.620.000 lekë, vlerë kjo e deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*. Në përfundim, subjekti deklaroi se është në pamundësi të paraqitjes së provave për mobilimin e shtëpive duke qenë se janë bërë pjesë-pjesë dhe janë blerë në vende të ndryshme.

5.3 Më anë të pyetësonit nr. 2, subjekti u pyet lidhur me shpenzimet e arredimit për apartamentet e blera në qytetin e Çorovodës. Në përgjigje deklaroi se arredimi i tyre është bërë pjesë-pjesë nga viti 1996 dhe në vazhdim. Fillimisht ka përdorur sende të cilat i ka pasur para vitit 1996 dhe më pas ka blerë pjesë-pjesë sendet e nevojshme. Sendet që ka pasur në banesën 1+1 pas shitjes së saj, i ka çuar në banesën 2+1. Duke qenë se pajisjet janë blerë në treg, në periudha të ndryshme disa edhe të përdorura, subjekti nuk është në gjendje të përcaktonte vlerën e tyre.

5.4 Komisioni vëren se lidhur me shpenzimet e mobilimit dhe pajisjeve elektroshtëpiake, subjekti në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësonin standard ka deklaruar në total shumën 1.620.000 lekë, ndërkohë që në deklaratat periodike vjetore janë deklaruar në total shpenzime në vlerën 2.000.000 lekë.

5.5 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime

subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimin se ka mospërputhje lidhur me vlerën e deklaruar për shpenzimet e mobilimit dhe pajisjeve elektroshtëpiake, pasi në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar në total në shumën 1.620.000 lekë, ndërkohë që deklaratat periodike vjetore janë deklaruar në total shpenzime në vlerën 2.000.000 lekë.

5.6 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime lidhur me rezultatin e mësipërm.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.7 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shpresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shpresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

5.8 Subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime lidhur me deklarimin e një vlere më të ulët prej tij në deklaratën *Vetting*, krahasimisht me atë të deklaruar ndër vite dhe, për rrjedhojë, Komisioni, për efekt të analizës financiare, i qëndroi vlerave të deklaruara në DIPP-të vjetore, sipas relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

6. Automjet tip “Renault Megane”, me targa *, në vlerën 2.700 euro**

6.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se zotëron automjetin tip “Renault Megane”, blerë nga shtetasi D.N., në datën 13.11.2011, në vlerë 2.700 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursimet familjare. Subjekti, për vërtetimin e deklaratimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵².

Fakte nga hetimi kryesisht

6.2 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar blerje automjet tip “Renault Megane”, nga shtetasi D.N., në datën 13.11.2011, në vlerën 2.700 euro. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRr-ja⁵³, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar automjetin me targa ***. Më kontratën nr. ***, datë 13.11.2011, me palë shitëse D.N., subjekti ka blerë automjetin tip “Renaul Megane”, me vit prodhimi 2003, në vlerën 2.700 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Nga verifikimet e kryera në AMF, ky automjet rezulton në pronësi të subjektit prej vitit 2011.

6.3 Referuar analizës financiare në datën 31.12.2011, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 933.932 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2011.

6.4 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se subjekti dhe personat

⁵² Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 13.11.2011, me palë shitëse D.N. për automjetin tip Renaul Megane, në vlerën 2.700 euro.

⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2019.

e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 958.932 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2011.

6.5 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, shpjegon se në deklarin periodik të vitit 2011 janë deklaruar të ardhura nga paga dhe të ardhura për bashkëshorten nga biznesi i saj. Sipas kontratës së qirasë së datës 15.12.2011, të lidhur me qiramarrësen T.Ç., rezulton se atë vit bashkëshortja e subjektit së bashku me lënien me qira të njësisë i ka shitur qiramarrësit edhe të gjitha mjetet e xhiros. Nga këto të fundit pas inventarit të bërë ka përfutuar *cash* shumë prej 800.000 lekësh. Kjo e ardhur nuk është deklaruar për shkak të harresës, por provohet si nga kontrata e qirasë e nënshkruar nga palët, ku është përcaktuar edhe shuma 800.000 lekë, ashtu dhe nga deklarimi periodik vjetor i vitit 2009, plotësuar në datën 18.3.2010, në të cilën është deklaruar pakësim i gjendjes *cash* në vlerën 2.000.000 lekë, 700.000 prej të cilave janë shtuar mjete xhiro për biznesin e bashkëshortes, kurse pjesa tjetër është paguar për blerjen e njësisë tregtare. Për sa rezulton, subjekti kërkon që këto të ardhura në shumën 800.000 lekë, të përfshihen në analizën financiare.

6.6 Gjithashtu, subjekti paraqiti shpjegimet e tij lidhur me të ardhurat nga punësimi i djalit të tij, të cilat në DIPP-në e vitit 2011, viti në fjalë, i ka deklaruar në shumën 125.000 lekë. Subjekti deklaroi se për sa i përket ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kushtet e mosdeklarimit si i punësuar dhe mospagimin e detyrimeve tatimore, e lë në vlerësim të Komisionit dhe theksoi se ka qenë detyrë e punëdhënësit dhe e strukturave shtetërore që ta regjistronin djalin e tij si punëmarrës.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.7 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

6.8 Komisioni, në vlerësim të pretendimit të subjektit për njohjen e të ardhurave në vlerën 800.000 lekë nga shitja e mjeteve të xhiros, shqyrtoi dy skenarë të mundshëm.

6.9 I pari është rasti që këto të ardhura janë të përfshira në xhiron e aktivitetit dhe, për to, është lëshuar dokumenti i duhur që provon transaksionin e shitjes sipas kërkesave të legjislacionit të kohës⁵⁴ dhe i dyti, rasti kur këto të ardhura nuk janë përfshirë në xhiron e aktivitetit. Në analizë të skenarit të parë, presupozohet se për të ardhurat e pretenduara janë paguar detyrimet tatimore për sa kohë janë përmbushur kërkesat ligjore për evidentimin e transaksionit të shitjes. Kjo nënkupton që këto të ardhura janë të përfshira në të ardhurat e aktivitetit, pjesë e rezultatit financiar të vitit ushtrimor, pra, fitimit nga aktiviteti, fitim i cili

⁵⁴ Në nenin 47, dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore për tatimpaguesit e klasifikuar “biznes i vogël”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ku citohet: “*Tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit ‘Për taksën vendore të biznesit të vogël’, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe lëshojnë një faturë të thjeshtë tatimore apo kuponë tatimorë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, si dhe dispozitat e ligjit ‘Për tatimin mbi të ardhurat’*”.

është konsideruar në analizën financiare të vitit 2011, në vlerën 695.000 lekë⁵⁵ dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk mund t'i përfshijë sërish këto të ardhura në analizën financiare.

6.10 Ndërkohë që, në skenarin e dytë, moslëshimi i faturës përkatëse për shitjen e mjeteve të xhiros, nuk do të kishte bërë të mundur lindjen dhe, më tej, pagesën e detyrimeve pranë organeve tatimore dhe në kuptim të parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, konsiderohen si pasuri të ligjshme të ardhurat që janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Lidhur me të ardhurat në fjalë, Komisioni vë në dukje se këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në vijim të analizës së skenarit të dytë, për to nuk janë paguar detyrimet tatimore.

6.11 Sa analizuar më lart, Komisioni vlerëson se të ardhurat në vlerën 800.000 lekë nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare.

6.12 Referuar pretendimit lidhur me të ardhurat nga punësimi i djalit, duke qenë se këto të ardhura nuk konsiderohen të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk i pasqyroj në analizën financiare.

6.13 Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 958.932 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2011, vit në të cilin është blerë automjeti, duke u gjendur në kushtet germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

7. Automjete të tjera

7.1 Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar se zotëron automjetin tip “Mercedes-Benz”, me vit prodhimi 1996, në vlerën 320.000 lekë, blerë në datën 12.11.2002 nga shtetasi N.Gj. me burim krijimi kursimet e subjektit dhe bashkëshortes. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 250D”, me kontratën nr. ***, datë 23.12.2011, në vlerën 2.000 euro.

7.2 Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja⁵⁶, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar në pronësi të tij automjetin me targa *** (statusi çregjistrim i përhershëm). Ky automjet është blerë me kontratën nr. ***, datë 12.11.2002, me palë shitëse z. N.Gj. dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit në vlerën 1000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noterale. Më pas, subjekti e ka shitur me kontratën nr. ***, datë 23.12.2011, te pala blerëse z. B.G., në vlerën 2.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noterale. Nga verifikimet e kryera në AMF, rezulton se në emër të subjektit është prerë polica e sigurimit në datën 16.2.2012 – 15.2.2013, ndërkohë që ky automjet është shitur nga subjekti në datën 23.12.011.

7.3 Komisioni vëren se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit, lidhur me vlerën e blerjes së këtij automjeti, pasi në DIPP-në e vitit 2003, subjekti deklaroi çmimin në vlerën 320.000

⁵⁵ Është zbritur vlera 25.000 lekë për qiranë e muajit dhjetor 2011, e cila sipas deklaratimit është përfshirë në shumën totale prej 720.000 lekë e deklaruar si e ardhur.

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2019.

lekë, ndërkohë që referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 12.11.2002, ky automjet është blerë në vlerën 100.000 lekë.

7.4 Për efekt të analizës financiare, Komisioni përfshiu në analizën financiare të periudhës 1994 - 2003, shumën 320.000 lekë, e deklaruar qartësisht në DIPP-në e vitit 2003 si çmim blerje nën kolonën “vlehtë” dhe në kolonën “burimi”.

7.5 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimin se: (i) ka mospërputhje lidhur me vlerën e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, pasi në DIPP-në e vitit 2003, subjekti deklaroi çmimin në vlerën 320.000 lekë, ndërkohë që referuar kontratës nr. ***, datë 12.11.2002, ky automjet është blerë në vlerën 100.000 lekë; (ii) është e paqartë polica e sigurimit e prerë për periudhën 16.2.2012 – 15.2.2013, në emër të subjektit, ndërkohë që ky automjet është shitur në datën 23.12.2011 me kontratën nr. ***.

7.6 Subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime me shkrim lidhur me këto konstatime, por në seancën dëgjimore të datës 19.4.2021, lidhur me çmimin e automjetit, deklaroi se: “[...] *doja të shpjegoja pak edhe atë që nuk e kisha shpjeguar, rasti i makinës, e cila është deklaruar 320.000 lekë dhe në kontratë është blerë 100.000 lekë, nuk më kujtohet mirë, ka shumë vite, por brenda asaj shume 320.000 lekë duhet të jetë dhe pagesa e doganës, d.m.th. që, nuk jam i sigurt por që ky duhet të jetë, makina ka kushtuar 320,000 lekë me gjithë doganë [...]*”.

7.7 Në përfundim, në vijim të konfirmimit nga subjekti, çmimi i blerjes së automjetit, për efekt të analizës financiare, mbetet i pandryshuar në vlerën 320.000 lekë.

8. Gjendje cash në vlerën 600.000 lekë

8.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në arkë, në datën 20.1.2017, në vlerën 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare.

8.2 Për të analizuar, nëse deklarimi i gjendjes *cash* është deklaruar me vërtetësi, Komisioni mori në analizë deklaratimet periodike vjetore, si vijon: (i) *në DIPP-në e vitit 2003*, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 100.000 lekë në banesë me burim nga paga e tij dhe bashkëshortes, si dhe shumën 450.000 lekë në depozitë në Bankën e Kursimeve me burim nga paga e tij dhe bashkëshortes; (ii) *në DIPP-në e vitit 2004* subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 500.000 lekë; (iii) *në DIPP-në e vitit 2005* subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 950.000 lekë; (iv) *në DIPP-në e vitit 2006* subjekti ka deklaruar pakësuar gjendje *cash* në shumën 3.800.000 lekë; (v) *në DIPP-në e vitit 2007* subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësime/gjendje *cash*; (vi) *në DIPP-në e vitit 2008* subjekti ka deklaruar shtuar gjendje *cash* në shumën 1.450.000 lekë nga shitja e shtëpisë, paga e tij dhe bashkëshortes; (vii) *në DIPP-në e vitit 2009* subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* së bashku me kursimet e realizuara në vitin 2009 në shumën 2.000.000 lekë; (viii) *në DIPP-në e vitit 2010* subjekti ka deklaruar “*pasuri e luajtshme e kursyer nga paga dhe të ardhurat e biznesit të bashkëshortes në llogarinë time bankare dhe në mjete xhiro të njësisë biznesi bashkëshortes, gjithsej, në shumën 400.000 lekë*”; (ix) *në DIPP-në e vitit 2011* subjekti ka deklaruar “*shtesë cash dhe në llogarinë time në bankë nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes, si dhe nga mbyllja e biznesit*”.

të saj dhe shitja e artikujve të aktivitetit, shuma 1.450.000 lekë” Ndërkohë, djali i subjektit O.H. deklaroi “cash (lekë) kursime nga puna me kohë të pjesshme, kursime shumëvjeçare nga mosha 10 vjeç të hapura në moshën 20 vjeç (dhurata këto të të afërmeve në festa e gëzime familjare) në shumën 300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”; (x) në DIPP-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar “vlera 900.000 lekë, pakësuar gjendje cash dhe në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’, si dhe në llogarinë e bashkëshortes në BKT, pakësim ky që ka ardhur si rezultat i mbylljes së një pjese të kredisë të deklaruar më parë, dhënies dhuratë djalit tim në shumën 150.000 lekë për blerjen e një makine”. Djali i subjektit O.H. deklaroi “pakësuar lekë cash ato që kisha një vit më parë ato që mora gjatë këtij viti si rrjedhojë e punës me kohë të pjesshme dhe të marra dhuratë nga babai gjithsej, 500.000 lekë”; (xi) në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar “shitesë para në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’, në llogarinë e bashkëshortes në BKT dhe KESH, në vlerën 1.150.000 lekë”. Djali i subjektit O.H. deklaroi nuk ka ndryshime (faqja e parë e deklaratës së personit të lidhur); (xii) në DIPP-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar pakësim gjendje cash (arkë) në vlerën 240.000 lekë. Djali i subjektit O.H. deklaroi “shtuar lekët në llogaritë e mia në ‘Credins Bank’ dhe cash nga shitja e makinës dhe puna ime, në vlerën 600.000 lekë”; (xiii) në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar pakësim gjendje cash arkë në vlerën 32.277 lekë. Djali i subjektit O.H. deklaroi “pakësuar, para në arkë dhe bankë, vlera 50.000 lekë”; (xiv) në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar “gjendje në arkë në datën 31.12.2016, në shumën 600.000 lekë, shtesa 0 lekë”. Djali i subjektit O.H. deklaroi “pakësuar para në arkë dhe bankë si individ, në shumën 550.000 lekë”.

8.3 Referuar sa më lart, duke qenë se në disa prej viteve subjekti përfshin në deklaratimet e tij edhe likuiditetet në llogaritë bankare, Komisioni për llogaritë gjendjen e likuiditeteve cash (jashtë sistemit bankar) në fund të çdo viti kalendarik bazuar në deklaratat periodike vjetore dhe u krahasua me përgjigjen e subjektit në pyetësonin nr. 2.

8.4 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimin se ka mospërputhje lidhur më vlerën e likuiditeteve cash të deklaruara në deklaratat periodike vjetore dhe atyre të deklaruara në pyetësonin nr. 2 nga subjekti i rivlerësimit.

8.5 Subjekti i rivlerësimit, nuk dha shpjegime lidhur me këto konstatime.

8.6 Në përfundim, Komisioni çmon se këto mospërputhje konsiderohen si deklaram jo i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe e vë Komisionin në vështirësi për kontrollin e vërtetësisë së deklarameve, siç edhe ligji e kërkon, duke u gjendur në kushtet e germës “a”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe do të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

8.7 Për sa i përket ligjshmërisë së krijimit të kursimeve në vlerën 650.000 lekë, për të cilat janë deklaruar si burim krijimi të ardhurat familjare, Komisioni vlerëson se shtesat dhe pakësimet e këtyre kursimeve janë pasqyruar në analizën financiare sipas viteve, duke dhënë efektin financiar përkatës në secilën periudhë.

9. Gjendje në vlerën 64.863 lekë, në “Raiffeisen Bank”

9.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje mjete monetare cash në “Raiffeisen Bank” në datën 20.1.2017, në vlerën 64.863 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: të ardhurat familjare. Subjekti për vërtetimin e deklaramëve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵⁷

9.2 Referuar dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”⁵⁸, konfirmohet në emër të subjektit të rivlerësimit llogari page me gjendje 64.863 lekë në datën 20.1.2017, çelur në vitin 2005.

9.3 Nga hetimi administrativ kryesisht Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

10. Lidhur me huan dhënë shtetasit S.L.

10.1 Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 200.000 lekë, si interesa nga huaja dhënë personit fizik “****”, Skrapar. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura, nga interesat e huas dhënë shtetasit S. L. të realizuara gjatë vitit 2005 sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 25.3.2015. Shuma: 200.000 lekë*”.

Sipas kësaj deklarate noteriale të dorëzuar nga subjekti, shtetasi S.L., deklaron se ushtron aktivitet privat në fushën e tregtimit të artikujve të ndryshëm ushqimor me shumicë dhe pakicë, në Çorovodë, që nga viti 1997 dhe në vazhdim. Në vitin 2004-2005 ka marrë hua shumën prej 1.200.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit, në dy ose në tre këste, me interes 20 %. Në përfundim të afatit ka shlyer huan së bashku me interesin vjetor.

10.2 Sa më sipër citohet se huaja në shumën 1.200.000 lekë është marrë në vitet 2004-2005, ndërkohë që Komisioni konstaton se në deklaratat periodike vjetore të këtyre viteve subjekti nuk ka deklaruar as huan e dhënë dhe as kthimin e saj, në kundërshtim me germën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

10.3 Në procesverbalin e datës 18.3.2015 mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se ka qenë një marrëdhënie mirëbesimi, pasi me vëllanë e z. S.L. kanë qenë shokë shkolle. I ka dhënë hua të gjitha kursimet e tij, si ato *cash* edhe ato në depozitë bankare pas tërheqjes, këto veprime janë bërë gjatë vitit pa shkresë në kushtet e mirëbesimit.

10.4 Sa më lart, duke qenë se nuk mund të përcaktohej me saktësi periudha e dhënies dhe kthimit të huas, për efekt të analizës financiare, me anë të pyetësorit nr. 2 subjektit iu kërkua: (i) të specifikonte shumën e dhënë për secilin vit dhe burimin financiar të krijimit të shumës së dhënë hua prej tij; (ii) të specifikonte periudhën në të cilën i është kthyer kjo hua dhe burimin financiar të huamarrësit që ka shërbyer për kthimin e kësaj huaje; (iii) të deklaronte nëse janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e realizuara nga interesat dhe, në përfundim, të dorëzonte dokumentacion ligjor justifikues për të provuar deklaramët e tij.

10.5 Në përgjigje subjekti deklaron se shumën e dhënë hua shtetasit S.L. në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 dhe 2005, e ka deklaruar si para *cash*, duke deklaruar vetëm shtesat. Në deklarimin e parë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar dhe ka pasur shumën 100.000 lekë *cash* dhe shumën 450.000 lekë në Bankën e Kursimeve. Gjatë vitit 2004, ka deklaruar shtesë në shumën 500.000 lekë, e cila ka qenë rezultat i pagës së subjektit, pagës së

⁵⁷ Vërtetim datë 20.1.2017 nga “Raiffeisen Bank”, ku rezulton se Durim Hasa disponon llogari me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 64.863 lekë.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2019.

bashkëshortes dhe 55.000 lekë interesa bankare nga depozita e deklaruar. Shumën 450.000 lekë, e cila u nxor nga depozita + 100.000 lekë që ishin para *cash* në fund të vitit 2003 + 500.000 lekë të kursyera gjatë vitit 2004, në total 1.150.000 lekë ia ka dhënë hua shtetasit S.L. Nga kjo në fund të vitit 2005 ka përfituar një shtesë në shumën 200.000 lekë. Nuk ka pasur kontratë huaje formale dhe për këtë shkak nuk e ka deklaruar kontratën e huas. Këto të ardhura i ka deklaruar si gjendje *cash*.

10.6 Lidhur me shlyerjen, subjekti ka shpjeguar se shuma së bashku me interesat e deklaruarra i është kthyer gjatë vitit 2006. Subjekti vijon se nuk mund të përcaktojë datë në momentin e lidhjes prej tij të kontratës së sipërmarrjes për pasurinë apartament banimi të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. Për sa i përket burimeve financiare të huamarrësit, subjekti sqaron se burimi i financimit ka qenë aktiviteti tregtar i tij në fushën e tregtimit të artikujve ushqimorë me shumicë e pakicë që nga viti 1993. Në cilësinë e provës, subjekti ka dorëzuar ekstrakt historik të subjektit tregtar “****”, person fizik, me NIPT ***, ku konfirmohet se data e regjistrimit është më 1.4.1993 dhe statusi është aktiv.

10.7 Subjekti pohon se nuk i ka paguar detyrimet tatimore për interesat e fituara nga huaja, për shkak se nuk ka treguar vëmendjen e duhur dhe deklaroi se është i gatshëm që t’i paguajë.

10.8 Komisioni vlerëson se që të ardhurat e realizuara të kualifikohen si të ardhura të ligjshme, duhet të provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, të ardhurat e realizuara dhe interesat e huas në shumën 200.000 lekë, nuk do të konsiderohen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

10.9 Komisioni vëren se subjekti edhe pas shpjegimeve të dhëna në pyetësor, është kontradiktor në përgjigjet e tij dhe nuk deklaroi qartësisht vitin në të cilin është dhënë kjo hua.

Gjithashtu, ka mospërputhje në deklaramet periodike vjetore të subjektit dhe deklarimeve në pyetësorin nr. 2, pasi: (i) në DIPP-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 500.000 lekë. Ndërkohë që në pyetësorin nr. 2 deklaroi edhe shtesën në shumën 55.000 lekë interesa bankare nga depozita, pra, në total shumën 550.000 lekë; (ii) sipas deklarimeve në pyetësorin nr. 2, gjendja e likuiditeteve *cash* deri në fund të vitit 2004 është në shumën 1.150.000 lekë, ndërkohë që Komisionit i rezultoi në shumën 1.050.000 lekë. Nga njëra anë, subjekti deklaroi se shumën e akumuluar të kursimeve prej 1.150.000 lekë e ka dhënë hua dhe nga ana tjetër këto kursime i deklaroi si likuiditete *cash*⁵⁹, konkretisht, deklaroi likuiditetet *cash* në datën 31.12.2004 në shumën 1.050.000 lekë dhe në datën 31.12.2005 në shumën 1.804.898 lekë; (iii) sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin nr. 2, shuma e huas është në vlerën 1.150.000 lekë, ndërkohë sipas deklaratës noteriale të z. S.L. është në vlerën 1.200.000 lekë; (iv) më tej, referuar deklaratës noteriale, kjo hua i është dhënë shtetasit S.L. me këste gjatë periudhës 2004 – 2005. Por, Komisioni analizon se nëse subjekti i ka pasur këto kursime *cash* në fund të 2004-2005, kjo e bën të pamundur dhënien e huas me burime të ligjshme në vitin 2004 apo 2005.

⁵⁹ Referuar deklaramet të subjektit në pyetësorin nr. 2, përgjigje të pyetjes nr. 12.

10.10 Sa më sipër, rezulton se subjekti ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1.200.000 lekë, për sa kohë kursimet deklarohen si likuiditete *cash* si në fund të vitit 2004, ashtu dhe në fund të vitit 2005.

10.11 Në këto kushte, për efekt të analizës financiare, Komisioni nuk e paraqiti këtë marrëdhënie huaje, por pasqyroj në këtë analizë vetëm gjendjen e likuiditeteve *cash* bazuar në deklaratat periodike vjetore.

10.12 Më tej, Komisioni hetoi mbi konfliktin e mundshëm të interesit për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 8.3.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 30.3.2021, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar një çështje penale ndaj shtetasit S.L. Nga hetimi i Komisionit, u provua se ky shtetas është shok i subjektit dhe figuron në cilësinë e personit tjetër të lidhur, pasi në vitet 2004-2005, ka marrë një hua nga subjekti në vlerën 1.200.000 lekë dhe e ka kthyer atë bashkë me interesat e përlllogaritura në shumën 200.000 lekë.

10.13 Rezulton se në gjykimin e masës së sigurisë ndaj shtetasit S.L., akuzuar për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose e impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, organi i akuzës ka kërkuar vendosjen e masës “arrest në burg”. Ndërkohë që, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 2.11.2014, ka vendosur të vleftësojë të paligjshëm “arrestin në flagrancë” të këtij shtetasi, duke caktuar masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Ky vendim është ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 15.12.2014, ka vendosur caktimin si masë sigurie “arrest me burg” për shtetasin S.L. Gjykata e Apelit Vlorë në arsyetimin e saj, çmon se subjekti nuk ka vlerësuar drejt rrethanat e faktit, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, kur ka caktuar masën e sigurimit ndaj të dyshuarit S.L.

10.14 Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë në datën 7.5.2015.

10.15 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2004 dhe 2005, huan e dhënë në shumën 1.200.000 lekë, si dhe kthimin e saj, në kundërshtim me dispozitat e germës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. (ii) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1.200.000 lekë, për sa kohë kursimet deklarohen si likuiditete *cash* si në fund të vitit 2004 ashtu edhe në fund të vitit 2005. (iii) Ka mospërputhje në deklaratimet periodike vjetore të subjektit dhe deklaratimeve në pyetësonin nr. 2, lidhur me kursimet *cash* pasi: - sipas deklaratimeve në pyetësonin nr. 2, gjendja e likuiditeteve *cash* deri në fund të vitit 2004 është në shumën 1.150.000 lekë, ndërkohë që Komisionit i rezulton se në shumën 1.050.000 lekë. Nga njëra anë, subjekti deklaroi se shumën e akumuluar të kursimeve prej 1.150.000 lekë e ka dhënë hua dhe nga ana tjetër këto kursime i deklaroi si likuiditete *cash*⁶⁰, konkretisht deklaroi likuiditetet *cash* në datën 31.12.2004 në shumën 1.050.000 lekë dhe në

⁶⁰ Referuar deklaratimit të subjektit në pyetësonin nr. 2, përgjigje të pyetjes nr. 12.

datën 31.12.2005 në shumën 1.804.898 lekë; - sipas deklarimeve të subjektit në pyetësin nr. 2, shuma e huas është në vlerën 1.150.000 lekë, ndërkohë sipas deklaratës noteriale të z. S.L. në vlerën 1.200.000 lekë; - referuar deklaratës noteriale të shtetasit S.L., kjo hua është dhënë me këste gjatë periudhës 2004 – 2005. Por, nëse subjekti i ka pasur këto kursime *cash* në fund të 2004-2005, kjo e bën të pamundur dhënien e huas me burime të ligjshme në vitin 2004 apo 2005. (iv) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 200.000 lekë për të ardhurat e realizuara nga interesat e huas, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. (v) Subjekti nuk deklaroi qartësisht vitin në të cilin është dhënë huaja në vlerën 1.200.000 lekë.

10.16 Një provë tjetër e administruar pas mbylljes së hetimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, ishte dhe shkresa nr. *** prot., datë 30.3.2021, përmbajtja e të cilë iu relatuar subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore.

10.17 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës shpjegon se mes tij dhe shtetasit S.L. ka ekzistuar një kontratë huaje, kontratë e cila është përmbushur, duke u realizuar qëllimi i palëve. Subjekti vijon duke shpjeguar se kjo kontratë në kuptim të ligjit (Kodi Civil) nuk ka pasur shkaqe pavlefshmërie dhe se ligji nuk kërkon që një kontratë e tillë të bëhet detyrues me shkrim, por për efekt të provueshmërisë shkresa është e domosdoshme. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një marrëdhënie juridike civile të ligjshme të pranuar nga palët dhe që i ka dhënë pasojat e saj. Në kushtet kur për shkak të shumës së vogël, si dhe kohës kur ka ndodhur ky veprim juridik, në raport me të gjithë shoqërinë shqiptare, nuk është paguar tatim për të ardhurat në masën 20.000 lekë, kjo është shuma që Komisioni mund ta konsiderojë të paligjshme dhe ta zbresë nga e tëra, përfundon subjekti.

10.18 Më tej, në seancën dëgjimore të datës 19.4.2021, subjekti deklaroi: “[...] kanë kaluar gjithë këto vite dhe unë nuk jam shumë i sigurt se çfarë muaji ia dhashë, ama kur kam deklaruar në deklaratën vjetore që i kam kursyer kaq lekë *cash*, kam parasysh që këto lekët *cash* ishin te ai. Unë në fakt, u mundova që për ligjërimin e këtyre, megjithëse janë shumë, duhet të paguaja nja 200.000 lekë, por nuk munda, sepse sistemet sot nuk e pranonin, nuk mund të vendosja një *barcod* në bankë që unë të paguaja ato 20.000 lekë me qëllim që të mos isha me këtë çështje [...]”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.19 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

10.20 Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2004 dhe 2005, huan e dhënë në shumën 1.200.000 lekë, si dhe kthimin e saj, në kundërshtim me dispozitat e germës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, vërtetur kjo me deklaratat e interesave periode vjetore për vitet

2004 dhe 2005, të cilat përbejnë provë në kuptim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit 84/2016, i cili citon se: “*Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit*”.

10.21 Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1.200.000 lekë, për sa kohë kursimet deklarohen si likuiditete *cash* si në fund të vitit 2004 ashtu edhe në fund të vitit 2005, vërtetuar me deklaratat e interesave periode vjetore për vitet 2004 dhe 2005, të cilat përbejnë provë në kuptim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit 84/2016, i cili citon se: “*Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit*”. Ky vlerësim nga Komisioni mbështetet, më tej, edhe me mospërputhjen që rezulton midis deklaramit të subjektit në deklaramet periodike vjetore dhe të deklarimeve në pyetësin nr. 2, lidhur me kursimet *cash* gjatë hetimit ku evidentohet se: (i) sipas deklarimeve në pyetësin nr. 2, gjendja e likuiditeteve *cash* deri në fund të vitit 2004 është në shumën 1.150.000 lekë, ndërkohë që Komisionit i rezulton se në shumën 1.050.000 lekë. Nga njëra anë, subjekti deklaron se shumën e akumuluar të kursimeve prej 1.150.000 lekësh e ka dhënë hua dhe nga ana tjetër këto kursime i deklaron si likuiditete *cash*⁶¹, konkretisht deklaron likuiditetet *cash* në datën 31.12.2004 në shumën 1.050.000 lekë dhe në datën 31.12.2005 në shumën 1.804.898 lekë; (ii) sipas deklarimeve të subjektit në pyetësin nr. 2, shumata e huas është në vlerën 1.150.000 lekë, ndërkohë sipas deklaratës noteriale të z. S.L. në vlerën 1.200.000 lekë; (iii) referuar deklaratës noteriale të shtetasit S.L., kjo hua është dhënë me këste gjatë periudhës 2004 – 2005. Por, nëse subjekti i ka pasur këto kursime *cash* në fund të 2004-2005, kjo e bën të pamundur dhënien e huas me burime të ligjshme në vitin 2004 apo 2005.

10.22 Bazuar në vlerësimin e sipërpërmendur, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 200.000 lekë për të ardhurat e realizuara nga interesat e huas, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

10.23 Lidhur me konfliktin e interesit në gjykimin e kësaj çështje, subjekti i pyetur në seancën dëgjimore të datës 19.4.2021, ku u ftua për t’u dëgjuar lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit për vlerësimin e kriterit të pasurisë, deklaroi se dhënia e huas prej tij në vlerën 1.200.000 lekë, ka ndodhur shumë kohë më përpara se të gjykohej kjo çështje.

10.24 Në lidhje me konfliktin e interesit, Komisioni, në përfundim vlerëson se bazuar në germen “ë”, të nenit 17 “heqja dorë”, të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie. Në rastin konkret provohet lidhja mes subjektit dhe shtetasit S.L., ekzistenca e marrëdhënies së interesit mes tyre, si dhe favorizimi në vendosjen e masës së sigurisë ndaj këtij shtetasi, masë e cila është rrëzuar nga gjykatat e dy shkallëve më të larta.

10.25 Në përfundim, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për dhënien e huas dhe përfitimin e interesave, si dhe ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, duke u gjendur në

⁶¹ Referuar deklaramit të subjektit në pyetësin nr. 2, përgjigje të pyetjes nr. 12.

kushtet e germave “a”, “b” dhe “d”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

11. Lidhur me apartamentet në Çorovodë

11.1 Nga hetimi i Komisioni u konstatuan një sërë faktesh dhe rrethanash kontradiktore në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me apartamentet në pronësi ose posedim të tij në qytetin e Çorovodës, mospërputhje të cilat janë analizuar në vijim.

Fakte nga hetimi kryesisht

11.2 Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar që gjatë periudhës nëntor 1996 – gusht 2008 ka jetuar në apartamentin e tij në lagjen “***” në Çorovodë, ndërkohë që apartamenti me sip. 72 m² në lagjen “***” është blerë në datën 4.4.1999. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura *neto* të realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme (apartamente) në qytetin e Çorovodës, në shumën totale 2.538.200 lekë: (i) blerje apartamenti në shumën 500.000 lekë, me kontratën noteriale nr. ***, datë 4.4.1999, shitur në shumën 2.203.200 lekë, me kontratën nr. ***, datë 28.4.2008. Pagar taksa pasurie në vlerën 170.000 lekë. Të ardhura *neto* 1.533.200 lekë (2.203.200 – 500.000 lekë - 170.000 lekë); (ii) apartamenti me sip. 59 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, fituar me kontratë këmbimi pasurie të paluajtshme noteriale nr. ***, datë 29.4.2011, për apartamentin me sip. 52 m², nr. pasurie ***, blerë në shumën 800.000 lekë. Shitur apartamenti me sip. 59 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, shitur në shumën 1.805.000 lekë me kontratë noteriale e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 17.1.2013. Të ardhura *neto* 1.005.000 lekë (1.805.000 – 800.000).

11.3 Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka dorëzuar këto dy kontrata: (i) kontratë këmbimi pasurie e paluajtshme me nr. ***, datë 29.4.2011, e lidhur nëpërmjet palëve, nga njëra anë subjekti Durim Hasa dhe pala tjetër E., G. dhe M.D. për këmbimin e apartamentit me sip. 52 m², nr. pasurie ***, me çmim reference 829.192 lekë në pronësi të subjektit me apartamentin me sip. 59 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me çmim reference 940.814 lekë, në pronësi të palës tjetër kontraktore; (ii) kontratë shitjeje nr. ***, datë 17.1.2013, me kontratë nr. ***, me palë shitëse subjekti Durim Hasa dhe palë blerëse shtetasi R.H. për apartamentin me sip. 59 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në vlerën 1.805.000 lekë.

11.4 Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 kontratën e këmbimit të pasurive. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 18.3.2015, lidhur me këtë mosdeklarim, subjekti shprehet se në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar regjistrimin e banesës me sip. 59 m², të cilën e ka deklaruar në vitin 2008, blerë pa dokumente në vlerën 800.000 lekë. Kontrata e këmbimit nuk është deklaruar pasi nuk përbën fitim pasurie, as shtim as pakësim. Kjo kontratë nuk është shoqëruar me pagesa për sipërfaqe, por është ligjërimit i faktit të pronësisë.

11.5 Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Berat⁶², nuk figurojnë të dhëna lidhur me apartamentet e mësipërme.

11.6 Sa rezulton, Komisioni evidenton disa mospërputhje në deklaratime dhe fakte. Në këto kushte, me anë të pyetësorit nr. 2, kërkoi shpjegime dhe paraqitjen e provave përkatëse për çdo konstatim si vijon: (i) në datën 18.7.1996, subjekti ka blerë apartament 1+1, në lagjen “***”,

⁶²Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020.

Çorovodë, në vlerën 450.000 lekë. Ndërkohë që në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 nuk është deklaruar pronësia e këtij apartamenti, si dhe gjatë periudhës nëntor 1996 – gusht 2008 deklarohet jetesa në lagjen “****” dhe jo “****”; (ii) subjekti deklaron se gjatë periudhës nëntor 1996 – gusht 2008 ka jetuar në apartamentin e tij në lagjen “****” në Çorovodë. U kërkuan sqarime lidhur me jetesën në këtë apartament që prej nëntorit të vitit 1996, duke qenë se data e blerjes së apartamentit me sip. 72 m² në lagjen “****” rezultoi më 4.4.1999; (iii) në DIPP-në e vitit 2008 është deklaruar blerje apartamenti 1+1, në lagjen “****”, Çorovodë, në maj të vitit 2008, pa bërë dokumentet, në vlerën 800.000 lekë; (iv) në datën 29.4.2011, me kontratë këmbimi, subjekti ka shkëmbyer apartamentin me sip. 52 m² me apartamentin me sip. 59 m². Referuar kontratës së shkëmbimit, apartamenti i përfituar nga subjekti ka një sipërfaqe më të madhe (7 m²) dhe bazuar në çmimin minimal një vlerë prej 111.622 lekësh më e lartë. Subjektit iu kërkua të dorëzojë dokumentacion ligjor justifikues për pagesën e detyrimeve tatimore gjatë regjistrimit në ZVRPP; (v) apartamenti i përfituar nga këmbimi është shitur në datën 17.1.2013, në vlerën 1.805.000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 në shumën 1.800.000 lekë. Subjektit iu kërkua të dorëzojë dokumentacion ligjor justifikues për pagesën e detyrimeve tatimore mbi fitimin e realizuar nga shitja e apartamentit në vitin 2013. Sipas kontratës, pala shitëse deklaron se i është likuiduar çmimi i shitjes tërësisht jashtë zyrës noteriale, në kundërshtim me ligjin nr. 7829/1994 “Për Noterinë” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë/Ministrisë së Financave nr. 6915/2, datë 30.1.2012.

11.7 Në përgjigje të pyetëtorit nr. 2, subjekti deklaroi se: *“Dua të bëj një përshkrim historik për të kuptuar saktësinë e deklaratës së pasurisë së parë të bërë prej meje, në datën 15.3.2004. Në atë deklaratë unë saktësisht kam deklaruar pasurinë time të paluajtshme deri në datën 30.12.2003, e cila ishte një apartament banimi 2 + 1, i ndodhur në lagjen ‘***’, Çorovodë, blerë nga shtetasi B.Sh. në datën 4.4.1999, në vlerën 500.000 lekë. Përpara se të blija pasurinë e mësipërme, unë, në muajin korrik të vitit 1996, kam blerë nga shtetasi E.D. një pasuri 1+1 në lagjen ‘***’ të qytetit Çorovodë. Ky i fundit e kishte fituar këtë pasuri nga statusi i të pastrehëve nga Enti Kombëtar i Banesave dhe, për rrjedhojë, shtëpia nuk mund të shitej ligjërisht, deri në përfundimin e pagesës prej tij në Entin Kombëtar të Banesave. Shtetasi E.D. këtë shitje e ka bërë pasi ai në atë kohë kishte rënë dakord verbalisht që të blinte një shtëpi 1+1 në lagjen ‘***’ të qytetit të Çorovodës. Konkretisht ai kishte rënë dakord me shitësin L.K. që të blinte shtëpinë e tij me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 52 m². Në rrethanat e mësipërme, me qëllim garantimin e blerjes së bërë prej meje nga shitësi E.D. pa dokumente, deri në realizimin e pagesës prej tij në EKB, unë bëra kontratë formale me shitësin e shtëpisë në lagjen ‘***’, të cilën e vendosi në posedim E.D., kurse unë vetë vura në posedim pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, me sip. 59 m², e ndodhur në lagjen ‘***’, Çorovodë. Këtë shtëpi unë e bleva prej tij në shumën 370.000 lekë, shumë e cila i duhej atij për të blerë shtëpinë e tij në lagjen ‘***’, e cila formalisht më kaloi mua. Verbalisht kishim rënë dakord që kalimi i pronësisë në emër të secilit pronar do të bëhej me kontratë këmbimi. Këtë shtëpi të cilën unë e kisha blerë në shumën 370.000 lekë, në muajin korrik të vitit 1996, e kam shitur dhe lëshuar nga posedimi në muajin mars të vitit 1999. Blerësi ka qenë shtetasi I.Z. Ai e bleu këtë pasuri në vlerën 400.000 lekë dhe unë e kam garantuar se do t’i bëja dokumentacionin e shitjes menjëherë porsa shitësi im të bënte pagesën pranë EKB-së dhe dokumentacionin në emrin tim. Në datën 28.4.2008, me kontratë të rregullt noteriale i kam shitur blerësit Q.H. apartamentin*

*në pronësinë time 2+1 që ndodhej në lagjen '***', Çorovodë. Ky apartament ka nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 72 m². Në këtë kohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar ishte mbyllur dhe qëllimi i shitjes ishte largimi im nga ky qytet. Për këtë shkak dhe në kushtet kur banesës 1+1 në lagjen '***' nuk i ishin bërë dokumentet, blerësi i saj I.Z. ma ktheu sendin, duke ma shitur përsëri mua në vlerën 800.000 lekë. Ky është shkakun që unë në deklaratën periodike vjetore të plotësuar në datën 24.3.2009 kam deklaruar, përveç pakësimit të banesës 2+1, edhe shtimin e banesës 1+1, por pa dokumentacion. Në vitin 2011 pasi shitësi E.D. përfundoi pranë Entit Kombëtar të Banesave pagesën e banesës 1+1 që më kishte shitur mua në lagjen '***' të qytetit Çorovodë dhe e regjistroi atë në favor të tij, në datën 29.4.2011, midis meje dhe atij ashtu siç kishim rënë dakord u bë kontrata e këmbimit. Kjo kontratë nuk është deklaruar prej meje në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 e dorëzuar në datën 19.3.2012, por është përcaktuar në pikën 5 të faqes përkatëse se banesa e deklaruar më parë pa dokumente dhe e blerë në vlerën 800.000 lekë u regjistrua në favorin tim me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 59 m²".*

11.8 Subjekti, pas parashtrimit të bërë lidhur me pyetjet e Komisionit deklaroi si vijon: (i) në DIPP-në e vitit 2003 nuk është deklaruar pronësia e apartamentit 1+1, në lagjen "****", Çorovodë, pasi kjo pasuri nuk ka qenë kurrë e tija. Kontrata është lidhur për të garantuar blerjen e shtëpisë 1+1 në lagjen "****", Çorovodë. Nuk ka qenë kurrë pronar faktik i këtij sendi, nuk ka paguar për blerjen e tij dhe, për rrjedhojë, nuk posedon dokumentacion për burimet e blerjes së tij; (ii) në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar blerjen e një apartamenti në maj të vitit 2008 në shumën 800.000 lekë, pasi ka qenë i detyruar të blejë pasurinë që shiti për shkak se nuk mundi t'i përmbahej premtimit të dhënë se blerësit do t'i bënte dokumentet e shtëpisë. Për këtë shkak dhe për rrethanat e tregut, shtëpinë që e kishte shitur në vlerën 400.000 lekë në vitin 1999, e bleu në shumën 800.000 lekë, blerje të cilën e ka deklaruar. Burimi i të ardhurave ka qenë shitja e apartamentit 2+1 në lagjen "****", Çorovodë; (iii) lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore mbi fitimin e realizuar nga shitja e apartamentit në vitin 2013, deklaroi se në DIPP-në e vitit 2013 nuk ka deklaruar tatim-fitimin për fitimin e realizuar nga kjo shitje dhe nuk e ka paguar, pasi ka përfituar nga rivlerësimi i pasurisë. Pas aplikimit për rivlerësimin e kësaj pasurie ka paguar shumën 12.280 lekë, derdhur në "Raiffeisen Bank" për Degën e Thesarit. Pas shitjes së kësaj pasurie është tatuar fitimi prej 5.000 lekësh (që është diferenca e vlerës së shitjes me vlerën e apartamentit të rivlerësuar). Për këtë, në datën 18.1.2013, është paguar tatim në masën 500 lekë; (iv) lidhur me likuidimin jashtë zyrës noteriale të pagesës për shitjen e apartamentit me sip. 59 m², në datën 7.1.2013, subjekti sqaroi se sipas ligjit nr. 7829/1994, "Për noterinë" dhe në bazë të pikës 10 të udhëzimit nr. 6915/2, datë 30.1.2012, është përgjegjësi e noterëve dhe strukturave përgjegjëse zbatimi i këtij udhëzimi. Nga ana e noterit në vitin 2013 nuk i ishte kërkuar një gjë e tillë; (v) subjekti është pyetur lidhur me përdorimin e apartamentit në lagjen "****" duke qenë se deklaroi banesën në lagjen "****" gjatë periudhës nëntor 1996 – gusht 2008. Në përgjigje sqaron se përkundër shpjegimit të dhënë më sipër, banesa 1+1 në lagjen "****" nuk ka qenë e tija, por ka qenë gjithmonë në posedim të pronarit të saj E.D. Në periudhën 1996 – 1999, subjekti ka jetuar në banesën 1+1 në lagjen "****" dhe në periudhën 1999 – 2008 ka jetuar në banesën 2+1, po në lagjen "****", Çorovodë. Subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.1.2021, lëshuar nga z. I.Z. Vërtetim nga OSHEE-ja, ku vërtetohet se nuk ka pasur kontratë energjie në lagjen "****", por vetëm në lagjen "****", Çorovodë.

Kontratën e energjisë elektrike në lagjen “****” e ka pasur z. E.D. dhe pas shitjes së banesës i ka kaluar z. A.Ç. Po kështu, rezulton se nuk ka pasur kontratë energjie elektrike në kabinën 15 Çorovodë që është lagjja “****”, si dhe në këto dokumente del qartë se pas riblerjes së apartamentit 1+1 nga shtetasi I.Z. kontrata e energjisë elektrike i ka kaluar subjektit; (vi) subjekti është pyetur lidhur me deklarinimin se gjatë periudhës nëntor 1996 – gusht 2008 ka jetuar në apartamentin në lagjen “****” në Çorovodë, kur ndërkohë apartamenti në lagjen “****” me sip. 72 m² është blerë në datën 4.4.1999 dhe në përgjigje shpjegoi se në periudhën nëntor 1996 – maj 1999 ka jetuar në banesën 1+1 në lagjen “****”, Çorovodë, të cilën e kishte blerë pa dokumente ligjore dhe pas shitjes së saj, po pa letra, ka jetuar në banesën 2+1, të blerë po në lagjen “****”, Çorovodë. Të dy këto apartamente ishin në të njëjtin pallat në të njëjtën shkallë dhe me një kat diferencë. Subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.1.2021, lëshuar nga z. I.Z. (referuar kontratës së shkëmbimit subjekti ka përfituar një sipërfaqe më të madhe (7 m²), bazuar në çmimin minimal rezulton vlera prej 111.622 lekësh më e lartë. Subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për pagesën e detyrimeve tatimore gjatë regjistrimit në ZQRPP. Në përgjigje, subjekti deklaroi se kontrata e shkëmbimit ka qenë thjesht ligjërimit i pasurive që kishte secili pjesëtar në këtë kontratë. Në lidhje me pagesën e detyrimit tatimor ka aplikuar për regjistrim në datën 6.6.2011 dhe ka paguar tarifën që i është kërkuar pas llogaritjeve të bëra nga zyra e ZVRPP-së. Në rastet e shitblerjes së pasurive të paluajtshme, vetëm pasi kryhet pagesa e detyrimit tatimor nga pala shitëse, bëhet i mundur regjistrimi i pasurisë në emër të blerësit. Nëse këto detyrime nuk paguhen pranë Zyrës së Kadastrës nuk mund të ndryshohen titullarët e pronësisë.

Analiza e Komisionit

11.9 Nga deklarinimet e subjektit rezulton se ka blerë *de jure*: (i) në korrik të vitit 1996 apartamentin me sip. 52 m² (1+1) në lagjen “****”, në vlerën 450.000 lekë dhe ndërkohë *de facto* ka blerë apartamentin 59 m² (1+1) në lagjen “****” me çmim 370.000 lekë; (ii) në mars të vitit 1999, apartamentin me sip. 59 m² në lagjen “****” ia shet *de facto* z. I.Z. në vlerën 400.000 lekë; (iii) në datën 4.4.1999 (*de facto* dhe *de jure*) ka blerë apartamentin me sip. 72 m² (2+1), që ndodhej në lagjen “****” me çmim 500.000 lekë, të cilin e shiti në datën 28.4.2008, në vlerën 2.200.000 lekë; (iv) duke qenë se nuk arriti të bënte *de jure* dokumentet e apartamentit me sip. 59 m² në lagjen “****”, ia bleu *de facto* përsëri personit që ia shiti z. I.Z. në vlerën 800.000 lekë (pasi me kalimin e kohës vlera e apartamentit ishte rritur); (v) më pas, në datën 29.4.2011, apartamenti me sip. 59 m², në lagjen “****” i kaloi *de jure* subjektit dhe ai më pas e shiti në datën 17.1.2013, në vlerën 1.805.000 lekë.

11.10 *Lidhur me apartamentin me sip. 59 m² (1+1) në lagjen “****”* - në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar regjistrimin e banesës me sip. 59 m² në Çorovodë, në datën 6.6.2011, me kosto regjistrimi 15.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar pakësuar banesa 1+1 në Çorovodë, shitur shtetasve R.H. dhe A.C. në vlerën 1.800.000 lekë.

11.11 Sipas deklarinimeve të subjektit në pyetësorë, apartamenti është blerë në korrik të vitit 1996, në vlerën 370.000 lekë, shitur në vlerën 400.000 lekë dhe riblerë përsëri në vlerën 800.000 lekë. Më pas, me kontratën nr. ***, datë 17.1.2013, me palë shitëse Durim Hasa dhe palë blerëse R.H. dhe A.C., është shitur në vlerën 1.805.000 lekë.

11.12 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, në datën 17.1.2013, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është depozituar shuma 1.500.000 lekë me përshkrimin “***”.

11.13 Sipas dokumentacionit të dorëzuar në pyetësonin nr. 02, Komisioni vëren se referuar kartelës së pasurisë, subjekti, këtë apartament, e ka regjistruar në datën 6.6.2011. Më pas ka bërë rivlerësimin e kësaj pasurie të paluajtshme në datën 30.8.2012, nga ku rezulton se vlera e tregut sipas ekspertimit është 1.800.000 lekë dhe vlera në kontratën e shitblerjes është 572.000 lekë. Nga përlllogaritjet rezulton se tatimi për t’u paguar është 12.280 lekë [1.800.000 - 572.000 (çmimi minimal fiskal i vitit 2011 minus çmimi në kontratën e shitblerjes) = 1.228.000*1%]. Kjo pagesë është kryer në “Raiffeisen Bank” në datën 31.8.2012 për llogari të Degës së Thesarit.

11.14 Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.1.2021, z. I.Z. ka deklaruar se në vitin 1999 ka blerë nga shtetasi Durim Hasa një banesë 1+1 (në pallatin *** hyrësh) në lagjen “****”, Çorovodë, në shumën 400.000 lekë dhe ka jetuar aty deri në vitin 2008. Banesën e ka blerë pa dokumente, pasi ishte për t’u paguar me kredi dhe subjekti i kishte dhënë garanci për bërjen e dokumenteve formale të blerjes së kësaj pasurie. Në kushtet kur subjekti nuk i formalizoi dot dokumentet e shtëpisë dhe në vitin 2008 do të largohej nga Çorovoda, gjithashtu ai shiti edhe banesën që kishte në të njëjtën shkallë, të cilën ia rishiti subjektit pa dokumente në vlerën 800.000 lekë (për shkak të ndryshimeve të çmimit të tregut dhe disa riparimeve që kishte bërë).

11.15 Lidhur me apartamentin me sip. 52 m², në lagjen “**”** - sipas deklarimeve të subjektit është blerë në korrik të vitit 1996, në vlerën 370.000 lekë. Më pas, ky apartament është shitur në shumën 900.000 lekë (likuiduar jashtë zyrës noteriale) me kontratën nr. ***, datë 9.9.2013, me palë shitëse z. E.D. dhe palë blerëse z. A.Ç. Referuar certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 18.9.2013, kjo pronë figuron e regjistruar në emër të z. A.Ç. Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, me shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2017, ZVRPP-ja Skrapar konfirmon se subjekti ka blerë me kontratën nr. ***, datë 18.7.1996, me palë shitëse L. dhe L.K. apartamentin me sip. 52 m², 1+1, në lagjen “****”, Çorovodë me çmim 450.000 lekë. Dhe më pas, me kontratën e këmbimit nr. ***, datë 29.4.2011, ky apartament i ka kaluar shtetasit E.D. (doc. arkivuar me nr. ref ***).

11.16 Për të provuar deklaratimet e tij lidhur me ngjarjet dhe rrethanat e pretenduara, subjekti ka dorëzuar si provë dokumente të nxjerra nga OSHEE-ja: (i) dokument me emërtim “detajet e pagesës së konsumatorit”, sipas së cilës kontrata nr. *** figuron në emër të shtetasit Durim Hasa, kabina *** Çorovodë, nënstation ***, data e fillimit të furnizimit 15.7.2005; (ii) listën e konsumatorëve privatë dhe familjarë të kabinës 15, ku pasqyrohet edhe emri i shtetasit I.Z., numri i kontratës së vjetër ***; (iii) dokument me emërtim “detajet e pagesës së konsumatorit”, sipas të cilit kontrata nr. *** figuron në emër të shtetasit A.Ç., kabina *** Çorovodë, nënstation ***, data e fillimit të furnizimit 17.1.2007; (iv) faturë tatimore lëshuar nga OSHEE-ja, muaji gusht 2008, nr. kontrate ***, kabina *** Çorovodë, në emër të shtetasit E.D.; (v) faturë tatimore lëshuar nga FSHU-ja, muaji dhjetor 2020, kontratë nr. ***, kabina *** Çorovodë, në emër të shtetasit A.Ç.

11.17 Më tej, subjekti shpjegoi: “Me këto dokumente vërtetohet se unë nuk kam pasur kontratë energjie në lagjen ‘***’, por vetëm në lagjen ‘***’. Kontratën e energjisë në lagjen ‘***’ e ka

*pasur E.D. dhe pas shitjes së banesës i ka kaluar A.Ç. Po kështu, nga këto dokumente rezultojnë se unë kam pasur kontratë energjie në kabinën *** Çorovodë që është lagja ‘***’, si dhe në këto dokumente del qartë se pas riblerjes së apartamentit 1+1, nga shtetasi I.Z. kontrata e energjisë më ka kaluar mua”.*

11.18 Komisioni analizoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti dhe konstatoi se në asnjë rast nuk përcaktohet se cilës adresë i përkasin kabinat e përmendura.

11.19 Ndërkohë që, në dokumentacionin e përcjellë nga OSHEE-ja⁶³ subjekti figuron abonent me kontratë furnizimi energjie elektrike nr. ***, e hapur në datën 15.7.2005, në lagjen “***”, çka bie në kundërshtim me deklarinimin e subjektit se ai nuk ka pasur kontratë energjie elektrike në këtë lagje.

11.20 Gjithashtu, Komisioni kërkoi praktikën/dosjen e plotë të privatizimit të kësaj pasurie⁶⁴ dhe në dokumentacionin e përcjellë nga EKB-ja⁶⁵ rezultojnë se shtetasi E.D., kategorizohet i pastrehë dhe me autorizimin datë 4.4.1996, të Bashkisë Çorovodë, i është dhënë apartamenti 1+1, në lagjen “***”, në datën 11.4.1996, ku ky shtetas ka lidhur me EKB-në Skrapar kontratën e përkohshme për shitjen e këtij apartamenti, sipas së cilës blerësi do të paguajë shumën 30.000 lekë si paradhënie mbështetur në urdhrin nr. 210, datë 1.4.1996, të EKB-së.

11.21 Më pas, në datën 2.3.2011, shtetasi E., G. dhe M.D., në cilësinë e palës blerëse, kanë lidhur me EKB-në, kontratën nr. *** për blerjen e këtij apartamenti dhe kanë paguar gjithsej shumën 572.000 lekë⁶⁶.

11.22 Sa më sipër rezultojnë se shtetasi E.D., në datën 11.4.1996, ka lidhur kontratën e përkohshme për shitjen e këtij apartamenti, i cili nga dokumentacioni i administruar rezultojnë në vlerën 572.000 lekë. Referuar nenit 6, të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” përcaktohet se shlyerja e tarifës mund të bëhet në mënyrë të njëhershme ose me këste.

11.23 Komisioni vëren se çmimi i paguar nga shtetasi E.D. për EKB-në (vlera 572.000 lekë) është 55% më i lartë (ose vlera 202.000 lekë) se çmimi me të cilin shtetasi E.D. ia ka shitur subjektit (vlera 370.000 lekë bazuar në deklarinimet e subjektit).

11.24 Në kushtet kur: (i) nuk ekziston dokumentacion ligjor që të provojë vullnetin e palëve për sa i përket çmimit të shitjes; dhe (ii) çmimi me të cilin deklarohet se e ka blerë subjekti është shumë më i ulët në krahasim me çmimin me të cilin e ka blerë personalisht shtetasi E.D. në të njëjtin vit, Komisioni nuk u bind lidhur me vlerën reale me të cilën subjekti e ka blerë këtë apartament.

11.25 Sa më sipër, për efekt të analizës financiare Komisioni konsideroi kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 18.7.1996 dhe përfshiu në analizën financiare të periudhës 1994 – 2003 në

⁶³Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2019.

⁶⁴Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021.

⁶⁵Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021.

⁶⁶Në datën 28.2.2011 ka paguar vlerën 520.000 lekë, në datën 9.6.1999 me dokumentin nr. *** ka paguar vlerën 22.000 lekë, sipas kartelës së kthimit të kredisë deri në datën 11.4.1996 ka paguar vlerën 30.000 lekë.

paragrafin 1.16 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht vlerën 450.000 lekë si shpenzim për blerje apartamenti.

11.26 Komisioni nuk mori në konsideratë transaksionet e shitjes së këtij apartamenti midis subjektit dhe shtetasit I.Z., për sa kohë nuk ka dokumentacion ligjor që provon këtë transaksion dhe, për rrjedhojë, nuk e paraqiti si të ardhur shumë 400.000 lekë në vitin 1999.

11.27 Në konkluzion, lidhur me pasaktësitë në deklaratime, Komisioni vlerëson se referuar germa “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, subjekti mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, pra në rastin konkret në DIPP-në e vitit 2003, subjekti duhet të kishte deklaruar transaksionet e kryera për apartamentin me sip. 52 m², në lagjen “****” dhe përdorimin e apartamentit me sip. 59 m² (1+1) në lagjen “****”.

11.28 Sa më sipër rezulton, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar tagrat e pronarit të apartamentit me sip. 59 m², në lagjen “****” dhe apartamentit me sip. 52 m², në lagjen “****”, në Çorovodë, në kushtet kur nuk mund të sillej si pronar, pasi ndodhej në mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për posedimin *de jure* të këtyre apartamenteve. Konstatohet se gjatë kësaj kohe subjekti ka kryer transaksione për blerjen dhe shitjen e tyre, gjë që bie në kundërshtim me ligjin dhe Kodin e Etikës së një magjistrati. Gjyqtari, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, duhet të shmangë çdo sjellje të papërshtatshme dhe veprimet që mund të dëmtojnë ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij morale.

11.29 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 transaksionet e kryera për blerjen e apartamentin me sip. 52 m², në lagjen “****” dhe përdorimin e apartamentit me sip. 59 m² (1+1) në lagjen “****”, në kundërshtim me germën “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 kontratën e këmbimit të pasurive; (iii) subjekti i rivlerësimit ka ushtruar tagrat e pronarit të apartamentit me sip. 59 m², në lagjen “****” dhe apartamentit me sip. 52 m², në lagjen “****”, në Çorovodë, në kushtet kur nuk mund të sillej si pronar, pasi ndodhej në mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për posedimin *de jure* të këtyre apartamenteve. Konstatohet se gjatë kësaj kohe subjekti ka kryer transaksione për blerjen dhe shitjen e tyre, gjë që bie në kundërshtim me ligjin dhe Kodin e Etikës së një magjistrati.

11.30 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, deklaroi se nuk ka qenë kurrë pronar faktik i apartamentit 1+1, në lagjen “****” dhe nuk ka paguar për blerjen e tij. Në shpjegimet e dhëna para Komisionit deklaroi se ka paraqitur prova⁶⁷ që tregojnë se nuk ka qenë kurrë pronar *de facto* i kësaj pasurie dhe as posedues i saj. Kontrata e ndërrimit provon faktin që subjekti e ka deklaruar. Komisioni duhet ta vlerësojë rastin në kushtet e kohës kur janë kryer veprimet. Banesa 1+1 në lagjen “****” është blerë pa dokumente nga shtetasi E.D. Ky i fundit e kishte përfituar atë me statusin e të pastrehëve dhe donte të blinte një banesë tjetër në lagjen “****”, për shkak të afërsisë me prindërit dhe vëllezërit e tij. Për të garantuar blerjen e bërë, subjekti

⁶⁷Kontrata e këmbimit nr. ***, datë 29.4.2011, si dhe faturat e konsumit të energjisë elektrike që tregojnë se posedues i apartamentit në lagjen “****” ka qenë shtetasi E.D.

bleu banesën e tij deri në momentin që do të paguante kredinë në Entin Kombëtar të Banesave dhe më pas do ta ndërronin, ashtu edhe siç edhe vepruan. Po kështu, Komisioni duhet të marrë në konsideratë edhe kohën kur janë bërë veprimet. Transaksionet e shitjeve dhe blerjeve të bëra të vlerësohen në raport me kohën që janë bërë, si dhe ato nuk kanë cenuar etikën e magjistratit dhe nuk mund të konsiderohen të tilla. Subjekti deklaron se në atë kohë kishte një përvojë vetëm 2-vjeçare si gjyqtar dhe natyrisht që në ditët e sotme do të sillej ndryshe.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.31 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

11.32 Komisioni çmoi të marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit lidhur me shitblerjet e apartamentit 1+1, në lagjen “****”, Çorovodë, në vlerën 450.000 lekë. Këto deklarime u morën në konsideratë mbështetur në: (i) kontratën e këmbimit datë 29.4.2011, sipas së cilës subjekti ka shkëmbyer apartamentin me sip. 52 m² me apartamentin me sip. 59 m²; (ii) apartamenti i përfituar nga këmbimi është shitur në datën 17.1.2013, në vlerën 1.805.000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 në shumën 1.800.000 lekë; (iii) subjekti ka deklaruar jetesën gjatë periudhës nëntor 1996 – gusht 2008 në apartamentin e tij në lagjen “****”, Çorovodë; (iv) në DIPP-në e vitit 2008 është deklaruar blerje apartamenti 1+1, në lagjen “****”, Çorovodë, në maj të vitit 2008, pa bërë dokumentet, në vlerën 800.000 lekë.

11.33 Për rrjedhojë, analiza financiare për periudhën 1994 – 2003 rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 375.482 lekë për blerjen e pasurive, shtimin e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

11.34 Gjithashtu, për këto transaksione jo të provuara me dokumentacion ligjor, por vetëm deklarative, Komisioni vlerëson se ato tregojnë se subjekti i rivlerësimit si gjyqtar dhe njeri i ligjit nuk i ka kushtuar rëndësi anës formale/ligjore, por ka vepruar në një mënyrë jo të denjë për një magjistrat, i cili duhet të jetë i pari në dhënien e shembullit se dokumentacioni ligjor ka rëndësi, sidomos në pozicionin e një magjistrati, i cili duhet të sillet dhe veprojë me korrektësi dhe në përputhje me ligjin, duke shmangur çdo dyshim mbi krijimin e pasurisë dhe të të ardhurave, gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

PASURITË E DJALIT TË SUBJEKTIT O.H.

12. Ortak dhe aksioner i shoqërisë “**” sh.p.k., me NIPT ***, vlera 500.000 lekë**

12.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur O.H. ka deklaruar se është ortak dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***. Shoqëria ka filluar aktivitetin në datën 12.4.2016 me krijimin e shoqërisë, kapitali fillestar në mjete monetare ka qenë 500.000 lekë,

aksione të cilat zotërohen plotësisht nga ortaku i vetëm O.H. Gjendja e mjeteve monetare datë 23.1.2017 është 303.862.56 lekë.

12.2 Si burim krijimi deklarohen të ardhurat nga puna ndër vite me kohë të pjesshme dhe me kohë të plotë.

12.3 Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶⁸.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht

12.4 Referuar informacionit të përcjellë nga QK-ja⁶⁹, shtetasi O.H. është administrator dhe ortak zotërues 100% i kuotave të kapitalit në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “***”, pajisur me NIPT ***, datë 12.4.2016, me zyra qendrore në lagjen “***”, rruga “***”, pallati nr. ***, shk. nr. ***, k. ***, ap. nr. ***, Berat. Më tej, në datën 21.2.2017 kjo shoqëri ka kaluar në status të pezulluar.

12.5 Në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2016, personi i lidhur/djali i subjektit ka deklaruar: *“Krijuar/shtuar shoqëria ‘***’ sh.p.k. me kapital në mjete monetare me vlerë të aksioneve 500.000 lekë, zotëruar tërësisht nga ortaku i vetëm O.H. Vlera e mbetur e mjeteve monetare në llogari në datën 31.12.2016 është 323.930,56 lekë”*.

12.6 Drejtoria Rajonale Tatimore Berat⁷⁰, lidhur me xhiron dhe fitimin e vetëdeklaruar nga tatimpaguesi ndër vite, sipas sistemit c@ts për vitin 2016 ka rezultuar një humbje në shumën 76.563 lekë, ndërsa për vitin 2017 nuk ka deklarime.

12.7 Sa më sipër, në analizën financiare u përfshinë në gjendjen e llogarive bankare edhe llogaritë e shoqërisë “***” sh.p.k., ndërsa si shpenzim u pasqyrua shuma 76.563 lekë për vitin 2016 dhe 39.652 lekë për vitin 2017. Kjo e fundit rezultoi nga shuma e kreditimeve në llogarinë bankare të “Raiffeisen Bank”, që kishin të bënim me pagesa të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, taksa të bashkisë dhe komisione.

13. Automjetet tip “Mercedes-Benz”, vlera 500.000 lekë

13.1 Në DIPP-në e vitit 2012, personi i lidhur O.H. ka deklaruar blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 1999, me kontratën nr. ***, datë 13.4.2012, në vlerë 500.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur O.H. ka deklaruar pakësohet automjeti tip “Mercedes-Benz”, shitur me kontratën nr. ***, datë 9.9.2014, në vlerën 4.000 euro, shtetasit G.H. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, personi i lidhur O.H. ka deklaruar të ardhura nga transaksionet e blerjes dhe shitjes së automjetit: blerë automjeti tip “Mercedes-Benz” me kontratë nr. ***, datë 13.4.2012, në shumën 500.000 lekë dhe shitur me kontratën nr. ***, datë 9.9.2014, në

⁶⁸Vërtetim nr. ***, datë 25.10.2016, nga DRT-ja Berat për subjektin “***” me NIPT ***, me administrator O.H., regjistruar në DRT-në Berat në datën 12.4.2016 me status ligjor sh.p.k., me status aktiv, nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” datë 23.1.2017, për subjektin “***” sh.p.k., me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 303.862 lekë.

⁶⁹Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2019.

⁷⁰Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2019.

shumën 4.000 euro ose 560.000 lekë (4000 * 140 lekë/euro) fituar shuma 60.000 lekë dhe ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues⁷¹.

13.2 Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja⁷² rezulton se personi i lidhur O.H. ka pasur të regjistruar automjetin me targa *** dhe aktualisht ka në pronësi automjetin me targa ***.

13.3 Automjeti me targa *** është blerë me kontratën nr. ***, datë 13.4.2012, me palë shitëse Q.Sh., si dhe subjekti ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 1999, në vlerën 500.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Më pas, ky automjet është shitur me kontratën nr. ***, datë 9.9.2014, në shumën 4.000, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Automjeti tip “Touareg” me targa *** është blerë pas deklaratës *Vetting* me kontratën nr. ***, datë 7.10.2017, me palë shitëse shtetasin V.D., në vlerën 4.000 euro.

13.4 Lidhur me të ardhurat e deklaruara në vlerën 60.000 lekë nga transaksionet e blerjes dhe shitjes së këtij automjeti, Komisioni vëren se në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁷³ nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti në vlerën 60.000 lekë dhe për këtë arsye vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar. Për këtë arsye, në analizën financiare të vitit 2017, u pasqyruan të ardhura nga shitja të barabarta me koston e blerjes.

13.5 *Lidhur me blerjen e automjetit në vitin 2012 nga djali i subjektit* - në DIPP-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar: “Vlera 900.000 lekë, pakësuar lekë cash dhe në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’ dhe në llogarinë e bashkëshortes në BKT, pakësim ky që ka ardhur si rezultat i mbylljes së një pjese të kredisë të deklaruar më parë, dhënies dhuratë djalit tim 150.000 lekë për blerjen e një makine”. Djali i subjektit O.H. deklaroi: “Pakësuar lekë cash ato që kisha një vit më parë ato që mora gjatë këtij viti si rrjedhojë e punës me kohë të pjesshme dhe të marra dhuratë nga babai gjithsej, 500.000 lekë”.

13.6 **Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e pasurive dhe shtesën e kursimeve në vitin 2012, në shumën 284.793 lekë; (ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti për shumën e përfituar prej 60.000 lekësh.

⁷¹Kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 13.4.2012, me palë shitëse Q.Sh. dhe palë blerëse O.H., për blerje automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 500.000 lekë, kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 9.9.2014, shitës O.H., të automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 4.000 euro.

⁷²Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2019.

⁷³Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2019.

13.7 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime apo prova lidhur me konstatimin e Komisionit për mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti për shumën e përfituar prej 60.000 lekësh.

13.8 Për sa i përket mungesës së burimeve financiare për vitin 2012 në vlerën 284.793 lekë, subjekti paraqiti pretendimet e tij lidhur me të ardhurat nga qiraja dhe të ardhurat nga punësimi i djalit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

13.9 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

13.10 Lidhur me fitimin e realizuar nga shitja e këtij automjeti, Komisioni, në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë, ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”*.

13.11 Nën dritën e sa më sipër, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit) nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

13.12 Në përfundim, Komisioni vlerëson se shuma prej 60.000 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes, nuk duhet të konsiderohet si e ardhur në analizën financiare, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

13.13 Lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 284.793 lekë për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2012, pretendimet e subjektit, lidhur me të ardhurat nga qiraja dhe nga punësimi i djalit, nuk u morën në konsideratë nga Komisioni, siç u arsyetua në paragrafët përkatës.

13.14 Për këtë arsye Komisioni arrin në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 284.793 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve gjatë vitit 2012, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

14. Të ardhurat e djalit - deklaruar në deklaratën *Vetting*

14.1 Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur/djali i subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura të deklaruar gjatë vitit 2011 në shumën 300.000 lekë. Burimi i krijimit: Nga kursimet vjeçare*

(dhuruar nga familjarët dhe të afërm për ditëlindje e festa = 175.000 lekë) si dhe puna me orar të redaktuar gjatë pushimeve të verës për periudhën 2008 – 2011 (në shumën 125.000 lekë)”.

14.2 Në DIPP-në e vitit 2011 personi i lidhur/djali i subjektit ka deklaruar: *“(1) Punë me kohë të pjesshme, gjatë verës me kohë të plotë në vlerën 100.000 lekë; (2) loto sporti në vlerën 20.000 lekë; (3) dhuratat e marra nga moshë 10 vjeç nga gjyshërit, xhaxhallarët, hallat, dajat, tezet dhe të afërm të tjerë në të kursyera në arkën time në familje të hapur në moshën 20-vjeçare, shuma 175.000 lekë”.*

14.3 Në pyetësorin nr. 2, ku subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues lidhur me të ardhurat nga punësimi, shpjegoi se djali i tij ka punuar gjatë verës si kamerier dhe për shkak të informalitetit nuk mund të paraqesë dokument.

14.4 **Sa më sipër, rezulton** se punëmarrësi ka qenë në dijeni të faktit që ishte i punësuar në mënyrë jo të rregullt dhe paga e tij nuk tatohej, duke iu shmangur kështu detyrimeve tatimore, si dhe mospagimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pavarësisht se këto detyrime i takojnë punëdhënësit⁷⁴ dhe nuk është përgjegjësi e punëmarrësit. Bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se: *“[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...], për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kriteret, që: (i) janë deklaruar; dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi⁷⁵”.* Për këtë arsye të ardhurat në shumën 125.000 lekë nuk u konsideruan në analizën financiare.

14.5 Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur/djali i subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura në vitin 2012, në shumën 200.000 lekë. Burimi i krijimit: dhuruar nga prindërit në mjete monetare 150.000 lekë, si dhe puna me kohë të reduktuar gjatë vitit 2012, në shumën 50.000 lekë”.*

14.6 Në DIPP-në e vitit 2012, personi i lidhur O.H. ka deklaruar: *“Pakësim cash (nga ato që kisha një vit më parë, ato që mora gjatë këtij viti si rrjedhojë e punës me kohë të pjesshme dhe të marra dhuratë nga babai) në vlerën 500.000 lekë. Të ardhura nga puna gjatë verës me kohë të pjesshme 50.000 lekë”.*

14.7 Komisioni pasqyroj në analizën financiare shumën 150.000 lekë edhe si të ardhur, edhe si shpenzim, ndërkohë që të ardhurat e realizuara nga puna informale në shumën 50.000 lekë nuk do të konsiderohen në analizën financiare.

14.8 Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur/djali i subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura nga paga gjatë vitit 2014 të punuar në shoqërinë ‘***’, në shumën 300.000 lekë dhe të ardhura në vitin 2015 nga puna informale në *** dizenjime dhe shërbime interneti në shumën 240.000 lekë”.* Në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur O.H. ka deklaruar: *“... shtuar lekë në llogaritë e mia në ‘Credins Bank’ dhe cash nga shitja e makinës dhe puna në vlerën 600.000 lekë”.* Të ardhura nga puna si specialist hostimi dhe administrator sistemi në shoqërinë “***” në vlerën 300.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur O.H. ka deklaruar: *“... pakësuar para*

⁷⁴Të zbrësë nga paga dhe të paguajë në organet përgjegjëse tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

⁷⁵Vendimi nr. 23/2020 i KPA-së.

në arkë dhe bankë, vlera 50.000 lekë, hostime dizenjime dhe shërbime interneti në vlerën 240.000 lekë”.

14.9 Në pyetësin nr. 2, ku subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues lidhur me këto të ardhura, shpjegoi se djali i tij ka punuar gjatë periudhës 9.12.2013 – 30.4.2015 pranë shoqërisë “****” sh.p.k. si specialist hostimesh dhe administrator rrjeti. Më tej, subjekti shpjegon se djali i tij në këtë shoqëri ka filluar punë për herë të parë në profesion dhe nuk është siguruar dhe, për këtë arsye, ka qenë i detyruar lidhur me deklarin e këtyre të ardhurave, por duke qenë se ato janë realizuar, është ndërjerë i detyruar t’i pasqyrojë. Pas muajit prill të vitit 2015, djali i tij ka vazhduar punë në dizejimin e disa faqeve web si i pavarur deri në fund të periudhës së deklarin. Si dokumentacion provues, subjekti ka paraqitur disa e-maile të shkëmbyera gjatë ushtrimit të kësaj pune për periudhën dhjetor 2013 – prill 2015.

14.10 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti deklaroi se të ardhurat e realizuara nga punësimi i djalit të tij janë deklaruar për faktin se kanë qenë hyrje në buxhetin familjar. Lidhur me ligjshmërinë e tyre në kushtet e mosdeklarimit si i punësuar dhe mospagimin e kontributeve shoqërore e lë në vlerësimin e Komisionit. Këtë punë djali e ka kryer në fillimet e tij për hir të profesionit që ka. Ka qenë detyrë e punëdhënësit të tij dhe e strukturave shtetërore që ta regjistronin atë si punëmarrës. Këto të ardhura janë realizuar dhe janë fryt i punës së tij, pjesë e të ardhurave të familjes.

Vlerësimi i Komisionit

Duke qenë se këto të ardhura nuk konsiderohen të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk i pasqyroi në analizën financiare.

Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti, përfituar nga qiraja e njësisë

14.11 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga qiraja për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, L., Tiranë, njësi shërbimi, për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016. Shuma 1.320.000 lekë*”. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues⁷⁶.

14.12 Në deklaratat periodike vjetore subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP-në e vitit 2011 *pakësohet, biznesi i bashkëshortes mbyllur dhe lënë me qira dyqani në datën 15.12.2011. Kontratë qiraje midis palëve, qiramarrëse T.C., vlera e qirasë 25.000 lekë/muaj*; (ii) në DIPP-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar *të ardhura të fituara nga qiraja filluar në fund të vitit 2011, vlera 300.000 lekë*; (iii) në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar *të ardhura realizuara nga qiraja e deklaruar më parë, vlera 300.000 lekë*; (iv) në DIPP-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar *të ardhura të realizuara nga qiraja e pasurisë e deklaruar më parë, vlera 240.000 lekë*; (v) në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar *të ardhura të realizuara nga qiraja e pasurisë e deklaruar më parë, vlera 240.000 lekë*; (vi) në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar *të ardhura të realizuara nga qiraja e pasurisë e deklaruar më parë, vlera 240.000 lekë*.

⁷⁶(1) kontratë qiraje datë 15.12.2011, me palë qiradhënëse Durim dhe V.H. dhe palë qiramarrëse T.Ç. për dhënie me qira njësi tregtare me sip. 32.5 m², gjithashtu edhe sende të luajtshme (frigorifer, tavolina dhe raftë), afati 3 vjet, në vlerën mujore 25.000 lekë; (2) kontratë qiraje nr. ***, datë 26.10.2015.

14.13 Sa më sipër, shuma e deklarimeve vjetore 2012 – 2016 përputhet me shumën e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

14.14 Në pyetësonin standard, në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, subjekti shpjegoi se ka qenë detyrë e biznesit që të paguante tatimin mbi të ardhurat dhe se nuk është në dijeni nëse ky tatim është paguar.

14.15 Në vijim, Komisioni analizoi të ardhurat nga qiraja të ndara për secilin qiramarrës.

14.16 *Lidhur me të ardhurat nga qiraja për periudhën 15.12.2011 – 30.9.2015*, subjekti ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* një kontratë qiraje datë 15.12.2011, jonoteriale, me palë qiradhënëse Durim dhe V.H. dhe palë qiramarrëse T.Ç. për dhënie me qira njësi tregtare me sip. 32.5 m², gjithashtu dhe sende të luajtshme (frigorifer, tavolina dhe rafte), afati 3 vjet, në vlerën mujore 25.000 lekë.

14.17 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar disa urdhërtransferta të BKT-së, të printuara nga sistemi *online*, ku vërehet se mbajtësi i llogarisë, shtetasi D.C., ka kryer pagesa për faturat e abonentit me kontrate nr. ***, në emër të shtetasit F.D. dhe një faturë tatimore të lëshuar nga OSHEE-ja në emër të shtetasit F.D. për muajin korrik 2015.

14.18 Me anë të pyetësonit nr. 4, subjektit iu kërkua të shpjegojë se përse kontrata e OSHEE-së për këtë njësi figuron në emër të shtetasit F.D., ndërkohë që pala qiramarrëse rezulton znj. T.Ç., si dhe të sqarojë lidhjen me këtë shtetas. Në përgjigje, subjekti deklaroi se shtetasin F.D. nuk e njeh, por kur ka lidhur kontratën e blerjes së njësisë nga shitësi I.Sh. është vënë në dijeni se kontrata me OSHEE-në ishte lidhur me një person tjetër, i cili ishte z. F.D. Subjekti nuk e ka ndryshuar këtë kontratë dhe pagesat e energjisë elektrike në këtë njësi janë paguar prej tij deri në fund të vitit 2011 dhe më pas nga qiramarrësit që kanë qenë posedues të kësaj njësie. Si fillim ka dashur të ndryshojë kontratën, duke e kaluar në emrin e tij, por pasi është njohur me procedurat burokratike të ndryshimit dhe duke parë faktin që nuk kishte asnjë problem lidhur me pagesat dhe furnizimin me energji elektrike kjo kontratë nuk është ndryshuar edhe sot.

14.19 Komisioni kërkoi informacion pranë FSHU-së lidhur me këtë numër kontrate dhe në përgjigje⁷⁷ informojnë se kjo kontratë është hapur në datën 19.2.2007 dhe i përket abonentit F.D., duke bashkëlidhur listën e faturimeve për këtë abonent dhe datën e pagesave.

14.20 Në pyetësonin nr. 2 subjekti dorëzoi një vërtetim të lëshuar nga Bashkia Tiranë, Njësia Administrative D. Nr. *** prot., datë 10.9.2020, ku vërtetohet se znj. T.C. ka paguar taksat e ndërtesës dhe të pastrimit për vitet 2012, 2013 dhe 2014. Gjithashtu dorëzoi edhe kërkesat e drejtuara prej tij Drejtorisë Rajonale Tatimore lidhur me detyrimet e paguara nga qiramarrësit.

14.21 DPT-ja⁷⁸ informon se subjekti T.C. me NIPT *** nuk rezulton të ketë qenë e regjistruar për përgjegjësinë tatimore “tatim në burim” dhe, rrjedhimisht, nuk ka pagesa për këtë lloj tatimi.

⁷⁷Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2021.

⁷⁸Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2021.

14.22 Sa më lart, për efekt të analizës financiare, Komisioni nuk i pasqyroj të ardhurat nga qiraja për periudhën 15.12.2011 – 30.9.2015.

14.23 Lidhur me të ardhurat nga qiraja për periudhën 1.10.2015 - 1.10.2016, subjekti ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* një kontratë qiraje nr. ***, datë 26.10.2015, me palë qiradhënëse Durim Hasa dhe palë qiramarrëse R.J., person fizik me NIPT *** për marrje me qira njësi me sip. 32.9 m², L., D., afati 1 vit, vlera 20.000 lekë/muaj. Referuar nenit 4 të kësaj kontrate, pala qiramarrëse merr përsipër të paguajë tatimin në burim, i cili nuk do t'i zbritet qiradhënësit dhe nuk do të ndikojë mbi qiranë mujore. Subjekti ka bashkëlidhur edhe urdhërpagesa tatimore të subjektit tregtar me NIPT ***, shoqëruar me dokumentacionin bankar të pagesës, ku vërtetohet se janë paguar detyrimet për tatimin në burim në vlerën 3.000 lekë për periudhën tetor 2015 – shtator 2015, me përjashtim të muajve maj dhe gusht 2016.

14.24 DPT-ja⁷⁹ informon se subjekti R.J. me NIPT *** ka deklaruar pagesa për qiratë në shumën 60.000 lekë për vitin 2015 dhe 240.000 lekë për vitin 2016, e më tej ka përlllogaritur e paguar tatim në burim, respektivisht 9.000 lekë për vitin 2015 dhe 36.000 lekë për vitin 2016.

14.25 Sa më lart, për efekt të analizës financiare, Komisioni pasqyroj të ardhura nga qiraja në shumën 60.000 lekë për vitin 2015 dhe 240.000 lekë për vitin 2016.

14.26 Sa më sipër rezulton, subjekti, në prapësimet e tij lidhur me konstatimin e Komisionit shpjegon se pagimi i këtij detyrimi nuk është përgjegjësia e tij si qiradhënës dhe për këtë arsye kërkon që të ardhurat në shumën 1.140.000 lekë duhet të llogariten për efekt të analizës financiare, jo vetëm për faktin se kjo është një shumë e realizuar prej tij, por edhe sepse në kuptim të ligjit kjo është një e ardhur plotësisht e ligjshme. Më tej, subjekti ndalet në nenin 33, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe shpjegon se ligji ka parashikuar si detyrim mbajtjen në burim të tatimit të të ardhurave të tatimpaguesve. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, vijon subjekti, rezulton plotësisht e qartë se ka qenë detyrim i qiramarrësit që të paguante 10% dhe pas vitit 2015 15% të shumës së qirasë që i paguante. Marrëdhëniet e qirasë janë rregulluar me kontratën e qirasë formale, por jonoteriale. Nga pikëpamja e vlefshmërisë kjo kontratë është në përputhje me ligjin, pasi ligji nuk kërkon që ajo të jetë kontratë noteriale në kushtet kur afati i saj ka qenë vetëm 3 vjet. Vërtetë në këtë kontratë nuk është përcaktuar mënyra dhe pala që do të paguante tatimet në burim dhe tatimin mbi ndërtesën, por një gjë e tillë rregullohej nga ligji, i cili në parashikimet e tij lidhur me tatimin në burim, jo vetëm që ka përcaktuar saktësisht personin që e paguan atë dhe që është qiramarrësi që ushtron aktivitet privat, por nuk ka lënë shkak për të kundërtën, pasi në asnjë vend nuk është parashikuar dhe nuk pranohet marrëveshje e kundërt e palëve. Një gjë e tillë rezulton edhe më e qartë nëse po të mbahet parasysh fakti se qiramarrësja ka paguar në komunë edhe taksën e ndërtesës në pronësi të subjektit, pra komuna i ka kryer detyrat e saj. Fakti që e njëjta sjellje nuk ka ndodhur me tatimet, megjithëse ishte detyrimi i tyre ligjor që të kërkonin dhe të mbledhnin tatimin në burim nga qiramarrësja, nuk mund të vlerësohet si përgjegjësia dhe detyrimi i tij për të paguar tatimin në burim mbi të ardhurat në vlerën 25.000 lekë, pasi kjo shumë ka qenë e ardhura *neto* për të cilën kishin rënë dakord, përfundon subjekti.

⁷⁹Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2021.

14.27 Në seancën dëgjimore të datës 19.4.2021 subjekti paraqiti urdhërpagesat e formularëve të pagesës së tatimit mbi të ardhurat individuale, ku pasqyrohet pagesë detyrimi në shumën 121.250 lekë dhe gjoba e interesa në shumën 30.313 lekë. Pagesa është kryer në datën 19.4.2021 dhe formularët i referohen viteve 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

14.28 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

14.29 Në kontratën e qirasë jonoteriale të datës 15.12.2011 figuron si qiramarrës shtetasja T.Ç. në cilësinë e individit dhe jo si një subjekt tregtar. Duke analizuar legjislacionin tatimor konstatohet se në rastin e kontratave të qiradhënies së lidhur midis dy individëve, detyrimin për deklarim dhe pagesë në organet tatimore e ka individit përfitues, në rastin konkret subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në cilësinë e qiradhënësve.

14.30 Referuar germës “d”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat personale” për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale të ardhurat nga qiraja konsiderohen të ardhura të tatueshme, për rrjedhojë të ardhurat në rastin konkret të subjektit të rivlerësimit i nënshtrohen detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale. Germa “ë”, e pikës 1, të nenit 33, të ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, parashikon se të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10% nga shuma *bruto* e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë. Me ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014, është ndryshuar masa e tatimit në 15%.

14.31 Po kështu, nga hetimi i Komisionit rezultoi e provuar se subjekti T.Ç. me NIPT *** nuk ka qenë e regjistruar për përgjegjësinë tatimore “tatim në burim” dhe rrjedhimisht nuk ka pagesa për këtë lloj tatimi.

14.32 Konstatimi i Komisionit, në lidhje me legjitimitetin e këtyre të ardhurave, bazohet në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ku citohet se: “ [...] *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm burimin nga vinin të ardhurat*”.

14.33 Për më tepër, subjekti është kontradiktor në shpjegimet e tij lidhur me vlerën *bruto* të qirasë dhe në kushtet që asnjë prej pagesave nuk ka kaluar nëpërmjet sistemit bankar, mbeti e paqartë për Komisionin nëse vlera prej 25.000 lekësh i referohej të ardhurave *bruto* apo atyre *neto*. Kjo pasi nga njëra anë, në prapësime subjekti pretendon që vlera prej 25.000 lekësh i referohet vlerës *neto*, çka përforcohet edhe me mënyrën dhe shumën e deklaruar në DIPP-në e viteve 2011, 2012 dhe 2013, ndërkohë që referuar formularëve dhe pagesës së kryer në datën

19.4.2021, vlera e detyrimit tatimor është përlogaritur mbi shumën 300.000 lekë, pra duke presupozuar që kjo e fundit është vlera *bruto*.

14.34 Për sa rezulton, Komisioni mban të njëjtin qëndrim lidhur me mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave në vlerën 1.045.000 lekë, të realizuara nga qiradhënia e njësisë tregtare.

Analiza financiare

14.35 Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit dhe në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, kreu analizën financiare për të ardhurat, detyrimet, shpenzimet dhe blerjen e pasurive, duke analizuar respektivisht periudhën 1994 (kur subjekti emërohet gjyqtar) – 2003 dhe periudhën 2004 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë qenë në pamundësi për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite.

14.36 Lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 500.078 lekë për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2013, pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat nga qiraja dhe nga punësimi i djalit nuk u morën në konsideratë nga Komisioni, siç u arsyetua në paragrafët përkatës.

14.37 Për këtë arsye, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 500.078 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve gjatë vitit 2013, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

14.38 Në përfundim, duke marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti, në prapësime, analiza financiare pasqyrohet në tabelën në vijim:

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete <i>cash</i>	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Vitet me balancë negative
1994- 2003	820,000	100,000	450,000	3,621,613	0	2,627,095	-375,482	-375,482
2004	0	500,000	0	1,132,335	0	375,456	256,879	0
2005	0	950,000	-69,505	1,278,811	0	438,228	-39,912	-39,912
2006	4,205,902	-1,550,000	-156,960	1,482,508	0	438,228	-1,454,662	-1,454,662
2007	80,811	0	-161,991	1,471,831	3,000	1,560,742	-4,731	-4,731
2008	800,000	1,450,000	-291,903	3,200,816	-244,100	849,887	148,732	0
2009	3,927,900	-1,450,000	236,328	1,371,810	3,137,170	1,620,198	174,553	0
2010	0	318,878	57,972	1,539,870	-137,170	1,033,784	-7,934	-7,934
2011	382,158	780,296	969,704	2,213,716	0	1,040,490	-958,932	-958,932
2012	500,000	-314,877	-844,411	1,314,255	103,550	2,361,885	-284,793	-284,793
2013	0	386,208	759,300	3,337,570	90,900	2,783,040	-500,078	-500,078
2014	0	-203,113	879,014	1,907,070	676,000	1,858,716	48,453	0
2015	2,950,000	-69,164	-1,236,265	1,255,200	1,707,777	2,435,707	-1,117,301	-1,117,301
2016	0	0	-209,370	1,693,997	0	1,739,094	164,273	0
TOTAL	13,666,771	898,228	381,914	26,821,402	5,337,127	21,162,550	- 3,950,934	- 4,743,825

14.39 Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, bazuar në konkluzionet për çdo pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, duke konkluduar mbi “papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Durim Hasa”.

2. Në vazhdim përcillet raporti vijues nr. *** prot., datë 8.2.2021, për kontrollin e figurës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 18.3.2021, të KDZH-së në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit Durim Hasa. Në disa raste rezulton se gjatë periudhës në të cilën subjekti ushtronte detyrën si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, dyshohet të jetë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës, në formën e veprimeve korruptive, si dhe në formën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm me qëllim lehtësimin e pozitës së të dënuarit/pandehurit.

3. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”. Në këto kushte, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, konfirmon konstatimin fillestar për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Durim I. Hasa.

4. Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në rastin tonë të një gjyqtari, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale.

5. Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në rastin tonë, në cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik, apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësohet se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.

Hetimi i kryer nga Komisioni mbi kontrollin e figurës

6. Në vijim të informacioneve të mësipërme, në bazë të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në bashkëpunim dhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, ka kryer disa aksese në dokumentacionin e klasifikuar të poseduar nga institucionet verifikuese për t'i studiuar ato, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura.

7. Më shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2020, Komisioni kërkoi informacion nëse ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 12.10.2020, nga Prokuroria e Përgjithshme, rezultoi sa vijon:

a) *Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës*⁸⁰ informon se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar materiali kallëzues me nr. ***, datë 11.1.2017, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal më 9.2.2017.

b) *Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë*⁸¹ bën me dije se: (i) në datën 15.10.2018 është regjistruar kallëzimi penal nr. *** ndaj subjektit Durim Hasa për kryerjen e veprës penale “shpërdorim i detyrës” e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë kallëzim, në datën 13.11.2018, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, vendim i cili është ankimuar në gjykatë. Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit dhe regjistrimin e procedimit penal. Procedimi penal i regjistruar në bazë të vendimit gjyqësor, me nr. ***, datë 24.9.2019, pa person nën hetim, është duke u hetuar; (ii) në datën 26.12.2018 është regjistruar kallëzimi penal nr. *** ndaj subjektit Durim Hasa për kryerjen e veprës penale “falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Për këtë kallëzim, në datën 2.7.2019, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, vendim i cili nuk është ankimuar; (iii) në datën 6.1.2017 është regjistruar me nr. *** referimi i Drejtorisë Vendore të Policisë Berat mbi kallëzimin e bërë nga shtetasi M. K. kundër gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat Durim Hasa për kryerjen e veprës penale “shpërdorim i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë kallëzim, në datën 5.2.2017, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, vendim i cili nuk është ankimuar.

c) Ndërkohë rezulton se subjekti Durim Hasa është përmendur gjatë kryerjes së hetimeve në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2019, ku Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, me vendimin datë 9.12.2020, ka vendosur pushimin e hetimeve pasi nuk provohet se fakti ekziston. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 7.1.2021, vendosi pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e procedimit penal nr. ***, pasi nuk provohet se fakti ekziston⁸².

Hetimi i Komisionit referuar *indicieve* të organeve verifikuese

⁸⁰Shkresë nr. *** prot., datë 15.7.2020.

⁸¹Shkresë nr. *** prot., datë 19.6.2020.

⁸²Shkresë nr. *** prot., datë 30.4.2021.

8. *Lidhur me çështjen gjyqësore me palë shtetasin B. I.* – shtetasit B. I. dhe R. B. dyshohet se në bashkëpunim me njeri - tjetrin kanë vjedhur gazoil (naftë) në shoqëritë që merren me ndërtimin e gazsjellësit TAP. Ndaj tyre është caktuar masa e arrestit me burg për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, pasi është dyshuar kryerja e vjedhjes në bashkëpunim. Vetëm pas caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg” personi nën hetim B. I. ka pranuar se vjedhja e naftës është bërë prej tij, duke e vjedhur pak nga pak me mjete dhe kohë të ndryshme. Për sa rezultoi, në datën 23.7.2018, Prokuroria ka vendosur marrjen të pandehur të shtetasit nën hetim B. I. për veprën penale “vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

8.1 Nga analizimi i dosjes gjyqësore rezulton se subjekti Durim Hasa, me vendimin nr. ***, datë 26.7.2018, ka vendosur të zëvendësojë masën e sigurimit personal “arrest në burg”, dhënë ndaj shtetasit nën hetim B. I., me masën e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila kërkon ndryshimin e vendimit duke vijuar masa e sigurimit arrest në burg ndaj personit nën hetim.

8.2 Në vendim, subjekti arsyeton se nevoja e sigurimit për të pandehurin B. I., pas komunikimit të akuzës së re është zbutur dhe masa e sigurimit personal e caktuar për veprën penale “vjedhja” sipas nenit 134/2 të Kodit Penal, nuk është më masa e sigurimit e vetmja e përshtatshme dhe nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit. Është i vërtetë pretendimi i akuzës se ajo është një vepër që ka të njëjtën natyrë me atë për të cilën është caktuar masa e sigurimit, por gjykata vlerëson se vepra penale e parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal është më e lehtë, si për sa i përket minimumit dhe maksimumit të dënimit të parashikuar, i cili është më i ulët, ashtu edhe mënyrës së kryerjes së kësaj vepre dhe rrezikshmërisë shoqërore që paraqet vepra penale. I pandehuri rezulton me rrezikshmëri të ulët shoqërore, është i padënuar më parë, nuk ekzistojnë më kushtet e arratisjes, kryerjes së një krimi tjetër apo edhe manipulimit të provave.

8.3 Ndërkohë, Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë, 25.9.2018, është shprehur se vendimi i shkallës së parë është marrë në vlerësim të gabuar të ligjit dhe provave dhe e ka ndryshuar atë. Në vendimin e apelit arsyetohet se duke krahasuar provat e administruara para caktimit të masës së sigurimit arrest në burg me ato pas këtij momenti rezulton se fakti penal pavarësisht nga mënyra e cilësimit të tij ka qenë i njëjtë si para dhe pas caktimit të masës së sigurimit. Cilësimi, që prokurori i ka bërë faktit penal në momentin e caktimit të masës sipas nenit 134/2 të Kodit Penal dhe aktualisht në nenin 134/1 të Kodit Penal nuk tregon se fakti penal ka qenë i ndryshëm. Përkundrazi rezulton se roli i të pandehurit B. I. është më determinant, pasi e ka kryer shumë herë veprën penale të vjedhjes dhe kjo është një rrethanë e posaçme rënduese e kryerjes së veprës, pasi vjedhja në mënyrë të përsëritur është një rrethanë më e rrezikshme në krahasim me vjedhjen e vetëm një herë të një sendi në dëm të një personi, që përbën rastin klasik të penalizimit sipas nenit 134/1 të Kodit Penal. Gjykata e Apelit vlerëson se mungojnë kushtet e parashikuara nga neni 260 i Kodit Penal në zbutjen e nevojave të sigurimit pasi rëndësia e faktit penal në ngarkim të të pandehurit, pavarësisht ndryshimit të cilësimit të tij vazhdon të mbetet e lartë.

8.4 Vepra penale e parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dënohet me gjobë ose me burgim, duke filluar nga 5 ditë deri në 3 vjet. Koha e qëndrimit në paraburgim nga i pandehuri është shumë më e vogël se masa e dënimit, që mund të caktohet për këtë vepër penale nisur, kjo edhe nga sasia e madhe e karburantit të vjedhur. Pra, periudha e vuajtur në paraburgim nuk përbën shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi dënimi që mund të caktohet ndaj personit nën hetim mund të jetë më i lartë.

8.5 Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: Duket se subjekti i rivlerësimit me anë të vendimit nr. ***, datë 26.7.2018, ka zëvendësuar masën e sigurimit nga “arrest me burg” në “detyrim për paraqitje”, pra ka dhënë një masë më të lehtë për të pandehurin B. I., ndërkohë që nuk plotësoheshin kushtet për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, me një tjetër më të butë, sipas pikës 2, të nenit 260, të Kodit të Procedurës Penale.

8.6 Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se: Kërkesat për vlerësimin e arrestit të flagrancës dhe caktimin e masës së sigurimit personal janë shqyrtuar nga subjekti si gjyqtar i gatshëm, e para kundër shtetasve B. I. dhe R. B., të cilët dyshoheshin se kishin kryer veprën penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal dhe e dyta kundër shtetasit H. I., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Pasi janë shqyrtuar këto kërkesa, përfundimisht, janë vlerësuar të ligjshme arrestimet e kryera nga policia gjyqësore dhe në ngarkim të tre shtetasve janë vendosur masat e sigurimit personal “arrest në burg” pa afat. Prokuroria, pas hetimit lidhur me shtetasit B. I. dhe R. B., ka arritur në përfundimin se nuk kishin qenë në bashkëpunim në vjedhjen e kryer.

8.7 Në kushtet e reja të krijuara është paraqitur kërkesë për zëvendësim e masës së sigurimit. Në përputhje me ligjin (neni 13 i Kodit të Procedurës Penale) kërkesat janë shqyrtuar nga subjekti, i cili ishte gjyqtari i hetimit paraprak. Në përfundim të shqyrtimit të të dyja kërkesave, subjekti ka vlerësuar se nevoja e sigurimit është zbutur. Në kushtet e reja të krijuara, veprat penale për të cilat akuzoheshin dy të pandehurit, ishin më të lehta sesa ajo e parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Sipas subjektit, fakti që të pandehurit nuk i janë fshehur hetimit dhe gjykimit, si dhe fakti që nuk është provuar se kanë kryer vepër tjetër penale apo kanë bërë përpjekje për të fshehur provat, provon drejtësinë e vendimit të dhënë prej tij. Më tej, ai deklaroi se në vendimet për zëvendësimin e masave të sigurimit për të dy këta shtetas, ka pasur parasysh edhe politikat e dënimit penal dhe faktin që në disa raste Ministria e Drejtësisë i është drejtuar publikisht organeve të qeverisjes së pushtetit gjyqësor për aplikimin e dënimeve alternative në rastet e parashikuara në ligj.

8.8 Lidhur me hetimin e kryer nga Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë, për veprat penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm nga funksionari që ushtron funksion publik”, “korrupsion pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarit tjetër të drejtësisë”, subjekti deklaroi se është vënë në dijeni vetëm nga raporti i Komisionit të Pavarur i Kualifikimit. Subjekti deklaroi se ky hetim është regjistruar mbi të dhëna të pavërteta dhe se marrëdhëniet e tij me palët, gjatë këtij procedimi, kanë qenë vetëm ato të seancave gjyqësore. Në asnjë rast nuk ka dhënë këshilla lidhur me çështjet e gjykuara prej tij apo çështje të tjera. Pavërtetësia e këtyre të dhënave qëndron në faktin se vëllëzërit e pandehur akuzoheshin për vepra të ndryshme, ishin në procedime të ndryshme dhe ishin arrestuar për fakte penale të ndryshme, kështu që pretendimi

se subjekti ka këshilluar që njëri prej vëllezërve të marrë përsipër fajin është jo vetëm i pavërtetë, por i paarsyeshëm dhe i palogjikshëm. Subjekti shpjegon se fakti që i pandehuri H. I. është gjykuar më vete provon vërtetësinë e shpjegimeve të tij. Ky i fundit akuzohej për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, i cili në minimum ka parashikuar një dënim 5 vjet burgim dhe nuk mund të gjykohej prej tij për shkak se ka qenë gjyqtar i hetimit paraprak dhe ndaj tij ka vendosur masën e sigurimit “arrest në burg”. Në përfundim, subjekti deklaroi se është njohur dhe vënë në dijeni se në lidhje me procedimin e mësipërm Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në bazë të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me vendimin nr. ***, datë 7.1.2021, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2019, me arsyetimin se nuk provohet se fakti ekziston. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti kërkesën e tij dorëzuar pranë këtij institucioni në datën 1.6.2021 dhe vendimin nr. ***, datë 7.1.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Arsyetimi ligjor i Komisionit

8.9 Trupi gjykues i Komisionit arsyeton se zëvendësimi i masës së sigurimit nga arrest me burg në detyrim për paraqitje, pra ka dhënë një masë më të lehtë, për të pandehurin B. I., ndërkohë që nuk plotësoheshin kushtet për zëvendësimin e masës së sigurimit arrest me burg me një tjetër më të butë, sipas pikës 2, të nenit 260, të Kodit të Procedurës Penale, tregon se subjekti i rivlerësimit me vendimin e dhënë për masën e sigurisë ka favorizuar të pandehurin B. I., duke qenë se nga provat dhe shqyrtimi i kësaj çështjeje rezultoi se ky shtetas ka kryer shumë herë veprën penale të vjedhjes, rrethanë rënduese e kryerjes së veprës, që përbën rastin klasik të penalizimit sipas nenit 134/1 të Kodit Penal. Gjithashtu, duke krahasuar provat e administruara para caktimit të masës së sigurimit arrest në burg me ato pas këtij momenti rezultoi se fakti penal ka qenë i njëjtë si para dhe pas caktimit të masës së sigurimit. Ky vendim i dhënë nga subjekti, i parë në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë hetimit, informacioni i verifikuar nga organet ligjzbatuese, si dhe bindja e brendshme e trupit gjykues, ka elementë që të bindin se në rastin konkret ka pasur një favorizim të të pandehurit në dhënien e masës së sigurisë, favorizim i cili ndikon në perceptimin e publikut/komunitetit ku jeton i pandehuri në lidhje me organet e drejtësisë. Gjithsesi, vlen të theksohet se ky vlerësim në këtë proces administrativ, në asnjë rast nuk vë në dyshim vendimin nr. ***, datë 7.1.2021, të marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2019, me arsyetimin se nuk provohet se fakti ekziston.

9. Lidhur me çështjen gjyqësore me palë shtetasin A. M. – nga hetimi i Komisionit rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me trupë gjyqësore Durim Hasa kryesues, R. P. dhe P. Z. – anëtarë, ka gjykuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit A. M., akuzuar për kryerjen e veprave penale “vjedhje me dhunë” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 139-25 të Kodit Penal dhe “vjedhje me pasojë vdekjen”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 141 dhe 25 të Kodit Penal.

9.1 Rrethanat e faktit – mbi bazën e materialit të ardhur nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka regjistruar procedimin penal nr. ***. Nga hetimi rezultoi e provuar

se në datën 18.4.2002, në vendin e quajtur K./Greqi, është vlarë në banesën e tij një shtetas gjerman. Nga aktekspertimi mjeko-ligjor i realizuar në shtetin grek, si dhe nga tërësia e provave shkresore që ndodhen në dosje provohet se ai ka gjetur vdekjen si pasojë e goditjeve të ushtruara me forcë dhe në mënyrë të përsëritur, me një këmbë karrigeje. Pas kësaj ngjarjeje autorët janë larguar menjëherë, pa arritur të realizonin vjedhjen e banesës. Gjithashtu rezulton e provuar se, në datën 1.4.2002, vetëm pak kohë përpara ngjarjes së mësipërme në vendin e quajtur P./Greqi, një person me aftësi të kufizuara është vjedhur dhe plagosur me thikë në faqe. Për këto vepra është akuzuar shtetasi A. M., në bashkëpunim me dy shtetas të tjerë shqiptarë K. H. dhe E. A., të cilët janë dënuar në shtetin grek.

9.2 Nga deklaratimet në seancë gjyqësore të të pandehurit lidhur me veprën penale “vjedhje me pasojë vdekjen”, kryer në bashkëpunim, rezultoi e provuar se ai e pranon faktin penal të datës 18.4.2002, ndërkohë lidhur me veprën penale “vjedhje me dhunë”, kryer në bashkëpunim, ndodhur më 1.4.2002, me vendimin nr. ***, datë 6.6.2019, gjykata arsyeton se nga tërësia e provave të administruara dhe aktet e dërguara për kompetencë gjykimi nga autoritetet e drejtësisë greke, si dhe nga përgjigjja e letërporosisë së dërguar kësaj gjykate, nuk rezultoi e provuar që i pandehuri së bashku me dy personat e tjerë të përmendur më sipër, të këtë kryer këtë vepër penale. Nga tërësia e provave të administruara provohet se nga autoritetet e drejtësisë greke nuk është ngritur akuzë për 2 të gjykuarit atje K. H. dhe E. A., në lidhje me këtë fakt penal për të cilin Prokuroria Berat në ngritjen e akuzës bazohet vetëm në vendimin për arrestimin dhe shpalljen në kërkim të autoriteteve, lëshuar në fillim të hetimit nga drejtësia greke e në të cilin është theksuar se në ngarkim të të dyshuarve rëndojnë faktet penale të ndodhura në këto dy data.

9.3 Rezulton se Prokuroria ka kërkuar deklaratimin fajtor të të pandehurit A. M. për kryerjen e të dy veprave penale të mësipërme në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 17 vjet burgim. Ndërkohë që gjykata, lidhur me veprën penale “vjedhje me pasojë vdekjen”, kryer në bashkëpunim, arsyeton se me ardhjen e pasojës së rëndë të vdekjes së viktimës, kjo vepër konsiderohet e kryer edhe pse nuk është bërë e mundur të realizohet vjedhja⁸³. Në përfundim e ka dënuar të pandehurin me 17 vjet burgim⁸⁴.

9.4 Në lidhje me akuzën tjetër të ngritur nga Prokuroria për veprën penale “vjedhje me dhunë”, gjykata arsyeton se në gjykim akuza nuk paraqiti qoftë edhe një provë të vetme për të provuar fajësinë e të pandehurit për këtë krim. Nga tërësia e provave që ndodhen në dosje nuk rezulton e provuar se i pandehuri e ka kryer veprën e dytë që akuzohet. Nga përgjigjja e letërporosisë së kthyer nga autoritetet greke, si dhe nga dosja e dërguar për kompetencë prej tyre nuk rezulton

⁸³Gjykata e shkallës së parë arsyeton se Gjykata e Lartë në vendimin e saj unifikues nr. 6, datë 30.9.2011, ka unifikuar praktikën duke theksuar: “*Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e personit, por nuk është shtënë në dorë (vjedhur) pasuria e tij, do të konsiderohet plotësisht e konsumuar që nga çasti që ka ardhur si pasojë vdekja e personit, të cilit i përkiste pasuria ose ishte vënë në mbrojtje të saj, pavarësisht nga shtënia në dorë ose jo e kësaj pasurie nga subjekti i veprës penale*”.

⁸⁴ Për sa i përket caktimit të masës së dënimit, gjykata mban parasysh rrezikshmërinë e veprës penale dhe të pasojës së saj. Formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje dhe në bashkëpunim. Në bazë të nenit 48 të Kodit Penal, gjykata vlerëson që të çmohë si rrethana lehtësuese për dënimin e këtij të pandehuri atë të parashikuar nga germa “ç” e këtij neni, siç janë: përkushtimi familjar, sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, fakti që ai nuk është i përfshirë më pas në veprimtari kriminale, veprën e ka kryer në moshë të re, është i padënuar më parë, si dhe qëndrimi i tij duke e pranuar faktin dhe fajësinë e tij.

që të jenë zhvilluar hetime dhe as të jenë ngritur akuza për të pandehurit në lidhje me këtë fakt. Nga autoritetet e drejtësisë greke rezulton se në vendimin e dërgimit të çështjes në gjyq për dy të pandehurit e tjerë të gjykuar në Greqi, gjykimi është pezulluar dhe nuk është ngritur akuzë për faktin e datës 1.4.2002, pasi për këtë fakt nuk ka prova se është kryer nga tre të pandehurit. Në këto kushte gjykata vlerëson që të shpallet i pafajshëm për këtë akuzë.

9.5 Komisioni vëren se vendimi është dhënë me shumicë votash dhe anëtarja e trupës R. P. ka dalë me vendim pakice, duke arsyetuar se për ngjarjen e datës 1.4.2002, nga ana e Prokurorisë nuk është regjistruar procedim penal, nuk janë kryer hetime dhe nuk janë marrë prova për të mbështetur akuzën në ngarkim të të pandehurit. Marrja e vendimit të pafajësisë për faktin penal të ndodhur në datën 1.4.2002, do të pengonte regjistrimin e një procedimi të ri në të ardhmen dhe do të pengonte hetimin dhe gjykimin e shtetasit A. M., nëse ky fakt penal do të provohej më vonë, apo nëse do të kërkohej transferim i procedimit penal ose njohja e vendimit penal të huaj që mund të jetë dhënë ose mund të jepet ndaj tij nga drejtësia greke. Në përfundim, kjo gjyqtare vlerëson se lidhur me këtë çështje penale gjykimi duhet të pushohet pasi nuk ka një procedim penal dhe hetime. Duhet të udhëzohet organi i akuzës të marrë informacion nga autoritetet greke, nëse rezulton të ketë të dhëna për implikimin e shtetasit A. M. apo personave të tjerë që mund të ndodhen në Shqipëri e të bëhet regjistrimi i procedimit penal për këtë vepër.

9.6 Kjo çështje është regjistruar në datën 12.7.2017 dhe ka përfunduar në datën 6.6.2019, në një kohëzgjatje prej rreth 2 vitesh, jashtë standardit kohor 12-mujor të parashikuar në germen “a”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Por, vlen të theksohet se çështja ka qenë komplekse pasi janë kërkuar disa letërporosi në shtetin grek dhe janë thirrur për të marrë pjesë në gjykim viktimat, të cilët janë shtetas të huaj.

9.7 Më tej, evidentohet se i pandehuri ka kërkuar të procedohej me gjykim të shkurtuar dhe gjykata, me shumicë votash, me vendimin e ndërmjetëm të datës 22.11.2017, ka vendosur të rrëzojë këtë kërkesë, duke arsyetuar se në bazë të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale pavarësisht se kjo vepër penale është kryer shumë kohë përpara se të hynin në fuqi ndryshimet që ndalojnë gjykimin e shkurtuar për veprat penale që përmbajnë dënim me burgim të përjetshëm, duhet të zbatohet kodi i ndryshuar, i cili e ndalon gjykimin e shkurtuar. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit Durim Hasa ka dalë me vendim pakice, duke arsyetuar se ndalesa e vendosur me ndryshimet e reja në nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale, nuk duhet të zbatohet për të pandehurit, të cilët kanë kryer vepra penale para datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 33/2017. Gjithashtu, subjekti referon në paragrafin 3, të nenit 3, të Kodit Penal, sipas të cilit në rastet kur ligji i kohës në të cilin është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

9.8 Në analizë të sa më sipër, Komisioni vëren se bazuar në nenin 141 të Kodit Penal “vjedhja me pasojë vdekjen”, vjedhja e pasurisë kur është shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga 15 deri në 25 ose me burgim të përjetshëm. Para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me gjykimin e shkurtuar, në nenin 406 parashikohej se: *“Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. Dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me tridhjetë e pesë vjet burgim”*. Ndërkohë që, me ndryshimet e bëra, në pikën 2 të nenit 403 “Kërkesa për gjykimin e

shkurtuar”, citohet se *nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm*. Referuar vendimit nr. 2, datë 29.1.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Komisioni vlerëson se: Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen e 1/3 të masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

9.9 Në kuadër të këtij hetimi, me anë të pyetësorit nr. 3⁸⁵, subjekti është pyetur nëse njihet me shtetasit Sh. M. dhe G. Ç. dhe në përgjigje⁸⁶ deklaroi se shtetasin Sh. M. e njeh pasi e ka pasur fqinjë në Çorovodë. Ky shtetas ka kërkuar ta takojë duke i bërë me dije se i pandehuri A. M. ishte nipi i tij. Subjekti deklaroi se i ka shpjeguar që në ngarkim të tij ishte duke u zhvilluar një gjykim i drejtë dhe nëse kërkonte të njihet me dosjen ai duhet të pyeste avokatin e nipit të tij, i cili në kushtet kur çështja ishte në gjykim posedonte të gjitha aktet. Pas kësaj ky shtetas nuk ka bërë përpjekje për ndikim, subjekti nuk e ka takuar dhe nuk ka komunikuar më me të. Lidhur me njohjen me shtetasin G. Ç., subjekti deklaroi se është kushëriri i tij (djali i dajës). Ky shtetas nuk ka bërë përpjekje për të ndikuar te subjekti lidhur me këtë çështje dhe se i vetmi fakt që mban mend është se në një rast ai i ka thënë se prindërit e shtetasit A. M. kishin nxjerrë në shitje shtëpinë në Poliçan për të liruar djalin nga burgu. Pas kësaj, subjekti e ka këshilluar të mos përzihej me këtë çështje dhe më pas e ka takuar rrallë në raste familjare, por nuk ka pasur asnjë bisedë lidhur me këtë fakt. Në përfundim, subjekti deklaroi se në lidhje me sa më lart, ka dhënë shpjegime me cilësinë e personit që di rrethana të hetimit përpara oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

9.10 Sa më sipër rezulton, subjekti ka konfirmuar kontaktin me persona të afërt të të dënuarit, lidhur me këtë rast gjykimi, çka përputhet me *indiciet* e organeve ligjzbatuese për favorizim në dukje të të pandehurit A. M. Në këto kushte, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) duket se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit/kryesues të kësaj çështje ka vepruar në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke takuar të afërm të të pandehurit, të cilët kanë ndërhyrë për çështjen, veprim i cili në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës, cenon figurën e gjyqtarit; (ii) duket se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar shtetasin A. M., me anë të mendimit të pakicës, në të cilin ka pranuar kërkesën për gjykimin e shkurtuar, pra uljen e 1/3 të masës së dënimit, kërkesë e cila ndalohet nga pika 2 e nenit 403 “Kërkesa për gjykimin e shkurtuar”; (iii) duket se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar me anë të marrjes së vendimit të dhënies së pafajësisë për veprën penale “vjedhje me dhunë” në bashkëpunim, pasi ky vendim do të pengonte hetimin, regjistrimin e një procedimi të ri dhe gjykimin e çështjes në të ardhmen për shtetasin A.M. Për rrjedhojë, duket se përputhen *indiciet* e organeve ligjzbatuese për favorizimin e shtetasit A. M. me faktet e administruara nga hetimi.

9.11 Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se: (i) nga të afërm të këtij të pandehuri ka takuar vetëm xhaxhain e tij, shtetasin Sh. M. dhe rrethanat e këtij takimi i ka shpjeguar në mënyrë të hollësishme në përgjigjet e pyetjeve shtesë nr. 03. Takimi është kërkuar në një kohë që subjekti nuk e dinte se ky shtetas ishte xhaxhai i të pandehurit dhe gjatë

⁸⁵E-mail datë 26.1.2021, ora 11:58.

⁸⁶E-mail datë 29.1.2021, ora 14:39.

këtij takimi nuk ka pasur përpjekje për ndikim të paligjshëm; (ii) në lidhje me vendimin e ndërmjetëm, në pakicë, deklaroi se ka qenë jashtë çdo lloji ndikimi të paligjshëm dhe është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e zbatimit të ligjit me korrektësi. Çështja është regjistruar në gjykatë dhe ka filluar gjykimi në datën 12.7.2017, në një kohë kur nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe, për rrjedhojë, as ndryshimet e nenit 406 të po këtij Kodi, për sa i takon ndalimit të gjykimit të shkurtuar për veprën penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm. Me arsyetimin se neni 406 i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, ndalon gjykimin e shkurtuar për personat që kanë kryer vepra penale që dënohen në maksimum me burgim të përjetshëm, si dhe me arsyetimin se ligji i zbatueshëm për shkak se është procedural duhet të jetë ligji i kohës së gjykimit, u arrit në përfundimin e shpallur nga shumica. Subjekti deklaroi se ligji nuk është një rregull dhe nuk mund të interpretohet vetëm si i tillë, është një tërësi rregullash, të cilat duhet të interpretohen në unitet me njëra-tjetrën. Siç ka theksuar edhe në vendim, paragrafi 3, i nenit 3, të Kodit Penal, ka parashikuar se kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ligji dispozitat e të cilit janë me të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Sipas subjektit, nëse një ligj penal është në favor të të pandehurit ai është i detyrueshëm të zbatohet, qoftë ky material apo procedural. Sipas subjektit në kushtet dhe gjendjen në të cilën ndodheshin aktet duhet të pranohet kërkesa për gjykim të shkurtuar, ku edhe prokurori e ka mbështetur këtë kërkesë⁸⁷.

9.12 Në lidhje me vendimin përfundimtar, dhënë me shumicë votash, subjekti deklaroi se në këtë rast zbatimi i normave procedurale të ndryshuara ka qenë i detyrueshëm për gjykatën. Pas ndryshimeve të bëra në nenin 387 të Kodit të Procedurës Penale, janë parashikuar në mënyrë eksplicite rastet e pushimit të çështjes në përfundim të gjykimit. Po kështu, edhe neni 388 i Kodit të Procedurës Penale, pas ndryshimeve të bëra ka rregulluar rastet e pafajësisë. Para ndryshimeve neni 387 përcaktonte se: *“1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillojë ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar, gjykata vendos pushimin e çështjes duke treguar dhe shkaqet. 2. Gjkata vendos në të njëjtën mënyrë kur ekzistenca e një kushti procedimi apo e një shkakut që e shuan veprën penale është e dyshimtë”*. Pas ndryshimeve në nenin 387 të Kodit të Procedurës Penale kjo dispozitë parashikon: *“1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, sipas rasteve të parashikuara në shkronjat ‘c’, ‘ç’, ‘e’ dhe ‘ë’ të paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi, ose kur vepra penale është shuar dhe i pandehuri nuk pretendon pafajësi, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke reaguar edhe shkakun. 2. Shfuqizuar”*. Nga analiza e kësaj dispozite rezulton se pushimi i çështjes në fund të shqyrtimit gjyqësor mund të bëhet vetëm në rastet e parashikuara në gjerat “c”, “ç”, “e” dhe “ë”, të paragrafit 1, të nenit 328⁸⁸. Pra, siç shihet nga dispozita e mësipërme ligji nuk ka lënë vend për interpretim, vetëm në këto katër raste çështja mund të pushohet në fund të gjykimit. Në rastet e tjera dhe sidomos në rastin kur nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale, në mënyrë të shprehur ka parashikuar pafajësi. Subjekti deklaroi se vendimi i pakicës është në

⁸⁷Subjekti, për referencë, përmend çështjen “Sçoppola kundër Italisë” paraqitur në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, ka arritur në përfundimin se dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin e shkurtuar kanë elementë të së drejtës penale materiale, si dhe vendimin nr. ***, datë 20.9.2019, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

⁸⁸“ c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën veprë penale; ë) i pandehuri vdes”.

lajthim, duke interpretuar normat procedurale të pandryshuara, gjithashtu gjyqtarja R. P., ka trajtuar në mënyrë të pasaktë edhe faktin kur ka theksuar se çështja nuk është regjistruar. Çështja e ndodhur në datën 1.4.2002, është pezulluar për mosgjetjen e autorit. Nga të dhënat e siguruara gjatë hetimit gjyqësor dy të pandehurit e tjerë të gjykuar në Greqi nuk ishin hetuar dhe gjykuar për këtë çështje ndërkohë që në fund të gjykimit prokurori pa e provuar fare këtë fakt kërkoi deklarinimin fajtor për të dyja veprat.

Arsyetimi ligjor i Komisionit

9.13 Lidhur me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, subjekti, në arsyetimin e vendimit të tij, referon në paragrafin 3, të nenit 3, të Kodit Penal, sipas të cilit kur ligji i kohës në të cilin është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Komisioni e gjen të drejtë shpjegimin e subjektit.

9.14 Në lidhje me vendimin përfundimtar dhënë me shumicë votash, Komisioni vëren se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm se pas ndryshimeve në nenin 387 të Kodit të Procedurës Penale kjo dispozitë parashikon se pushimi i çështjes në fund të shqyrtimit gjyqësor mund të bëhet vetëm në rastet e parashikuara në gerrat “c”, “ç”, “e” dhe “ë”, të paragrafit 1, të nenit 328, kur: “c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes. Në rastet e tjera, si dhe kur nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale në nenin 388 të Kodit të Procedurës Penale, pas ndryshimeve të bëra, janë parashikuar rastet e pafajësisë.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se kontakti në formën e një takimi me një të afërm të të pandehurit gjatë kohës së shqyrtimit të kësaj çështjeje, konfirmuar nga subjekti, tregon se subjekti i rivlerësimit, të paktën në dukje, ka një mënyrë sjelljeje jo të denjë për një magjistrat, gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës së tij. Frekuentimi i personave të afërm me të pandehurit, i gjykuar vetëm në dukje, cenon figurën dhe integritetin e një magjistrit. Kjo sjellje e subjektit të rivlerësimit ndikon në perceptimin e publikut për dhënien e drejtësisë.

Komisioni, ndërsa arrin në konkluzionet e sipërpërmendura në dy çështjet e analizuara në vendim, çmon se këto konkluzione të merren parasysh në një vlerësim të përgjithshëm, në këndvështrim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

10. Trupi gjykues, në vlerësimin e rrethanave faktike si më sipër, ka parasysh se objekt i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

11. Në përfundim të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk rezultuan të dhëna të tjera që subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

12. Në përfundim, Komisioni çmon të nevojshme të trajtojë konkluzionet e sipërpërmendura në gjykimin e çështjeve më sipër në vlerësimin tërësor të procedurave në kuptim të paragrafi 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Subjekti i rivlerësimit Durim Hasa është diplomuar në datën 29.3.1994. Me vendimin e datës 6.7.1995 të KLD-së është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar. Në vijim, me vendimin datë 24.10.2008, të KLD-së është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Në datën 24.12.2018 zgjidhet nga Këshilli i Gjykatës në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, detyrë që mban edhe aktualisht.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

3. Sa më sipër, lidhur me aftësitë profesionale, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka njohuri në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit dhe aftësi mesatare në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara janë të kuptueshme, përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe të ligjit për të treguar lidhjen midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur subjekti, por në disa raste pa cituar identitetin e plotë dhe aktin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal është dhënë “Në emër të Republikës”, kur në fakt nuk është një çështje themeli, por kërkime të prokurorit dhe vendime të gjykatës në fazën e hetimeve paraprake. Si praktikë të arsyetimit të vendimit subjekti ka bërë edhe analizën e kompetencës së juridiksionit apo përbërjes së gjykatës, megjithëse nuk janë kundërshtuar nga palët. Në dy prej dosjeve të analizuara, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit nuk analizohen të detajuara rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe autorit të saj, rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në një rast arsyetimi ligjor për dënimin penal të të pandehurit nuk është cituar mbi bazën e dispozitave të ligjit “Për armët” dhe aktekspertimit teknik të armëve dhe municionit luftarak për të përcaktuar gjendjen e tyre teknike si kusht për ekzistencën e veprës penale. Në një rast tjetër është cenuar parimi kushtetues i proporcionalitetit që lidhet me masën e dënimit penal, si dhe keqinterpretuar neni 63/3 i Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim.

4. Trupi gjykues vlerëson se konstatimet e mësipërme nuk përbëjnë shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbeten elemente, të cilat do të konsiderohen në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

5. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit (8 tetor 2013 - 8 tetor 2016) për subjektin Durim Hasa janë paraqitur gjithsej 4

ankesa në Inspektoratin e KLD-së: 2 ankesa të vitit 2015 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar pasi mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor, 1 ankesë e vitit 2016 pas shqyrtimit fillestar është arkivuar pasi nuk përmban fakte dhe rrethana për verifikim dhe 1 ankesë e vitit 2016 është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe nuk është konstatuar shkelje. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin Durim Hasa përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk janë regjistruar kërkesa për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

6. Lidhur me aftësitë organizative sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat konstatohet se për periudhën e rivlerësimit, subjekti ka përfunduar 1491 çështje gjyqësore, 936 civile dhe 555 çështje penale, me një ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Koha e gjykimit të çështjeve rezulton brenda standardit të një procesit të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i dosjeve të shortuara është konstatuar se subjekti i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore.

7. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se gjyqtari Durim Hasa referuar kohëzgjatjes mesatare të gjykimeve dhe arsyetimit të vendimeve, ngarkesës sasiore dhe cilësisë së vendimmarrjes, rezulton eficient dhe i aftë për të përballuar ngarkesën në punë në kryerjen e veprimtarisë gjyqësore. Gjithashtu vërehet se ka kryer veprimet e nevojshme me qëllim përfundimin në kohë të gjykimit të çështjeve⁸⁹.

8. Më tej, nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në to, si dhe nuk janë konstatuar të dhëna negative lidhur me komunikimin verbal dhe shkresor me kolegët, administratën, palët ndërgjyqëse dhe të tretët, brenda dhe jashtë procesit gjyqësor dhe nuk është evidentuar asnjë rast i konfliktit të interesit.

9. Lidhur me gatishmërinë për t'u angazhuar, Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 76/5 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", për vlerësimin "shumë mirë" periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë vjetëve, kështu që duke interpretuar shifrat me rendin zbritës, standardi minimal rezulton 28 ditë për 3 vjet. Të dhënat e dokumentuara me vërtetimin nr. *** prot., datë 25.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, provojnë se për periudhën trevjeçare të rivlerësimit subjekti ka qenë pjesëmarrës në 2 seminare trajnimi, me 3 ditë trajnim në 3 vjet. Për rrjedhim, subjekti i rivlerësimit Durim Hasa nuk ka plotësuar standardin minimal të pjesëmarrjes në formimin vazhdues prej 28 ditësh në 3 vjet, sipas pikës 5, të nenit 76, të ligjit për Statusin.

10. Trupi gjykues vlerëson se mosplotësimi i standardit minimal të pjesëmarrjes në formimin vazhdues, nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element që

⁸⁹Pas marrjes së çështjes me short ai ka vënë në lëvizje shpejt përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore edhe njoftimin e palëve brenda afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 333 i Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 155 të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti, në tërësi respekton afatet ligjore në caktimin e seancave, duke mbajtur në konsideratë edhe shkakun që shtyn seancën gjyqësore.

është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

11. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv dhe ankesave të paraqitura pranë Inspektoratit të KLD-së. Pas analizimit të tyre u konstatuan këto problematika dhe u kërkuan shpjegime e prova për sa vijon:

*Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.12.2015*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me palë paditëse S. S. kundër të paditurve Zyra Private Përmbartimore Tiranë sh.p.k. dhe shoqëria e parë financiare “****” sh.a. Tiranë, persona të tretë: ZVRPP-ja Skrapar, R. S. dhe L. S. me objekt “pavlefshmëri e titullit ekzekutiv”. Nga hetimi konstatohet se çështja është regjistruar për gjykim në datën 2.2.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 10.12.2015. Gjykimi ka zgjatur 10 muaj e 8 ditë jashtë afatit standard prej 6 muaj, të parashikuar nga germa “b”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

11.1 Nga faktet e analizuar më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se gjykimi i çështjes ka zgjatur 10 muaj e 8 ditë jashtë afatit standard prej 6 muaj të parashikuar nga germa “b”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

11.2 Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se gjatë gjykimit të kësaj çështjeje 2 muaj e 15 ditë, ka qenë me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punën, në pamundësi lëvizjeje, me diagnozën “Hernie diskale”. Po kështu, gjatë muajit gusht subjekti ka qenë me pushime vjetore. Shkaqet e tjera kanë ndodhur për shkak të vonesave në përgatitjen e aktekspertimit dhe kërkesave të palëve për t’u njohur me aktin dhe bërjen e pyetjeve të ndryshme prej tyre. Pyetjet e palëve kanë bërë që në lidhje me çështjen të përgatitet një aktekspertimi shtesë. Subjekti shpjegon se nga datat e seancave të caktuara dhe hapësira midis dy seancave provohet qartë përpjekja e tij për të përfunduar çështjen sa më shpejt.

Arsyetimi ligjor i Komisionit

11.3 Pasi u analizuan shpjegimet e paraqitura nga subjekti, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimit, tej afatit standard, nuk ka ardhur si rezultat i mosorganizimit të mirë të punës nga ana e subjektit, si dhe nuk rezultoi të ketë shtyrje të seancave për shkaqe të pamotivuara. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afateve të gjykimit në shqyrtimin e kësaj çështjeje nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

12. Çështja civile nr. * regj. them., datë 22.4.2014 regjistrimi**, që i përket paditësit F. D., kundër të paditurit M. SH., persona të tretë shtetasit G. B. dhe M. K. me objekt “kallëzim i një punimi të ri dhe dëmi të mundshëm”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 3.10.2014.

12.1 Nga faktet e analizuar më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) Në seancën e parë përgatitore datë 16.5.2014, subjekti, bazuar në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile, e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore për në datën 6.6.2014. Ndërkohë që në këtë datë, referuar procesverbalit gjyqësor datë 6.6.2014, është

zhvilluar përsëri një seancë e dytë përgatitore, pa u shpjeguar arsytet. (ii) Seanca gjyqësore e datës 29.7.2014 e caktuar për t'u mbajtur në orën 10:00, është çelur në orën 09:52, 8 minuta para orarit të caktuar dhe ka zgjatur deri në orën 10:02 minuta. Zhvillimi i procesit para orarit të caktuar ka sjellë pasoja gjykimi në mungesë për palën e paditur dhe palën e tretë. (iii) Evidentohen 3 seanca joproductive, 1 seancë përgatitore e përsëritur dhe 2 seanca gjyqësore për shkak të mungesës dhe mos përgatitjes së ekspertit.

12.2 Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se në lidhje me pikën (i) ku konstatohen dy seanca përgatitore ka vlerësuar vazhdimin në seancë përgatitore, pasi nga natyra e çështjes ka dashur të sqarojë natyrën e konfliktit. Ka qenë një kërkesëpadi e hartuar keq, me mungesë të theksuar profesionalizmi dhe në rrethana të tilla e ka mbajtur çështjen në seancë përgatitore. Nga përmbajtja e procesverbalit të seancës së parë përgatitore rezulton se ka urdhëruar palët që të paraqesin provat e pronësisë së tyre mbi pasuritë në konflikt. Kjo do të thotë se gjatë asaj seance nuk e ka përfunduar përgatitjen e çështjes dhe, për rrjedhojë, ka vazhduar edhe në seancën pasardhëse. Marrja e vendimit për kalimin në seancë gjyqësore duket se ka qenë një sjellje për shkak të rutinës nga përsëritja e vazhdueshme dhe për një kohë të gjatë i të njëjtave gjëra. Subjekti deklaroi se nuk ka sjellë asnjë pasojë për çështjen dhe nuk duhet të konsiderohet një seancë joproductive. Në lidhje me pikën (ii) deklaroi se në seancën gjyqësore të datës 29.7.2014, e caktuar për t'u mbajtur në orën 10:00 dhe e çelur në orën 09:52, mund të ketë qenë ndonjë gabim në orën e kompjuterit ose gabim në orën e subjektit. Në lidhje me pikën (iii) subjekti shpjegon se ka dy seanca joproductive dhe ato kanë qenë për shkak të mungesës së ekspertit, i cili ka pasur arsye për të mos u paraqitur. Megjithatë, çështja ka përfunduar brenda afateve të parashikuara dhe ka mbetur në fuqi në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Arsyetimi ligjor i Komisionit

12.3 Në analizë të shpjegimeve të paraqitura, Komisioni vlerëson se zhvillimi i dy seanceve përgatitore ka ardhur edhe si rezultat i sqarimit të natyrës së konfliktit, si dhe nuk rezultoi të ketë shtyrje të seanceve për shkaqe të pamotivuara. Lidhur me çeljen e seancës gjyqësore para orës së caktuar, rezulton se në këtë seancë i janë dhënë detyrat ekspertit dhe gjatë relativitetit të tij dhe në vazhdim të gjyqimit, pala e paditur ka qenë prezente në të gjitha seancat, duke mos sjellë pasoja për çështjen, gjithashtu konstatohet se gjykimi ka përfunduar brenda afateve të parashikuara dhe ka mbetur në fuqi në Gjykatën e Apelit Vlorë. Në përfundim, pas analizimit të shpjegimeve dhe fakteve të paraqitura, Komisioni nuk vëren problematika që mund të lidhen me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në gjykimin e kësaj çështjeje.

13. Për të kryer një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, Komisioni gjithashtu kërkoi informacion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor⁹⁰ dhe Ministrisë së Drejtësisë⁹¹ dhe në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masave disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri më sot. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 7.5.2021, të Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit Durim Hasa janë depozituar 4 ankesa: (1) ankesa e shtetasit F. T. e vitit 2017; (2) ankesa e shtetasit T. K. e vitit 2018 (trajtuar edhe në seksionin e denoncimeve nga publiku). Pasi u analizuan këto dy ankesa, nga Ministria e Drejtësisë është

⁹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2021.

⁹¹Shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2021.

vlerësuar se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni; (3) ankesa e shtetases M. B., e vitit 2019 (trajtuar edhe në seksionin e denoncimeve nga publiku), arkivuar nga Ministria e Drejtësisë; (4) ankesa e Institutit të Mjekësisë Ligjore e vitit 2019, e cila ka kaluar për kompetencë në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë.

14. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 14.5.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se ndaj subjektit Durim Hasa nga viti 2006 e deri më sot janë depozituar 21 ankesa, për të cilat është vendosur arkivimi. Vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit. Ndërkohë që, 8 ankesa të tjera (të përsëritura nga të njëjtët denoncues), nuk disponohen fizikisht pranë arkivit të institucionit, pasi janë depozituar pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Më tej, KLGJ-ja bën me dije se nuk rezultojnë të dhëna për procedime disiplinore apo masa të marra ndaj subjektit të rivlerësimit Durim Hasa.

15. Në vijim të hetimeve, mbështetur në informacionet e marra referuar burimeve të hapura, Komisioni hetoi edhe çështjen gjyqësore me palë shtetasin A. Z.

15.1 Rrethanat e faktit – rezulton se shtetasi A. Z. ka bërë kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat duke kërkuar rehabilitimin e tij si rrjedhojë e kalimit të afateve ligjore të parashikuara në nenin 69 të Kodit Penal nga dënimet penale të dhëna kundër tij. Rezulton e provuar se kërkuesi është person i dënuar me vendime gjyqësore të formës së prerë. Me vendimin nr. ***, datë 1.2.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar e ka deklaruar atë fajtor për veprën penale “kundërshtimi i punonjësit të policisë”, parashikuar nga neni 23 6/1 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 10 muaj burgim. Po kështu, provohet se kërkuesi është deklaruar fajtor me vendimin nr. ***, datë 21.5.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprat penale “kryerja e veprimeve arbitrare” dhe “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 250 dhe 187/1 të Kodit Penal. Në bazë të këtyre dispozitave ligjore dhe në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal për bashkimin e dënimeve kërkuesi është dënuar përfundimisht me 1 vit burgim.

15.2 Komisioni vëren se në datën 14.6.2002 ka hyrë në fuqi ligji nr. 8895, datë 16.5.2002, për amnistinë neni 1/1, i të cilit përcakton se: “*Amnistohen personat e dënuar më burgim deri në 2 vjet, personat e dënuar me kusht ose me gjobë*”. Ligji i mësipërm ka hyrë në fuqi në një kohë kur në datën 31.5.2002, vendimi i dënimit me 1 vit burgim ishte i formës së prerë dhe kjo amnisti ka bërë që i dënuari A. Z. të mos e kryejë dënimin.

15.3 Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 8.9.2016, ka vendosur të konstatojë të rehabilituar kërkuesin A. Z. nga dënimet penale të dhëna ndaj tij dhe pas datës 14.6.2007 të konsiderohet me gjendje gjyqësore “i padënuar”.

15.4 Subjekti, në vendimin e tij, ka arsyetuar se kërkuesi A. Z., pa u rehabilituar për dënimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar, është dënuar përsëri nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 1 vit burgim. Ky burgim konsiderohet i kryer në datën 14.6.2002, datë në të cilën ka hyrë në fuqi amnistia. Në lidhje me këtë situatë ligjore, subjekti arsyeton në vendim se kërkuesi e ka kryer dënimin me 1 vit burg në datën 14.6.2002 dhe, për rrjedhojë, në kuptim të gërmës “b”, të nenit 69, të Kodit Penal nga data 14.6.2002 duhet të konsiderohet i padënuar 5 vjet pas kësaj date, në qoftë se ai gjatë kësaj periudhe nuk kryen vepër tjetër penale. Nuk

rezulton që kërkuesi të ketë kryer ndonjë veprë tjetër penale pas datës 14.6.2002 dhe, për rrjedhojë, nga kjo datë konsiderohet i padënuar.

15.5 Pasi u analizua kjo çështje, trupi gjykues vëren se bazuar në germën “b”, të nenit 69, të Kodit Penal, quhen të padënuar ata persona që janë dënuar me burgim për një kohë nga 6 muaj deri në 5 vjet dhe që gjatë 5 vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer veprë tjetër penale. Ndërkohë që shtetasi A. Z., pa përfunduar rehabilitimin e dënimit të parë me të cilin është dënuar me 10 muaj burgim, është dënuar me 1 vit burgim për dy vepra të tjera penale pas një viti, pavarësisht se nuk e ka vuajtur dënimin si rezultat i amnistisë, kjo nuk e mohon kryerjen e dy veprave të tjera penale dhe mosplotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 69/b.

15.6 Sa më sipër rezulton, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për sa vijon se duket se vendimi i konstatimit të rehabilituar të shtetasit A. Z. nga dënimet penale të dhëna ndaj tij, vjen si pasojë e interpretimit të gabuar të ligjit, konkretisht nenit 69 të Kodit të Procedurës Penale, pasi: (i) me vendimin nr. *, datë 1.2.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar e ka deklaruar atë fajtor për veprën penale “kundërshtimi i punonjësit të policisë” dhe e ka dënuar atë me 10 muaj burg; si dhe (ii) është deklaruar fajtor me vendimin nr. ***, datë 21.5.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprat penale “kryerja e veprimeve arbitrare” dhe “falsifikimi i dokumenteve” dhe është dënuar përfundimisht me 1 vit burgim.**

15.7 Në shpjegimet e tij subjekti deklaron se: *“Bazuar në nenin 69 të Kodit Penal rezulton qartë se Instituti i Rehabilitimit nuk e ndalon rehabilitimin e të dënuarve që përfundojnë vuajtjen e dënimit, pavarësisht sa herë janë dënuar ata. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ngatërrohet kryerja e një veprë tjetër penale me dhënien e dënimit për kryerjen e një veprë penale. I dënuari A. Z. me vendimin nr. ***, datë 21.5.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dënuar për dy vepra penale të kryera përpara se t’i fillonte afati 5-vjeçar i rehabilitimit për dënimin e caktuar me vendimin nr. ***, datë 1.2.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar dhe jo të kryer gjatë këtij afati. Duhet theksuar se ai i ka kryer këto vepra përpara se të kryente veprën penale për të cilën është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar”.*

Kufizimi i vetëm i vendosur nga neni 69/b i Kodit Penal është që i dënuari gjatë periudhës prej 5 vjetësh nga vuajtja e dënimit, të mos kryejë veprë tjetër penale dhe jo të mos dënohet për një veprë penale të kryer përpara kësaj periudhe. Fakti që dënimi i marrë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është dhënë për vepra penale të kryera përpara afatit 5-vjeçar të rehabilitimit, provohet nga vendimi i mësipërm, i cili ka qenë pjesë e fashikullit të gjykimit. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se veprat penale, për të cilat është dënuar shtetasi A. Z., janë kryer përpara datës 1.2.2001, kur ka filluar periudha e rehabilitimit të tij. Po kështu, edhe pas dënimit të dytë, të dhënë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga provat e administruara në gjykim, nuk ka rezultuar se i dënuari ka kryer veprë tjetër penale. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 21.5.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Arsyetimi ligjor i Komisionit

15.8 Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti dhe më pas ato në seancën dëgjimore, vëren se ai i pranon konstatimet e Komisionit duke deklaruar gjithashtu edhe faktin që nuk ka arsyetuar në vendim se vepra e dytë për të cilën akuzohej shtetasi A. Z. ka ndodhur para veprës për të cilën kishte nisur afati i rehabilitimit. Komisioni, bazuar në germën “b”, të nenit 69, të Kodit Penal, i qëndron konstatimit se quhen të padënuar ata persona që janë dënuar me burgim për një kohë nga 6 muaj deri në 5 vjet dhe që gjatë 5 vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale. Ndërkohë që shtetasi A. Z., pa përfunduar rehabilitimin e dënimit të parë me të cilin është dënuar me 10 muaj burgim është dënuar me 1 vit burgim për dy vepra të tjera penale pas 1 viti, pavarësisht se nuk e ka vuajtur dënimin si rezultat i amnistisë, kjo nuk e mohon kryerjen e dy veprave të tjera penale dhe mosplotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 69/b.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se qasja e subjektit dhe arsyetimi i tij në vendimin e dhënë lidhur me rehabilitimin e shtetasit A. Z., do të konsiderohet nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor, në këndvështrim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

1. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Durim Hasa, janë administruar 24 denoncime nga publiku. Në 13 prej këtyre denoncimeve ngrihen pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta dhe nuk përmbahen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 30.5.2019, i shtetasit M. K.; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 10.6.2019, i shtetasit Th. C.; (3) denoncimet nr. *** prot., datë 10.6.2019 dhe nr. *** prot., datë 28.3.2018, të shtetasit A. M.; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 26.9.2019, i shtetasit N. L.; (5) denoncimi nr. *** prot., datë 28.10.2019, i shtetasit D. I.; (6) denoncimi nr. *** prot., datë 6.3.2018, i shtetasit D. K.; (7) denoncimi nr. *** prot., datë 8.6.2018, i shtetasit J.S.; (8) denoncimi nr. *** prot., datë 3.7.2018, i shtetasit T. K.; (9) denoncimi nr. *** prot., datë 31.7.2018, i shtetasit A. A.; (10) denoncimi nr. *** prot., datë 6.11.2018, i shoqërisë “****” sh.a.; (11) denoncimi nr. *** prot., datë 21.4.2021, i shtetasit F. D.; si dhe (12) denoncimi nr. *** prot., datë 20.11.2019, adresuar nga Dhoma e Avokatisë Berat, por pa emër konkret, ku ngrihen pretendime ndaj disa subjekteve, ndër ta, edhe subjekti Durim Hasa, i cili gjatë ushtrimit të funksionit të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat akuzohet për organizimin e dobët të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga kjo gjykatë, si dhe për mungesë të aftësive profesionale dhe burimeve të ligjshme financiare për pasuritë e regjistruara në emër të tij.

2. Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalja e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

3. Ndërkohë që, kërkoi shpjegime lidhur me denoncimet nr. *** prot., datë 3.7.2018; nr. *** prot., datë 19.4.2021; nr. *** prot., datë 19.4.2021; nr. *** prot., datë 19.4.2021; nr. *** prot., datë 28.4.2021; nr. *** prot., datë 10.5.2021; nr. *** prot., datë 28.4.2021; nr. *** prot., datë

21.5.2021; denoncimet e paraqitura në rrugë elektronike, si dhe të depozituara dorazi në institucion protokolluar me nr. *** prot., datë 27.4.2021, nr. *** prot., datë 28.4.2021, nr. *** prot., datë 28.4.2021; (gjithsej 9 denoncime) të shtetaseve/motrat M. B. dhe A. Q., të cilat ngrenë akuza për disa subjekte rivlerësimi për dhënien e disa vendimeve të padrejta, ndërkohë që pretendimet e ngritura ndaj subjektit të rivlerësimit Durim Hasa lidhen me falsifikimin e dosjes gjyqësore nr. ***, datë 22.2.2009.

4. Rrethanat e faktit – shtetaset M. B. dhe A. Q. (J.) kanë bërë kallëzim penal, pasi pretendojnë se nga dosja gjyqësore civile me nr. *** vendimi datë 22.4.2009 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat janë hequr akte, duke u zëvendësuar me akte të tjera nga sekretaret gjyqësore E. D. dhe K. H. në bashkëpunim me gjyqtarin Durim Hasa, kryesekretaren dhe shtetasin A. J. Sipas këtyre shtetaseve, këto dokumente janë tjetërsuar duke zëvendësuar dokumentet origjinale që kanë qenë në dosjen e vitit 2009, me dokumente të njëjta nga forma, por me përmbajtje të falsifikuar, me qëllim për të dëmtuar procesin dhe për të bërë të pavlefshëm vendimin e gjykatës. Me vendimin datë 13.11.2018, Prokuroria Lushnjë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018, lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë⁹², ndërkohë që Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 28.2.2019, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe vijimin e hetimeve, duke arsyetuar se shumë nga pretendimet e kallëzuesëve, jo vetëm që nuk janë hetuar dhe sqaruar, por as nuk janë vlerësuar si ekzistente në lidhje me mangësitë në administrimin dhe evidentimin e akteve të dosjes gjyqësore. Sipas akteve në fashikullin gjyqësor që i përket vendimit nr. ***, datë 22.4.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, konstatohet dukshëm mungesa e akteve që, sipas inventarit të kësaj dosjeje, duhet të ishin pjesë e saj⁹³.

5. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se gjatë gjykimit të procedimit penal nr. *, lidhur me hetimet e kryera në dosjen gjyqësore civile me nr. vendimi ***, datë 22.4.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, konstatohen mangësi në administrimin dhe evidentimin e akteve të dosjes gjyqësore.**

6. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se: Në përfundim të gjykimit, pasi janë administruar të gjitha provat shkresore, gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e kërkuarit dhe ka vërtetuar faktin e pronësisë së trashëgimlënësit mbi pasuritë e pretenduara në pronësi të tij për periudhën përpara vitit 1945. Pas shpalljes së vendimit, brenda afateve procedurale është dorëzuar vendimi i arsyetuar dhe sekretaria gjyqësore ka

⁹²Vendimi nr. ***, datë 26.12.2018.

⁹³(i) Në dosjen gjyqësore, në faqet nr. *** ndodhet i evidentuar aktekspertimi i ekspertit topograf. Ndërsa aktekspertimi i hartuar në dy fletë mban numrat rendorë *** dhe ***, harta treguese që duhet të jetë pjesë integrale e këtij akti nuk ka asnjë numërtim, por vijon faqja *** e dosjes me shkresën e datës 23.2.2009 të Këshillit të Qarkut Berat; (ii) Rezulton gjithashtu se në relatin e tij në seance gjyqësore, eksperti është shprehur: “*Aktekspertimin e kam përgatitur me shkrim dhe po e dorëzoj në gjykatë, së bashku me aktet përkatëse dhe skicat bashkëngjitur*”. Ndërkohë që në dosjen gjyqësore ndodhet vetëm një hartë treguese, pikërisht ajo e sipërcituar më lart, e panumërtuar si aktet e tjera të këtij gjykimi; (iii) po kështu, rezultojnë mangësi të theksuara në përmbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 10.3.2009, i cili rezulton jo i plotë (mungojnë faqet *** dhe ***); (iv) rezulton gjithashtu se shkresa nr. *** prot., datë 10.9.2008 e Arkivit Shtetëror Vendor Berat, shoqërohet nga *** fletë gjithsej, ndërkohë që në dosjen gjyqësore, ky vërtetim shoqërohet me *** fletë; (v) gjithashtu, dokumentit të marrë nga Arkivi Qendror Shtetëror Tiranë, i cili është i numërtuar me numrin *** në dosjen civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i mungon faqja shpjeguese.

bërë numërtimin e tij. Vendimi ka marrë formë të prerë dhe çështja është dorëzuar në arkiv, po brenda afateve ligjore. Ankueset kanë paraqitur kallëzim ndaj subjektit në vitin 2017, në një kohë që çështja ka qenë e arkivuar për një periudhë më shumë se 8 vjet.

6.1 Në lidhje me pretendimet e ngritura nga kallëzueset, subjekti deklaroi se bazuar në nenin 77 të Kodit të Procedurës Civile, është detyra e sekretarisë gjyqësore administrimi, numërtimi dhe ruajtja e akteve të fashikullit. Për këtë arsye nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi si gjyqtar i kësaj çështjeje. Nuk ka pasur arsye dhe motive të tërhiqte nga dosja akte, të cilat do të çonin në dëm të arsyetimit të vendimit të njohjes. Siç provohet edhe nga vetë deklaratimet e ankueseve janë dorëzuar prova që kanë qenë fotokopje të vërtetuara me origjinalin. Provat janë marrë nga arkivat shtetërore dhe, në këtë rast, ankueset kanë mundësi që të rimarrin aktet e pretenduara si të hequra nga dosja pranë zyrës së noterisë ku kanë bërë noterizimin e këtyre provave.

6.2 Gjykata e Apelit Vlorë rezultoi të jetë shprehur se në dosje mungon faqja *** e aktekspertimit dhe midis faqeve *** dhe *** ndodhet harta treguese e pronës, e cila është e panumërtuar. Ndërkohë që, faqja *** është e numërtuar dhe dokumenti që e mban këtë numër është harta treguese. Ky dokument është format i madh dhe duke qenë se aktet e ndodhura janë format ***, harta në dosje është e palosur në dy pjesë, gjatë fotokopjes së bërë ka ndodhur që pjesa ku është vendosur numri nuk është fotokopjuar, pasi numri është vendosur në pjesën e bardhë të hartës, e cila ka qenë e palosur. Po kështu, lidhur me pretendimin se përveç aktekspertimit ka pasur dokumente të tjera bashkëlidhur, i vetmi dokument ka qenë skica (harta) e cituar më lart. Kjo provohet nga rendi numerik i dosjes si në përgjithësi dhe për çdo fletë, ashtu edhe në renditjen në kapakun e saj.

6.3 Në lidhje me konstatimin e bërë nga gjykata se në dosje mungojnë faqet *** dhe *** të procesverbalit gjyqësor, subjekti deklaroi se sekretarja gjyqësore gjatë mbajtjes së procesverbalit me shkrim dore ka harruar pa shënuar numrin në faqen e radhës, ku pas numrit *** ka shënuar numrin *** dhe po kështu edhe në faqen ***. Ky gabim është i dukshëm dhe i kuptueshëm për dy arsye. Së pari në procesverbal nuk ka shprehur mendimi nga faqja *** në faqen *** dhe nga *** në faqen *** dhe, së dyti, në numërtimin përfundimtar të dosjes nuk ka ngatërrim dhe as korrigjime, gjë që do të thotë se nuk ka ndërhyrje.

6.4 Lidhur me problemin e ngritur në lidhje me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2007, në të cilin theksohet fakti se mungon një fletë, sipas subjektit as ky pretendim nuk qëndron. Nga citimi i arkivit rezultoi se kërkuesit i është vënë në dispozicion dokumenti arkivor i marrë nga “F ***, V ***, D ***, fl ***”. Është qartësisht e kuptueshme se nga materiali arkivor i mësipërm kërkuesit i është dhënë fleta me nr. *** dhe jo dy fletë. Në të kundërt arkivi do të theksonte se i jepën fletët me numrat përkatës⁹⁴. Për më shumë në lidhje me këtë ankim, subjekti thekson se rasti është në hetim dhe se nuk ka pasur dhe as nuk ka motive për të tërhequr prova nga dosja, prova mbi të cilat është bazuar vendimi që ai ka dhënë.

⁹⁴Në lidhje me dokumentin e dorëzuar në gjykatë fotokopje e njëzuar me origjinalin nga kërkuesi, dërguar këtij të fundit me shkresën nr. *** prot., datë 10.9.2008 nga Arkivi Shtetëror Vendor Berat, rezultoi se bashkëlidhur dokumentit nuk janë *** fletë, por *** (konkretisht fl. ***, ***, *** dhe ***), të cilat janë të legalizuara nga noteri. Mënyra e dërgimit të dokumenteve nga Arkivi provon qartësisht se në rastin e mësipërm bëhet fjalë për fletën *** dhe jo për *** fletë siç ka theksuar padrejtësisht Gjykata e Apelit Vlorë.

6.5 Në kuadër të hetimeve lidhur me këtë denoncim, Komisioni i është drejtuar Prokurorisë Lushnjë⁹⁵ lidhur me ecurinë e procedimit penal nr. ***, datë 24.9.2019, si dhe administrimin e fashikujve të dosjes penale. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021, Prokuroria informon se ky procedim është ende në hetim. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se nuk mund të shprehet lidhur me pretendimet e ngritura në denoncim.

7. Më tej, Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me konstatimet referuar denoncimit nr. *** prot., datë 27.4.2021, paraqitur nga shtetasi Xh. K., i cili ngre pretendime ndaj subjektit Durim Hasa për pranimin në gjykim të Deklaratës së Mbrojtjes së palës së paditur tej afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 158, të Kodit të Procedurës Civile.

7.1 Nga hetimi i Komisioni rezulton se denoncuesi është në cilësinë e palës paditëse në çështjen civile me objekt “detyrimin e të paditurit të pushojë cenimin në pronësi, lirim dhe dorëzim të banesës tonë me përbërje 2 +1 në pallatin nr. ***, kati i ***, ap. ***, në lagjen “****”, në qytetin Ura Vajgurore, Berat”, me palë të paditur S. Dh. Kjo çështje ka qenë duke u gjykuar nga gjyqtari K. Ç. dhe më pas i ka kaluar subjektit Durim Hasa.

7.2 Komisioni vëren se kjo çështje është në gjykim e sipër në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe ftoi subjektin të japë shpjegime lidhur me vijimësinë e procesit gjyqësor dhe pretendimet e ngritura në këtë denoncim.

7.3 Për sa rezulton, subjekti deklaroi se kjo çështje ka qenë në shqyrtim nga gjyqtari K. Ç., pasi atij i përfundoi mandati i magjistratit i kaloi subjektit. Në kushtet kur çështja ishte në seancë përgatitore gjykimi u vazhdua aty ku ishte ndërprerë. Gjatë vazhdimit të seancës përgatitore përfaqësuesi i paditësit ngriti pretendimin se në kushtet kur brenda afatit të parashikuar nga neni 158/1 të Kodit të Procedurës Civile, i padituri nuk ka paraqitur deklaratë mbrojtjeje dhe prova shoqëruese, të mos pranohen këto prova dhe njëkohësisht pretendon se i padituri nuk duhet të marrë fjalën në seancat gjyqësore të kësaj çështjeje. Kërkesa e dytë nuk është pranuar, gjë që ka bërë që paditësi të paraqesë kërkesë për përjashtimin e subjektit, kërkesë e cila është rrëzuar. Në kushtet e mësipërme seanca përgatitore është shtyrë në pritje të vendimit për kërkesën për përjashtim dhe është riçelur përsëri në datën e caktuar. Në përfundim, gjykata, bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur të nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe provat që do të merren në shqyrtim. Është përjashtuar pranimi i deklaratës së mbrojtjes dhe provave shoqëruese të pretenduara nga i padituri. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti procesverbalet e printuara nga sistemi, në datat 8.4.2021 dhe 12.5.2021, si dhe vendimi nr. ***, datë 26.4.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Arsyetimi ligjor i Komisionit

7.4 Trupi gjykues çmon se bazuar në pikën 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim. Në këto kushte, vlerësohet se nuk mund të analizohen pretendimet e ngritura në denoncim.

⁹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2021.

8. Sa më sipër, pas analizimit të denoncimeve të paraqitura, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se denoncimet e trajtuara nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

9. **Si konkluzion**, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale problematikat e evidentuara dhe të shqyrtuara në këtë vendim vlerësohet se nuk përmbajnë shkelje serioze dhe nuk kanë shkaktuar pasoja të rënda procedurale për palët në mënyrë që subjekti i rivlerësimit të kualifikohet “i papërshtatshëm” nga ana profesionale.

10. Komisioni çmon se këto mangësi duhen vlerësuar sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të pikës 2, të nenit 4, të të njëjtit ligj dhe, sipas pikës 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, çka nënkupton se Komisioni arrin në përfundimin se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Në një analizë të përgjithshme të të gjitha konkluzioneve të arritura në procesin e rivlerësimit dhe të arsyetuara në vendim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë **në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë:**

- i. Deklarim jo të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë apartament me sip. 96.6 m², L., Tiranë, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Mospërputhje deklarimesh midis deklarimit të subjektit dhe provave të administruara në lidhje me pjesën takuese të një garazhi automjeti me sip. 24.8 m², L., Tiranë, blerë në shumën 5.555,2 euro.
- iii. Deklarim jo i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e këtij apartamentit me sip. 55 m², rruga “***”, Berat, blerë në shumën 2.400.000 lekë.
- iv. Mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë automjet tip “Renault Megane”, blerë në datën 13.11.2011, në vlerën 2.700 euro.
- v. Deklarim jo i saktë dhe në përputhje me ligjin, mungesë të burimeve të ligjshme për dhënien hua shtetasit S. L., në shumën 1.200.000 lekë, në vitin 2005 dhe, për rrjedhojë, mungesë burimesh të ligjshme për përfitimin e interesave nga kjo hua në shumën 200.000 lekë, si dhe gjendja në kushtet e konfliktit të interesit në shqyrtimin e një çështjeje për shtetasin S. L., me të cilin kishte pasur marrëdhënie të konfirmuar interesi dhe shoqërie.
- vi. Deklarime kontradiktore dhe një sërë transaksionesh joformale në lidhje me apartamentet në pronësi ose posedim të subjektit në qytetin e Çorovodës, duke pasqyruar vështirësi në kontrollin e ligjshmërisë së këtyre apartamenteve.

- vii. Mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në pronësi të djalit të subjektit, blerë në vlerën 500.000 lekë.
- viii. Mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasuri, kryerjen e shpenzimeve, të ardhurat dhe pagimi i detyrimeve sipas analizës financiare për periudhat 1994 – 2003 (kur subjekti emërohet gjyqtar) dhe 2003 – 2006 sipas deklarimeve në ILDKPKI.
- ix. Mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e njësisë në shumën 1.045.000 lekë.

Në lidhje me vlerësimin tërësor

Në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në pikën 2, të nenit 4 dhe në pikën 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi:

- i. Nëpërmjet marrjes së vendimit për vlerësim sigurie ndaj shtetasit S. L., me të cilin kishte marrëdhënie shoqërore dhe interesi dhe ishte në kushtet e papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës së tij.
- ii. Kryerja e një sërë transaksionesh joligjore për apartamentet në Çorovodë, duke mos i kushtuar rëndësi anës formale, por duke kryer veprime që nuk duhet të kryhen nga një magjistrat me njohuritë e posaçme ligjore.
- iii. Zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest me burg” në “detyrim për paraqitje”, dhënia e një mase më të lehtë për të pandehurin B. I., ndërkohë që nuk plotësoheshin kushtet për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, me një tjetër më të butë, i parë në këndvështrimin e informacioneve nga organet ligjzbatuese.
- iv. Takimi me një të afërm të të pandehurit me inicialet A. M., gjatë kohës së shqyrtimit të kësaj çështjeje, konfirmuar nga subjekti. Frekuentimi i personave të afërm me të pandehurit, i gjykuar vetëm në dukje, cenon figurën dhe integritetin e një magjistrati, duke ndikuar në perceptimin e publikut për dhënien e drejtësisë.
- v. Dhe disa mangësi konstatuar në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, të cilat nuk janë të tilla në numër sa mund të rekomandohet program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë bazuar në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D, DH, E dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Durim Hasa, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA

Relatore

Roland ILIA

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Olsida Goxhaj